

# **NJOHURI THEMELORE FETARE**

**Tekst mësimor**

**6**

**2001**

Ky tekst është përgatitur nga një komision  
Përkthyes: Dr. Mithat Hoxha  
Stamboll, maj 2001

## **PËRMBAJTJA:**

<b>PJESA I</b> .....	8
<b>KUPTIMI I FESE</b> .....	8
<b>1. FEJA</b> .....	9
Lexim letrar .....	9
Rëndësia e fesë .....	9
<b>3. HEBRAIZMI</b> .....	10
<b>4. KRISHTERIZMI</b> .....	11
<b>5. ISLAMI</b> .....	12
<b>6. LUTJA E “ETTEHIJJATU” DHE KUPTIMI I SAJ</b> .....	13
<b>PJESA II</b> .....	14
<b>PARIMET DHE PERGJEGJESITE BESIMORE-ADHURIMORE NE ISLAM</b> .....	14
<b>1. Ç’ESHTE BESIMI?</b> .....	15
<b>2. PERSE BESOJME?</b> .....	15
<b>3. KUSHTET E BESIMIT</b> .....	16
<b>4. DISA NGA DETYRAT TONA MORALE</b> .....	16
<i>a. Detyrat tona para Allahut</i> .....	16
<i>b. Detyrat tona para Profetit</i> .....	17
<i>c. Detyrat tona para Kur’anit</i> .....	17
<b>5. Ç’ ESHTË ADHURIMI?</b> .....	18
<b>6. PERSE BEJME ADHURIM?</b> .....	18
<b>7. Ç’PERFITIME NA SJELL ADHURIMI?</b> .....	19
Lexim letrar .....	21
<b>8. LUTJET “ALLAHUMME SAL-LI”, “ALLAHUMME BARIK” DHE KUPTIMI I TYRE</b> .....	22
<b>PJESA III</b> .....	24
<b>PASTERTIA DHE NDERSHMERIA NE ISLAM</b> .....	24
<b>1. PASTERTIA</b> .....	25

<i>a. Njeriu i pastër moralisht</i> .....	25
<i>b. Njeriu i pastër trupërisht</i> .....	25
<i>c. Pse duhet ta mbajmë pastër mjedisin?</i> .....	26
<b>2. NDERSHMERIA DHE DOBITE E SAJ</b> .....	<b>26</b>
<i>a. Ç'është ndershmëria?</i> .....	26
<i>b. Kujt i thonë “njeri i ndershëm”?</i> .....	27
<i>c. Cilat janë dobitë e ndershmërisë?</i> .....	27
<b>3. ABDESTI TRUPOR (GUSULI)</b> .....	<b>28</b>
<b>DHE ABDESTI I NAMAZIT</b> .....	<b>28</b>
<i>a. Abdesti trupor (gusuli)</i> .....	28
<i>b. Abdesti i namazit</i> .....	29
<i>c. Farzet, sunnetet dhe mekruhet e abdestit</i> .....	29
<i>d. Gjërat që prishin abdestin</i> .....	30
<b>Lexim letrar</b> .....	<b>30</b>
<i>e. Tejemmumu</i> .....	31
<b>4. EZANI DHE KUPTIMI I TIJ</b> .....	<b>33</b>
<b>PJESA IV</b> .....	<b>35</b>
<b>NAMAZI</b> .....	<b>35</b>
<b>NAMAZI</b> .....	<b>36</b>
<b>1. FARZET E NAMAZIT</b> .....	<b>36</b>
<b>2. SI FALET NAMAZI?</b> .....	<b>37</b>
<b>3. NE Ç'RASTE PRISHET NAMAZI?</b> .....	<b>39</b>
<b>4. NDIKIMET E NAMAZET</b> .....	<b>39</b>
<b>MBI JETESEN TONE TE PERDITSHME</b> .....	<b>39</b>
<b>5. LUTJET E NAMAZIT DHE KUPTIMI I TYRE</b> .....	<b>39</b>
<b>6. RENDESIA E FALJES SE NAMAZIT NE BASHKESI</b> .....	<b>42</b>
<b>7. NAMAZET</b> .....	<b>42</b>
<i>a. Namazet e pesë kohëve</i> .....	42
<i>b. Namazi i xhumasë</i> .....	44
<i>c. Namazi i teravive</i> .....	46
<i>ç. Namazi i bajramit</i> .....	46
<i>d. Namazi i të vdekurit</i> .....	46

<i>e. Namazet shitesë (nafile)</i> .....	47
<b>Lexim letrar</b> .....	<b>48</b>
<i>Namazi mbulon mëkatet</i> .....	48
<b>Lexim letrar</b> .....	<b>49</b>
<b>Lexim letrar</b> .....	<b>49</b>
<b>8. KREU FIL (Elefanti) DHE KUPTIMI I TIJ</b> .....	<b>51</b>
<b>PJESA V</b> .....	<b>52</b>
<b>AGJERIMI</b> .....	<b>52</b>
<b>1. AGJERIMI</b> .....	<b>53</b>
<b>2. KUSHTET E AGJERIMIT</b> .....	<b>54</b>
<b>3. NE Ç'RASTE PRISHET AGJERIMI</b> .....	<b>54</b>
<b>4. GJERAT QE S'E PRISHIN AGJERIMIN</b> .....	<b>55</b>
<b>5. SHPREHITE E MIRA QE FITOHEN ME AGJERIMIN</b> .....	<b>55</b>
<i>a. Zotërimi i vetvetes (forcimi i vullnetit)</i> .....	55
<i>b. Aftësimi për t'u bërë ballë vështirësive</i> .....	56
<i>c. Formimi i marrëdhënieve të mira me mjedisin</i> .....	56
<i>d. Ndihma shoqërore</i> .....	56
<b>6. DOBITE E AGJERIMIT</b> .....	<b>56</b>
<i>a. Nga ana fizike</i> .....	57
<i>b. Nga ana shpirtërore</i> .....	57
<b>Lexim letrar</b> .....	<b>58</b>
<b>7. KREU ASR DHE KUPTIMI I TIJ</b> .....	<b>59</b>
<b>PJESA VI</b> .....	<b>60</b>
<b>ZEQATI</b> .....	<b>60</b>
<b>1. ZEQATI</b> .....	<b>61</b>
<b>2. KUSH JEP ZEQTAT?</b> .....	<b>61</b>
<b>3. KUJT I JEPET ZEQTAT?</b> .....	<b>62</b>
<b>4. PER Ç'FARE JEPET ZEQTAT?</b> .....	<b>62</b>
<b>5. DOBITE SHOQERORE TE ZEQTATIT</b> .....	<b>63</b>

<b>6. SADAKAJA E FITRIT (FITRI)</b> .....	<b>63</b>
<b>7. RESPEKT NDAJ TE DREJTES</b> .....	<b>63</b>
<b>SE TJETRIT</b> .....	<b>63</b>
<i>a. E drejta vetiake e njeriut</i> .....	63
<i>b. E drejta e fqinjtit</i> .....	64
<i>c. E drejta e të varfërit dhe bonjakut</i> .....	65
<b>Lexim letrar</b> .....	<b>65</b>
<b>Lexim letrar</b> .....	<b>67</b>
<b>Lexim letrar</b> .....	<b>67</b>
<b>8. LUTJA E BUKES DHE KUPTIMI I SAJ</b> .....	<b>68</b>
<b>PJESA VII</b> .....	<b>69</b>
<b>HAXHI</b> .....	<b>69</b>
<b>1. HAXHI</b> .....	<b>70</b>
<b>2. PER KE ESHTË HAXHI FARZ?</b> .....	<b>70</b>
<b>3. FARZET, VAXHIBET DHE SUNNETET</b> .....	<b>71</b>
<b>4. ETIKA E HAXHIT</b> .....	<b>71</b>
<b>5. KURBANI</b> .....	<b>72</b>
<b>6. KURBANI I PERKUSHTUAR</b> .....	<b>72</b>
<b>Lexim letrar</b> .....	<b>73</b>
<b>7. LUTJE NGA GOJA E PROFETIT TONE</b> .....	<b>74</b>
<b>PJESA VIII</b> .....	<b>75</b>
<b>FEJA ESHTË MORAL I BUKUR</b> .....	<b>75</b>
<b>1. FEJA ESHTË MORAL I BUKUR</b> .....	<b>76</b>
<b>2. SHPREHITE DHE SJELLJET E MIRA</b> .....	<b>76</b>
<i>a. Detyrat ndaj vetes</i> .....	76
<i>b. Detyrat ndaj prindërve</i> .....	77
<b>Lexim letrar</b> .....	<b>77</b>
<b>Lexim letrar</b> .....	<b>78</b>
<b>Lexim letrar</b> .....	<b>79</b>

<i>c. Detyrat tona ndaj mësuesve .....</i>	<i>80</i>
<i>d. Detyrat tona ndaj motrave e vëllezërve e ndaj të afërmeve të tjerë .....</i>	<i>80</i>
<i>e. Detyrat tona ndaj kombit dhe shoqërisë.....</i>	<i>81</i>
<b>Lexim letrar .....</b>	<b>83</b>
<b>Mikpritja e Ebu Talhasë.....</b>	<b>83</b>
<b>3. VESET E KEQIA.....</b>	<b>84</b>
<i>a. Përgojimi dhe smira.....</i>	<i>85</i>
<i>Smira.....</i>	<i>85</i>
<i>b. Egoizmi dhe dyfytërsia .....</i>	<i>86</i>
<b>Lexim letrar .....</b>	<b>88</b>
<i>c. Urrejtja dhe armiqësia .....</i>	<i>89</i>
<b>Lexim letrar .....</b>	<b>90</b>
<b>Druri i gështenjës .....</b>	<b>90</b>
<b>Lexim letrar .....</b>	<b>91</b>
<i>d. Sjellje që dëmtojnë vendin dhe kombin .....</i>	<i>92</i>
<b>Lexim letrar .....</b>	<b>92</b>
<b>4. KREU FATIHA DHE KUPTIMI I TIJ .....</b>	<b>94</b>
<b>BURIMET.....</b>	<b>95</b>

## **PJESA I KUPTIMI I FESE**

### **ÇESHTJET**

- 1. FEJA**
- 2. NJOHURI TE PERGJITHSHME MBI FETE**
- 3. HEBRAIZMI**
- 4. KRISHTERIZMI**
- 5. ISLAMI**
- 6. LUTJA “ETTEHIJATU” DHE KUPTIMI I SAJ**

### **PUNE PERGATITORE**

- 1. Gjeni në fjalor dhe mësojeni kuptimin e fjalëve fe dhe moral.**
- 2. Çfarë ndryshimesh ka në jetën e përditshme mes një muslimani dhe një besimtari të një feje tjetër? Kërkoni të dini.**
- 3. Ç’ dini mbi fetë hyjnore? Kërkoni të dini ngjashmëritë në themel mes këtyre feve.**



## 1. FEJA

Feja është tërësia e rregullave hyjnore të cilat Allahu i Lartë ua ka dërguar njerëzve me anë të profetëve të Tij.

Besimi është një nevojë për njeriun. Për këtë arsye, gjatë gjithë historisë, në të gjitha shoqëritë ka ekzistuar besimi dhe jeta fetare dhe asnjëherë nuk është parë ndonjë shoqëri pa ndjenja fetare e pa besim fetar. Ekzistenca e idhujve dhe faltoreve në gjetjet arkeologjike të periudhave të lashta nxjerr në shesh ekzistencën e jetesës fetare edhe në kohët e vjetra.

Në librat e shenjtë të feve hyjnore bëhet e qartë ekzistenca e fesë bashkë me njeriun e parë. Në librat e shenjtë shprehet qartë se Hz. Ademi, njeriu i parë, ishte njëkohësisht edhe një profet i ngarkuar me detyrë nga ana e Zotit. Dhënia e detyrës së profetit njeriut të parë nga ana e Allahut tregon se feja ka ekzistuar që me njeriun e parë.

Feja është e nevojshme që njeriu të jetojë i lumtur dhe i qetë, sepse besimi dhe adhurimi i japin njeriut qetësi.

Feja bën të mundur që njerëzit të jetojnë në paqe e siguri, sepse feja ndalon të këqijat e padrejtësitë si krimi, mëria, gënjeshtria e mashtrimi dhe urdhëron dashurinë, respektin, ndihmën e përbashkët, ndershmërinë dhe sjelljen e mirë mes njerëzve, kërkon që njerëzit të shkojnë mirë me njëri-tjetrin e të kenë respekt për të drejtat e njëri-tjetrit, këshillon jetesën në paqe. Njerëzit janë të lumtur dhe të qetë kur zbatojnë urdhëresat e fesë dhe largohen prej gjërave që ajo ndalon, nuk i bëjnë padrejtësi njëri-tjetrit, nuk mbajnë mëri, nuk tregojnë armiqësi, por sillen ndaj njëri-tjetrit me drejtësi, tregojnë respekt ndaj lirive dhe të drejtave të njëri-tjetrit. Kështu, shoqëria fiton qetësi, siguri dhe lumturi.

### **Lexim letrar** **Rëndësia e fesë**

Feja është një institucion që i bashkon njerëzit në shprehi e ndjenja të shenjta dhe që e zhvillon dhe e ngrre lart shoqërinë. Feja është një rend jetese që i drejton njerëzit dhe i shtyn ata për të bërë gjëra të mira e të dobishme edhe aty ku ligjet s'arrijnë ta bëjnë këtë, sepse feja është kundër çdo të keqeje, padrejtësie e paligjshmërie dhe i ndalon ato.

Feja ka për qëllim të mbrojë rendin shoqëror. Në histori është parë ekzistenca e shoqërive të dobëta ekonomikisht e materialisht, por nuk është parë vazhdimi i ekzistencës të shoqërive me ndjenja fetare të dobëta e të shkatërruara moralisht. Dobësimi i ndjenjave fetare sjell me vete edhe fajet morale e penale, sepse, ku mungon feja, mungon edhe forca vepruese e moralit, merr fund kuptimi e *ndaluar* - e *lejuar* (haram - hallal), tronditet rendi shoqëror, shfaqet çrregullimi dhe, si rezultat, fillojnë vështirësi të ndryshme. Por kur njeriu beson në ekzistencën e një Krijuesi që e kontrollon atë kudo, gjithmonë zgjedh të mirën e përpiqet t'i largohet të keqes.

## 2. NJOHURI TE PERGJITHSHME MBI FETE

Feja është dërguar nga ana e Allahut. Ndërkaq, me kalimin e kohës, njerëzit janë larguar nga feja që iu ka dërguar Allahu dhe kanë formuar besime të ndryshme, të bazuara në mendimet e veta. Si rrjedhojë, kanë lindur fe të ndryshme me burim njerëzor. Nga ky vështrim, fetë ndahen në dy grupe:

**a. Fetë hyjnore:** Fetë e dërguara nga Allahu me anë të profetëve. Këto janë hebraizmi, krishterizmi dhe islami.

**b. Fetë johyjnore:** Fetë e formuara nga njerëzit duke u bazuar në idetë e veta. P. sh., budizmi, taoizmi, zoroastrizmi janë fe johyjnore.

## 3. HEBRAIZMI

Hebraizmi është nga fetë që ka dërguar Allahu i Lartë.

Profeti i hebraizmit është **Hz. Musai (Moisiu)**, kurse libri i shenjtë i zbritur për të është **Teurati (Dhjata e Vjetër)**.

Prifti i hebrenjve quhet **rabin**, faltorja e tyre quhet **sinagogë**.

Hebrenjtë e quajnë të shtunën ditë të shenjtë, prandaj s'punojnë sepse besojnë se këtë ditë duhet ta kalojnë me adhurim.

Adhurimet e hebrenjve janë ditore dhe javore. Falja bëhet nën drejtimin e rabinit dhe duke u kthyer nga faltorja **Aksa** që ndodhet në Jerusalem.

Parimet themelore të hebraizmit janë **Dhjetë Porositë** që Zoti ia bëri të ditura Moisiut në malin **Sina**. Dhjetë Porositë janë këto:

- Jam unë, Zoti, që të nxora ty nga shtëpia e robërisë në vendin e Egjiptit.
- Nuk do të kesh zot tjetër veç Meje, nuk do të adhurosh asnjë send tjetër në zbrazëti, nën tokë apo mbi tokë dhe në thellësitë e detit.
- Nuk do ta marrësh në gojë kot së koti emrin e Zotit.
- Gjithmonë do ta kujtosh ditën e shtunë e do ta shenjtërosh atë. Gjashtë ditët e javës do të punosh, të shtatën do të bësh pushim.
- Do të respektosh prindërit.
- Nuk do të vrasësh.
- Nuk do të bësh imoralitet.
- Nuk do të vjedhësh.
- Nuk do të bësh dëshmi të gënjeshtërt.

- Nuk do t'i vësh syrin asnjë gjëje që nuk të përket.

#### 4. KRISHTERIZMI

Njëra prej feve hyjnore është edhe krishterizmi. Profeti i krishterizmit është **Hz. Isai (Jesui)**, kurse libri i shenjtë i zbritur atij është **Ungjilli**.

Ungjilli u hodh në shkrim dhe u shumua shumë kohë pas Hz. Isait (**Krishtit**). Në vitin 325 e.r. perandori i Bizantit, Kostandini, bëri një mbledhje në Nicë ku katër prej ungjijve u pranuan të saktë: Mateu, Marku, Luka dhe Joani.

Faltoret e krishterëve janë kishat dhe katedralet. Klerikët krishterë quhen papë, prift, murg, patrik, etj.

##### **Parimet besimore të krishterizmit**

Besimi te Zoti në krishterizëm mbështetet në një themel tresh; Ati, Biri, Shpirti i Shenjtë. Ky besim i krishterizmit quhet *trinitet*.

Ndërkaq, besohet se, në një kohë të afërt me kiametin, katastrofën e përgjithshme, Krishti do të zbresë sërish në tokë dhe do ta plotësojë detyrën e tij. (Besimi në Mesihun).

Krishterët besojnë se çdo njeri lind mëkatar. Për këtë arsye, çdo fëmijë që lind e çojnë në kishë te prifti për ta kunguar.

Priftërinjtë kanë të drejtë ta pranojnë dikë në fe ose ta përjashtojnë prej saj. Gjithashtu, ata mund t'ua falin mëkatet njerëzve në emër të Zotit.

Për krishterët, e diela është ditë e shenjtë dhe këtë ditë ata shkojnë në kishë ku falen dhe rrëfehen.

Në krishterizëm ka një kuptim moral dhe parime morale të caktuara. P.sh., në krishterizëm, dashuria për Zotin dhe njerëzit është një parim, sepse dashuria është thelbi i Zotit.

Krishterët kanë adhurimet e tyre fetare ditore, javore dhe vjetore. Adhurimet ditore bëhen duke lexuar në mëngjes e mbrëmje pjesë nga Ungjilli dhe duke kënduar këngë fetare. Adhurimet javore bëhen të dielave në kishë, nën drejtimin e priftit. Kurse ritet vjetore bëhen në ditë festash ose përkujtime, si krishtlindjet dhe pashkët.

## 5. ISLAMI

Islami është feja e fundit që Allahu i Lartë i ka dërguar njerëzimit.

Profeti i islamit është **Hz. Muhammedi** (a.s.), kurse libri i shenjtë është **Kur'ani**.

Feja islame është e gjithëbotshme. Kur'ani i është zbritur gjithë njerëzimit; po kështu, Muhammedi është dërguar si profet për të gjithë njerëzimin. Lidhur me këtë çështje, Hz. Muhammedi (a.s.) ka thënë: “Unë jam profeti që Allahu i Lartë ia ka dërguar gjithë njerëzimit...”

Faltoret e muslimanëve janë *xhamitë* dhe *mesxhidet*.<sup>1</sup>

Sipas besimit islam, Allahu është një dhe është Zoti i çdo krijese. Ekzistenca e Allahut nuk ka as fillim, as fund. Ai nuk ia ka nevojën askujt dhe asgjëje. Allahu sheh dhe di gjithçka dhe dëgjon çdo zë. Atë që dëshiron, e krijon në formën që dëshiron. Allahu zotëron fuqi të pasosur.

Sipas besimit islam, *profetët* janë njerëz të zgjedhur të ngarkuar nga ana e Allahut me detyrën për t'u kumtuar njerëzve *Fjalën Hyjnore*, urdhrat dhe ndalimet hyjnore. Librat e shenjtë, *Teurati* (Dhjata ose Testamenti), *Zeburi* (Psalmet), *Ungjilli* dhe *Kur'ani* janë zbritur nga ana e Allahut. Në islam ekziston edhe besimi në *engjëjt*, në *ringjalljen* (*ahiretin* ose ringjalljen pas vdekjes, gjykimin dhe jetën e pasosur) dhe në *kaderin* ose fatin e paracaktuar.

Sipas fesë islame, njerëzit lindin pa mëkate, të pafajshëm, sepse askush nuk mund të bëhet përgjegjës për fajet ose mëkatet e të tjerëve.

Mëkatet e njerëzve mund t'i falë vetëm Allahu. Askush tjetër nuk ka të drejtën t'ua falë njerëzve mëkatet apo t'i nxjerrë ata nga feja.

Islami nuk njeh mes njerëzve dallime apo epërsi fisnore, klase, posti, pasurie apo race. Islami u jep shumë rëndësi drejtësisë, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, moralit të mirë dhe pastërtisë, urdhëron njerëzit që në çdo punë të sillen ndershmërisht e të respektojnë të drejtat e të tjerëve, kërkon që njerëzit të jenë të moralshëm e të pastër.

Islami u jep një rëndësi të veçantë arsyes dhe dijes dhe e quan detyrë të çdo muslimani nxënien e diturisë.

Islami i urdhëron njerëzit të punojnë edhe për këtë botë, edhe për botën tjetër. Puna e pastër dhe e ndershme, fitimi me të drejtë, pra, hallall, i bekuar, quhen adhurim në islam.

---

<sup>1</sup> Xhami (nga arabishtja: shumë, grumbull, bashkim): vendmbledhjeje, vendgrumbullimi. Xhamia si mjedisi ku mbledhen muslimanët për adhurim, ka një ndërtim arkitekturor me tipare të caktuara. Jo çdo ndërtesë mund të quhet xhami.

Mesxhid (nga arabishtja: vendsexhdeje, vend për t'u falur): quhet çdo ndërtesë apo mjedis (dhomë, sallon) që plotëson kushtet për të falur namaz dhe përdoret për këtë qëllim. (Shën. I përkthyesit)

## 6. LUTJA E “ETTEHIJJATU” DHE KUPTIMI I SAJ

التحيات لله والصلوات والطيبات. أَسْلَامٌ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ، أَسْلَامٌ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ.

### **Kuptimi:**

Të gjitha adhurimet e bëra me gojë, trup e pasuri i përkasin vetëm Allahut! O i Dërguar i Allahut! Mëshira, begatia dhe paqja e Allahut qofshin për ty! Paqja e Allahut qoftë mbi ne e mbi robtë e Tij të mirë! Dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi është robi dhe i Dërguari i Tij!

## PERMBLEDHJE

1. Ç'është feja? Shpjegojeni shkurt.
2. Cilat janë fetë hyjnore?
3. Cilat janë parimet themelore të besimit hebreist?
4. Cili është libri i shenjtë i krishterizmit? Kush është profeti?
5. Si quhet libri i shenjtë i islamit? Kush është Profeti?

## PJESA II

### PARIMET DHE PERGJEGJESITE BESIMORE-ADHURIMORE NE ISLAM

#### ÇESHTJET

1. Ç'ESHTË BESIMI?
2. PERSE BESOJME?
3. KUSHTET E BESIMIT
4. DISA PREJ DETYRAVE TONA MORALE
5. Ç'ESHTË ADHURIMI?
6. PERSE BEJME ADHURIM?
7. Ç'PERFITIME NA SJELL ADHURIMI?
8. LUTJET "ALLAHUMME SAL-LI", "ALLAHUMME BARIK" DHE KUPTIMET E TYRE

#### PUNE PERGATITORE

1. Kërkoni të mësoni kuptimin leksikor dhe terminologjik të fjalës **besim**.
2. Ç'detyra kemi para Allahut, Profetit dhe Kur'anit? Mësojini duke pyetur të mëdhenjtë.
3. Ç'përfitime na sjellin adhurimet për trupin dhe shpirtin tonë?
4. Si priten nga shoqëria sjelljet e gabuara te personi?

## 1. Ç'ESHTË BESIMI?

**Besim** (iman), si kuptim fjale, do të thotë bindje e fuqishme dhe e palëkundur në qenien dhe drejtësinë e diçkaje. Kurse si term në islam, besimi është bindja në vërtetësinë dhe drejtësinë e Allahut dhe gjithçkaje të zbuluar<sup>2</sup> Hz. Muhammedit (a.s.) nga ana e Allahut. Kjo është shkalla e parë e besimit. Besimi shprehet me gojë dhe vërtetohet me zemër. Pra, në besim, gjuha dhe zemra e njeriut duhet të jenë një.

Njeriu lidhet sinqerisht pas asaj që beson. Prandaj njeriu mundohet ta shpjegojë në përshtatje me arsyen atë që beson. Në këto kushte, zemra e pranon në brendësi atë që beson. Kështu, besimi përforcohet edhe me arsyen. Sepse besimi nuk arrihet me detyrim apo frikësim. Në islam, besimi është vepra e mendimit, arsyes, ndjenjës dhe dashurisë, është punë e zemrës dhe e mendjes. Prandaj në Kur'an urdhërohet: **“La ikrahe fi'd-din”, “Nuk ka detyrim në fe”** (Kur'ani, Bakara: 256). Pra, besimi arrihet me arsye, dashuri, dëshirë e dituri.

Besimi në islam shprehet shkurtimisht dhe përmbledhurazi me fjalinë: **“La ilahe il'lallah, Muhammedun Resulullah”**. Kjo fjali quhet *“Fjala e Njësisë”*. Kuptimi i saj është: “Nuk ka zot tjetër veç Allahut, Muhammedi është i dërguari i Allahut”.

## 2. PERSE BESOJME?

Njerëzit nuk mund të jetojnë pa i besuar diçkaje. Edhe ata njerëz që thonë se nuk besojnë, në të vërtetë i besojnë diçkaje, sepse besimi është një nevojë e pamënjatueshme për shpirtin e njeriut. Kjo nevojë duhet plotësuar, ndryshe, njerëzit pa besim s'gjejnë qetësi e lumturi, nuk u bëjnë dot ballë vështirësive e dhimbjeve të jetës. Besimi i jep paqe e qetësi zemrës së njeriut. Burimi i kësaj paqeje e qetësie është besimi në Allahun, Krijuesin tonë dhe të gjithësisë dhe lidhja pas Tij. Besimi në Zotin i jep njeriut siguri. Duke i besuar Allahut, ne hyjmë nën mbrojtjen e Tij të sigurtë, sepse Ai është Zot i botërave. Gjithçka Ai e krijon dhe e ruan. Asnjë krijesë tjetër veç Tij nuk mund ta shembë këtë rregull në gjithësi.

**Rregullin në gjithësi mund ta ndryshojë vetëm Ai i cili e ka vendosur atë, Allahu!** Kështu, lidhja pas zotëruesit të kësaj fuqie të pafundme na lidh ne pas jetës, natyrës dhe njerëzve dhe na e bën të mundur të jetojmë në paqe e qetësi.

Në çastet e vështira e të dhimbshme, në raste aksidentesh apo fatkeqësish e ndiejmë veten pa rrugëdalje. Ajo që na shpëton ne nga këto çaste të vështira, është

---

<sup>2</sup> Në arabisht është fjala “vahj” (angl. revelation), zbulesa hyjnore. Kjo fjalë përdoret edhe në Kur'an për të emërtuar mënyrën me të cilën Allahu ia përcolli Fjalën e Tij Hyjnore profetit Muhammed me ndërmjetësinë e engjëllit Xhebrail. Allahu ua ka përcjellë profetëve Fjalën e Tij me tre mënyra: me mënyrën e zbulesës, të frymëzimit e të të folurit të drejtpërdrejtë. Në Kur'an përdoret shpesh, me kuptim të përgjithshëm e të figurshëm, edhe fjala “inzal”, “zbritje”. Por në përkthimet shqip të Kur'anit si dhe në letërsinë fetare përkatëse, në vend të fjalës “zbulesë”, është përdorur gabimisht fjala “shpallje”. Ky është një gabim shumë i rëndë që e shpërftyron krejtësisht çështjen. “Shpallje” do të thotë “njoftim, lajmërim, kumtim” Ka qenë detyra e profetëve që, pasi e kanë marrë Fjalën Hyjnore, t'ua shpallin, t'ua njoftojnë, t'ua kumtojnë, t'ua bëjnë të ditur atë njerëzve. Në letërsinë fetare, detyra kumtuese e profetëve emërtohet me fjalën arabishte “teblig”. Shihni letërsinë dhe fjalorët përkatës. (Shën. i përkthyesit)

lidhja jonë me Allahun, sepse ne besojmë se, për sa kohë që të jemi të lidhur me Allahun, Ai nuk e kursen ndihmën e Tij për ne!

Njerëzit nuk mund ta zgjedhin vetë as lindjen e as vdekjen e vet. Pra, është një qenie e lartë që na sjell ne në këtë botë. Po ta kuptonim sado pak këtë rend që Allahu ka krijuar, do ta kishim më të lehtë ta besonim Atë.

Asnjë gjë nuk krijohet vetvetiu. Sepse, po të krijohej diçka vetvetiu, sërish vetvetiu do të zhdukej. Mirëpo në gjithësi nuk ka rastësi, gjithçka ekziston brenda një rregullsie të caktuar. Është ky kuptim rregull që i shtyn njerëzit në besim. Në Kur'an na kërkohet të mendojmë mbi krijimin e maleve, deteve, natës e ditës. Sërish Kur'ani na urdhëron që të bëjmë kërkime mbi bimët, kafshët e njerëzit, na fton që të mendojmë thellë mbi ekzistencën tonë. Në këtë mënyrë, duke bërë kërkime mbi dukuri e qenie të ndryshme, do të na forcohet edhe më tepër besimi te Allahu. Duke njohur më mirë forcën e Tij, do të na shtohet më shumë lidhja e dashuria për Të.

### **3. KUSHTET E BESIMIT**

Allahu vazhdimisht u ka treguar udhë njerëzve në çështjen e besimit dhe këtë e ka bërë me anë të profetëve, të dërguarve të Tij. Kjo është një mirësi, një dhunti e madhe e Tij për ne. Parimet e besimit që na ka kumtuar profeti i fundit, Hz. Muhammedi (a.s.), janë:

1. Besimi në ekzistencën dhe njësinë e Allahut.
2. Besimi në engjëjt e Allahut.
3. Besimi në librat e Allahut.
4. Besimi në profetët e Allahut.
5. Besimi në Ditën e Ringjalljes.
6. Besimi në kaderin, se e mira dhe e keqja krijohen nga Allahu.

### **4. DISA NGA DETYRAT TONA MORALE**

#### **a. Detyrat tona para Allahut**

Allahu na ka krijuar e na ka dhënë jetë. Gjithashtu ka krijuar mirësi të panumërta për të përballuar nevojat tona të ndryshme. Ne kemi shumë detyra para Allahut të Lartë që është Krijuesi i gjithçkaje. Disa prej tyre mund t'i rrjeshtojmë kështu:

1. Duhet ta bëjmë si duhet detyrën që kemi si rob, si krijesa të Allahut: duhet ta falenderojmë dhe ta adhurojmë Atë. Duhet të zbatojmë urdhrat e Tij.

2. Duhet ta duam Allahun më fort se gjithçka. Duhet ta përmendim shpesh Atë.



3. Duhet t'ua dimë vlerën të mirave që na ka dhënë Allahu. Nuk duhet të jemi mosmirënjohës ndaj Tij.

4. Duhet të zbatojmë urdhëresat dhe ndalesat e Allahut dhe duhet t'i këshillojmë edhe të tjerët për këtë gjë.

Kur i zbatojmë si duhet detyrat ndaj Allahut, Ai kënaqet me ne. Këtë kënaqësi Allahu e tregon duke u dhënë paqe e qetësi njerëzve që e përmendin Atë. Kjo parashtrohet edhe në ajetin e mëposhtëm: **“Pra, më përmendni ju mua që dhe Unë t’ju përmend ju...”** (Kur’ani, Bakara: 152).

#### **b. Detyrat tona para Profetit**

Profeti ynë ka punuar gjatë gjithë jetës së tij për qetësinë dhe shpëtimin e njerëzve, ua ka mësuar njerëzve Allahun, Librin dhe fenë e Tij pa mangësi, ka qenë shembull me mënyrën e tij të jetesës. Për këtë, në Kur’an Allahu ka thënë: **”... Ai është shembulli më i mirë për ju.”** (Kur’ani, Ahzab: 21).

Duhet ta duam shumë Profetin tonë. Që ta duam atë, duhet ta njohim shumë mirë. Duhet ta lexojmë jetën e Tij, duhet të mendojmë mbi vuajtjet që ka hequr dhe vështirësitë që ka kaluar. Duhet ta mbushim zemrën me dashurinë për të.

**Duhet ta marrim shembull Profetin tonë. Por nuk duhet të imitojmë veprimet e tij padituriisht. Duhet ta kërkojmë e ta kuptojmë shumë mirë se çfarë ka bërë e pse e ka bërë. Atëherë do ta kuptojmë më mirë se sa e dobishme është ta marrim Atë si shembull e do ta përvetësojmë më së miri moralin e Tij.**

Si tregues i dashurisë që kemi për Profetin, përmendjen e emrit të tij duhet ta shoqërojmë me *salavat*, me lutjen që Allahu ta rrethojë me mëshirën e Tij të pafundme!

#### **c. Detyrat tona para Kur’anit**

Allahu e ka dërguar Kur’anin që njerëzit të largohen nga rruga e gabuar dhe të gjejnë të vërtetën. Kur’ani u mëson njerëzve besimin, adhurimin, moralin e mirë, marrëdhëniet mes tyre. Duhet ta lexojmë Kur’anin e duhet të zbatojmë urdhrat dhe ndalesat e tij. Kur’ani është fjala e Allahut, për këtë arsye, është i shenjtë.

Në Kur’an ka ajete që tregojnë rëndësinë e leximit dhe mendimit. Edhe urdhri i parë që Allahu i lartë i dërgoi Profetit tonë, është **“Lexo!”** Prandaj feja islame i ka dhënë rëndësi të madhe kërkimit në fushën e dijes, mësimin dhe diturisë.

Duhet ta mësojmë e ta marrim shembull moralin e lartë që ka sjellë Kur’ani. Kur ta marrim në dorë Kur’anin, duhet të jemi me abdest dhe duhet ta respektojmë gjithmonë atë. Duhet ta zbatojmë urdhrin: **“Kur lexohet Kur’an, rrini në qetësi dhe dëgjojeni atë!”** (Kur’ani, A’raf: 204).

## 5. Ç' ESHTË ADHURIMI?

*Adhurim* do të thotë të përulësh e të tregosh bindje ndaj atij që adhuron, të bësh ato gjëra që Zotit tonë i pëlqejnë e të heqësh dorë nga ato që nuk i pëlqejnë. Nivelin e besimit tonë ndaj Allahut e tregojnë punët dhe sjelljet tona. Prandaj na duhet të dimë se ç'gjëra i pëlqejnë Allahut e cilat, jo.

Adhurimet kryhen duke bërë më parë *nijet*. *Nijet* do të thotë *qëllim i paracaktuar*. Pra, *të bësh nijet për një gjë*, do të thotë *ta përcaktosh atë gjë si qëllim qysh më parë*. Adhurimi vlerësohet sipas nijetit. **Nuk ka adhurim pa nijet!** Madje edhe veprimet tona të tjera e marrin vlerën sipas nijetit tonë të mirë apo të keq!

Ndërkaq, adhurim është jo vetëm të falësh namaz, të agjërosh e të shkosh në haxh. Edhe punë të tjera si leximi, mësimi, sigurimi i drejtësisë janë adhurim. Njeriu që punon për të fituar me djersën e ballit, domethënë hallall, njerëzit që shkojnë mirë me njëri-tjetrin, gjithashtu, bëjnë një lloj adhurimi.

Personi që i kryen rregullisht adhurimet fetare, edhe punët e tjera nuk i lë mangut. Ai nuk e braktis këtë jetë për jetën tjetër, as jetën tjetër për këtë jetë, por ruan drejtpeshimin e duhur mes tyre! Ai i lutet kështu Zotit: “Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë e në jetën tjetër!”

Adhurimet tona si muslimanë mund t'i ndajmë në tre grupe:

**a. Adhurimet trupore:** janë adhurimet e bëra me trup, si namazi dhe agjërimi.

**b. Adhurimet pasurore:** janë adhurimet e bëra me para dhe sende pasurie, si sadakaja, zeqati, kurban.

**c. Adhurime edhe trupore edhe pasurore:** janë adhurimet e bëra edhe me trup, edhe me pasuri, si haxhi, umreja, xhahadi.

## 6. PERSE BEJME ADHURIM?

Ne e adhurojmë Allahun sepse e duam. Me anë të adhurimeve, i shprehim Atij besimin, dashurinë dhe respektin tonë. Adhurimi i jep njeriut ndjenjën e sigurisë dhe e bën të ndihet mirë. Sepse njeriu nuk ka fuqi të pafund. Të pafuqishmit ndiejnë nevojën për t'u mbështetur te i fuqishmi, për të hyrë nën mbrojtjen dhe sigurinë që jep ai. Krahas kësaj, çdo njeri ka nevojë për dashurinë dhe interesimin e të tjerëve për të. Allahu i Lartë është burimi i dashurisë e i fuqisë. Ai është i vetmi te i cili ndihemi plotësisht të sigurt. Besimi se është Ai që na ruan, na rrit besimin në vetvete. Dhe ky besim në vetvete na ndihmon t'i kryejmë punët tona më mirë e më qetë.

Qëllimi i fesë që Allahu ka dërguar me anë të profetëve, është t'i sigurojë njeriut lumturinë hyjnore si në këtë botë, edhe në botën tjetër. Ta njohësh Allahun e ta adhurosh Atë është rruga që të çon te ky qëllim. Në suren *Dhariat*, ajeti 56, Allahu urdhëron: **”Unë i krijova njerëzit dhe xhindët vetëm që të më adhurojnë mua.”**

Ashtu siç nuk ka nevojë për asgjë tjetër, Allahu nuk ka nevojë as për adhurimet tona. Ne i kryejmë adhurimet për t'i shprehur Allahut dashurinë e respektin që ndiejmë për Të e për të përmbushur detyrën tonë si rob të Tij.

Një njeri që beson, ndien nevojën për të bërë adhurim si domosdoshmëri e besimit të tij. Njeriu i cili e plotëson këtë nevojë duke e adhuruar Allahun që e ka krijuar e që ia ka dhuruar çdo gjë që ka në dorë, është i qetë e i lumtur!

Me anë të adhurimeve e ndiejmë veten më afër Allahut, i kërkojmë ndihmë e mëshirë drejtpërsëdrejti, pa asnjë ndërmjetës. Përmes adhurimeve ndiejmë lumturinë dhe kënaqësinë e fitimit të dashurisë së Tij!

Adhurimi është një formë falenderimi ndaj mirësive të Allahut. Mes gjithë mirësive të Allahut, jeta është, pa dyshim, mirësia më e madhe! Përsa kohë të jetë gjallë, njeriu duhet të bëjë adhurim si përgjigje ndaj kësaj mirësie. Në Kur'an thuhet: **“Adhuroje Zotin tënd gjersa të të vijë vdekja!”** (Kur'ani, Hixhr: 99)

Edhe shpërblimin e një jete të tillë të kaluar me adhurim e falenderim, nga Kur'ani e mësojmë:

**“Për sa u përket atyre që besuan e kryen vepra të mira, ata janë më të vlefshmit e njerëzve. Shpërblimi i tyre tek Zoti i tyre është xhenneti Adn ku rrjedhin lumenj e ku ata do të jenë përgjithmonë!”** (Kur'ani, Bejjine: 7-8)

**“E do t'u thuhet: “Ja xhenneti për ju! Ju u bëtë trashëgues të tij si shpërblim i veprave të mira që kryet!”** (Kur'ani, A'raf: 43)

## 7. Ç'PERFITIME NA SJELL ADHURIMI?

Kushti themelor për të qenë musliman është një besim i sinqertë dhe i shëndoshë, i pastruar prej të gjitha dyshimeve. Që adhurimet e bëra të pranohen nga Allahu, nevojitet, më së pari, besim. Ndërkaq, mbrojtja, vazhdimësia dhe fuqizimi i besimit janë të mundura vetëm me adhurim. Ndryshe, besimi pa adhurim është i dënuar të marrë fund!

Personit që i bën adhurimet me gjithë shpirt, i forcohet besimi, zemra i pastrohet nga ndjenjat, qëllimet e mendimet e këqia, morali i zbukurohet!

Në adhurimet ka shumë dobi për shpirtin dhe trupin tonë:

Adhurimet na mësojnë të bëjmë një jetë të rregullt, na përftojnë shprehitë e pastërtisë, na e mbushin zemrën me kënaqësi e lumturi që i lexohet njeriut në sy. Ndoshtu kështu sepse pastërtia dhe shëndeti i trupit i japin zemrës qetësi. Ndërkaq, largimi i mendimeve të këqia dhe qetësia e zemrës na japin mundësi t'i bëjmë adhurimet më me sinqeritet e, kështu, të lidhemi më fort pas Zotit!

**Namazi** na bën që të fitojmë pëlqimin e Allahut tonë të Lartë. Na fal dashurinë e engjëjve. Bëhet shkak që të na pranohen lutjet. Është çelësi i xhenetit. Pjekuria,

rehatia, qetësia e afrimi me Allahun që fitohen me namaz, nuk i sjell asnjë adhurim tjetër.

**Agjërimi** forcon durimin e vullnetin që janë të domosdoshëm në luftën për jetën, na mban larg nga dëshirat e zakonshme trupore, na e forcon karakterin e na e përsos moralin. Është shërim për shumë sëmundje materiale e shpirtërore. Agjërimi zhvillon, mes atyre që mbajnë agjërim së bashku e festojnë bajramin së bashku, ndjenjat e bashkimit e të vëllazërisë. Kështu agjërimi, i cili zgjat ditë të numëruara, i përfton jetës sonë të shkurtër thellësi, brishtësi dhe hijeshi.

**Zeqati** e ruan njeriun nga kopracia, zhvillon te ai ndjenjat e bujarisë e të ndihmesës, forcon lidhjet mes të pasurit e të varfrit, zhvillon ndjenjat e mëshirës dhe dhembshurisë.

Me anë të adhurimit forcojmë vullnetin, përdorim më mirë mendjen, zotërojmë më mirë ndjenjat tona. E mundim më lehtë zemërimin. Shpëtojmë nga sjelljet e tepruara, bëhemi më të rregullt në jetën e përditshme.

Në sajë të adhurimit, i zbatojmë më me përpikmëri vendimet që marrim. Kjo bën që sjelljet tona të jenë më të qëndrueshme. Për shembull, një njeri që bën adhurim rregullisht, e ruan dhe e shmang veten më lehtë nga të këqijat si alkooli, kumari, droga, etj. Një zë i brendshëm e paralajmëron atë për rrugën e keqe, i jep atij qëndresë, pastaj i bëhet pengesë së keqes. Si përfundim, ne bëhemi më të moralshëm.

Adhurimet zhvillojnë te njeriu ndjenjat e durimit, falenderimit, bujarisë, edukatës dhe ndihmesës.

Adhurimet na ndihmojnë të mendojmë saktë e të jetojmë në mënyrë të moralshme, sepse gjatë adhurimeve e ndiejmë vazhdimisht Allahun në zemër. Kjo gjë edhe na jep qetësi shpirtërore, edhe bën të mundur që të fitojmë pëlqimin e Allahut.

Duke bërë adhurim, ne përgatitemi për jetën tjetër. Lumturohemi dhe gjejmë qetësi shpirtërore. Duhet të përpiqemi të bëjmë adhurim në mënyrë të vazhdueshme duke e kuptuar këtë si një detyrën tonë!

## Lexim letrar

### Si i këshilloi Profeti ata që hiqnin dorë prej të mirave të kësaj bote

Një ditë, një grup prej sahabëve, shokëve dhe ndjekësve të Profetit, bisedojnë mes tyre mbi masat që duheshin marrë për t'u ruajtur nga zjarri i xhehenemit dhe vendosin njëzëri që *“ditën ta kalojnë me agjërim dhe natën me falje si dhe të heqin dorë prej nevojave të tilla si ngrënia e mishit, fjetja në shtrat dhe jeta familjare”...*

Pas kësaj, ata shkojnë te shtëpia e Profetit dhe i pyesin njerëzit e tij për adhurimet që bënte ai në shtëpi. Kur familja e shenjtë e Profetit iu tregojnë për adhurimet që Profeti kryente në shtëpi, ata, sikur ato adhurime t'u dukeshin fare pak, thonë:

*“Kush është Profeti e kush jemi ne! Allahu ia ka falur atij gjithë mëkatet e shkuara e të ardhshme, prandaj atij edhe pak adhurim i mjafton!”*

Njëri prej tyre hidhet e thotë:

*“Tash e mbrapa, gjatë gjithë jetës, unë çdo natë do ta kaloj me namaz!”*

Një tjetër thotë:

*“Edhe unë, gjatë gjithë jetës, për ditë do të agjëroj, asnjë ditë nuk do ta prish agjërimin!”*

Edhe i treti, po kështu:

*“Unë do të largohem prej grave përgjithmonë, asnjëherë nuk do të bashkëjetoj me to!”*

Më pas, kur Profeti e mësoi si ishte puna, i gjeti ata dhe u tha kështu:

*“Ju paskeni thënë kështu e kështu! Beto hem në Allahun se unë jam mes jush ai që e njuh më mirë Allahun, që e ka më shumë frikë Allahun e që ruhet më shumë prej gjërave të ndaluara prej Allahut! Megjithatë, unë disa herë agjëroj e, disa herë, ha; edhe falem, edhe fle; bashkëjetoj me gratë e krijoj familje. Ky është sunneti im! E kush i kthen shpinën sunnetit<sup>3</sup> tim, nuk është nga radhët e mia!*

Pas kësaj, shokët e tij hoqën dorë nga një jetë e tillë.

---

<sup>3</sup> Sunneti: tradita profetike, tërësia e thënieve, sjelljeve dhe veprimeve të Profetit.

## KESHILLA

**E mesmja është më e dobishmja e punëve.**

**Është më i dobishëm adhurimi i paktë por i vazhdueshëm.**

As nuk janë vlerësuar e as nuk janë këshilluar punët e shumta por të përkohshme. Një veprim që ka vazhdimësi, edhe po të jetë pak, është shprehje sistemi e disipline. Sistemi e disiplina japin siguri e të çojnë në rezultat. Veprimtaria e Profetit i ngjan shiut të lehtë që bie pa ndërprerë.

**Është e dobishme që adhurimet të bëhen me maturi.** Duhet të ruhem nga teprimi. Sepse, siç dihet, po të mos ishin bamirësia, mëshira dhe falja e Allahut, askujt nuk do t'i mjaftonte puna e vet për t'u ruajtur prej zjarrit!

**Allahu i Lartë asnjëri nuk i ngarkon më tepër se ç'mund të mbajë!**

**Në islam nuk ka murgëri.** Të largohesh nga njerëzit e të mbyllesh në një kënd për të bërë adhurim, të rrish pa gjumë, të agjërosh aq sa kjo të bëhet shkak për dobësimin e trupit, të largohesh nga jeta familjare, të gjitha këto janë sjellje që bien në kundërshtim me natyrën e njeriut e që s'kanë vend në islam.

**Muslimani i jep kujt do të drejtën që i takon.** Mbi personin ka të drejta Allahu, familja, fëmijët dhe vetja e vet. Njeriu ka nevojë për gjumë, për ushqim, për jetesën e përbashkët shoqërore e familjare.

## 8. LUTJET “ALLAHUMME SAL-LI”, “ALLAHUMME BARIK” DHE KUPTIMI I TYRE

اللهم صل على محمد و على آل محمد كما صليت على إبراهيم و على آل إبراهيم إنك حميد مجيد.

**Kuptimi:**

”Allahu im! Mëshiroje Muhammedin dhe familjen e tij sikur ke mëshiruar Ibrahimin dhe të afërmit e tij! Pa dyshim, Ti je i vetmi që meriton lëvdatat, Ti je i Famshëm e i Përlavdëruar!”

اللهم بارك على محمد و على آل محمد كما باركت على إبراهيم و على آل إبراهيم إنك حميد مجيد.

### **Kuptimi:**

“Allahu im! Begatoje Muhammedin dhe familjen e tij sikur ke begatuar Ibrahimin dhe të afërmit e tij! Pa dyshim, Ti je i vetmi që meriton lëvdatat, Ti je i Famshëm e i Përlavdëruar!”

### **PERMBLEDHJE**

1. Cilat janë kushtet e besimit?
2. Cilat janë detyrat që kemi para Allahut? Shpjegojini shkurtimisht.
3. Cilat janë detyrat që kemi para Profetit?
4. Cilat janë detyrat që kemi para Kur'anit?
5. Ç'është adhurimi? Përse bëjmë adhurim? Shpjegojeni shkurt.
6. Cilat janë të mirat që na sjell adhurimi?
7. Thuajeni Fjalën e Dëshmisë.

### **PJESA III PASTERTIA DHE NDERSHMERIA NE ISLAM**

#### **ÇESHTJET**

1. PASTERTIA
2. NDERSHMERIA DHE DOBIA E SAJ
3. ABDESTI I TRUPIT, ABDESTI I NAMAZIT DHE TEJEMMUMI
4. EZANI DHE KUPTIMI I TIJ

#### **PUNE PERGATITORE**

1. Ç' kuptoni kur thuhet *pastërti shpirtërore*?
2. Diskutojeni me shokët rëndësinë e pastërtisë për shëndetin e njeriut.
3. Pyetini më të rriturit si merret abdesti dhe abdesti i trupit (gusuli).



## 1. PASTERTIA

Pastërtia është kushti i parë që të jemi e të jetojmë të shëndetshëm. Pranimi i adhurimeve dhe ruajtja e shëndetit janë të lidhura me pastërtinë. Për këtë arsye, feja jonë e lartë i ka dhënë shumë rëndësi pastërtisë. Kur'ani dhe Profeti ynë e kanë vlerësuar shumë pastërtinë. Në Kur'an urdhërohet kështu:

**“Allahu zbret nga qielli shiun që ju të pastroheni me të!”** (Kur'ani, Enfal: 11)

**“Dhe veshjen tënde mbaje (gjithmonë) pastër!”** (Kur'ani, Muddeththir: 4)

Një musliman s'mund të dalë në prani të Allahut pa u pastruar; që të bëjë adhurim, ai është i detyruar të jetë fizikisht e shpirtërisht i pastër. Pranimi i adhurimeve tona dhe dashuria e Allahut për ne janë të lidhura me qenien tonë të pastër. Për këtë arsye, një musliman që do të falë namaz, duhet së pari të jetë i pastër e të marrë abdest.

Profeti ynë i ka kushtuar rëndësi sidomos pastërtisë trupore, dhe ka kërkuar që të tregohet kujdes i veçantë për pastërtinë e gojës, dhëmbëve, duarve e fytyrës. Si në çdo gjë, edhe në pastërti ai është shembulli më i mirë!

Në Kur'an Allahu na bën të ditur se Ai i do ata që pastrohen. Fitimi i dashurisë së Allahut dhe ruajtja e shëndetit janë të mundura vetëm duke zbatuar urdhrat dhe këshillat e fesë sonë.

Po aq rëndësi sa ç'i ka dhënë feja jonë pastërtisë së jashtme, i ka dhënë edhe asaj të brendshme. Pastërtinë e studiojmë në tre pjesë: pastërti morale, pastërti fizike dhe pastërti e mjedisit.

### a. Njeriu i pastër moralisht

Pastërtia morale është pastërtia e brendshme. Pastërti e brendshme do të thotë pastërti e ndjenjave dhe mendimeve tona.

**Zemrën** duhet ta pastrojmë nga të gjitha ndjenjat e këqia. Duhet të përpiqemi të mos ushqejmë në vetvete asnjë ndjenjë të keqe. Duhet t'u rrimë larg mërisë e urrejtjes. S'duhet të kemi smirë për të tjerët. Përkundrazi, duhet t'i duam e t'i ndihmojmë të tjerët e të ushqejmë ndjenja të mira për ta. Sepse smira e ha dhe e shkatërron njeriun nga brenda sikurse krimbi gërryen e prish një pemë...

**Mendimet** duhet t'i mbajmë gjithnjë të pastra, duhet të mendojmë e të bëjmë gjëra të mira. Çdo gjë duhet ta trajtojmë me qëllim të mirë. Duhet të lexojmë shumë e të nxëmë shumë dije.

Kur t'i bëjmë **adhurimet** me sinqeritet e pastërti shpirtërore, ndjenjat e bukura do të na zhvillohen, morali do të na zbukurohet!

### b. Njeriu i pastër trupërisht

Pastërtia e trupit arrihet duke u larë shpesh. Po të mos e mbajmë trupin të pastër, mund të na kapin lloj-lloj sëmundjesh.

Pastërtia e trupit na kërkon që t'i pastrojmë me kujdes gojën dhe dhëmbët. Duhet ta bëjmë shprehi që t'i lajmë dhëmbët pas çdo ngrënieje, sepse shkakut i shumë sëmundjeve janë prishjet e dhëmbëve dhe mikrobet që prodhohen në ta.

Islami i ka dhënë shumë rëndësi pastërtisë trupore. Profeti ynë e ka vlerësuar shumë pastërtinë dhe është bërë shembull për njerëzit. Ai u ka kërkuar muslimanëve të jenë të pastër e të shkojnë të pastër në xhami. Veçanërisht ka theksuar higjienën e gojës e të dhëmbëve.

Larja e duarve para dhe pas çdo ngrënieje është në përshtatje me sunnetin, traditën e Profetit tonë. Gjithashtu, Kjo gjë është e domosdoshme edhe për shëndetin tonë. Duhet ta bëjmë shprehi që t'i zbatojmë këshillat e Profetit tonë.

### **c. Pse duhet ta mbajmë pastër mjedisin?**

Mjedisi është vendi ku jeton njeriu. Mjedisin mund ta përcaktojmë si mjedis të ngushtë e mjedis të gjerë. Mjedisi i ngushtë është shtëpia ku jetojmë, lagjja dhe rrugët e saj. Në traditën tonë popullore lidhur me pastërtinë e mjedisit të ngushtë, është thënë: "Po ta mbajë gjithkush pastër pjesën para shtëpisë së vet, edhe sokaku mbahet pastër!" Askush nuk do të donte të jetonte në një mjedis të ndyrë e të çrregullt, secili do të donte të largohej, të ikte që andej.

Mjedisi i gjerë është gjithë natyra që na rrethon. Malet, lumenjtë, pyjet, fushat, kullotat, arat e mbjella formojnë mjedisin e gjerë. Në ditët tona, hedhjet helmuese të fabrikave e ndyjnë gjithë mjedisin e gjerë. Kafshët ngordhin, drejtpeshimi i natyrës prishet, rregullsia e saj ndryshon. Si rrjedhojë, edhe jeta e njeriut rrezikohet!

Pastërtia e mjedisit përreth ka shumë rëndësi për shëndetin tonë fizik e shpirtëror. Mjediset plot plehra e ndyrësira janë shtrat për mikrobet e sëmundjet. Njerëzit e qytetëruar nuk e ndotin mjedisin. Ata e ruajnë atë duke e mbajtur pastër e duke u bërë pengesë për ndotjen e tij!

Ne duhet të japim ndihmesën tonë për mbajtjen pastër të mjedisit. Duhet t'u bëhemi pengesë atyre që veprojnë pa përgjegjësi dhe t'u a tërheqim vëmendjen në mënyrë të qytetëruar. Duhet t'i ndihmojmë punëtorët që ruajnë mjedisin. Duhet ta mbajmë pastër shtëpinë, shkollën, lagjen, rrugën, shkurt, gjithë mjedisin ku jetojmë e duhet të ndihmojmë për mbajtjen pastër të tij. Feja jonë urdhëron pastërtinë. Në Kur'an na kërkohet ta duam natyrën, prandaj së pari duhet të mos e ndotim atë por ta mbajmë pastër!

## **2. NDERSHMERIA DHE DOBITE E SAJ**

### **a. Ç'është ndershmëria?**

Fjala *ndershmëri* do të thotë drejtësi, moral i pastër, vërtetësi, sjellje e ndërgjegjshme në përputhje me moralin e pastër dhe drejtësinë. Ndershmëria

shprehet në sjelljen e drejtë e të ndershme të njeriut, larg prej gënjeshtërisë e dyfytërisë. Ndershmëria e njeriut në punë, sjellje e në marrëdhënie të ndryshme është një nga urdhëresat e fesë. Ndershmëri është edhe mbrojtja e të drejtave të vetvetes, edhe respektimi e mosshkelja e të drejtave të të tjerëve. Është pranimi i të vërtetave të njohura si të tilla prej gjithkujt. Është mbrojtja e ruajtja e të drejtës të tjetrit edhe kur kjo është në kundërshtim me interesin tënd. Ndershmëri është të jesh një në mendim e në veprim. Të sillesh kudo njëlloj e të mos kryesh veprime në kundërshtim me fjalët e veprimet e mëparshme.

Ndershmëria është vetia më e mirë morale që na kërkohet. Në Kur'an Allahu e urdhëron kështu Profetin tonë: **“...Ji krejt i ndershëm, ashtu si të është urdhëruar...”** (Kur'ani, Hud: 116) Ky ajet i shkurtër i kreut *Hud* i ka ngarkuar njeriut një përgjegjësi të madhe. Për këtë ajet Profeti ynë i dashur ka thënë: *“Mua më ka plakur sureja Hud.”*

Në çdo rekat të namazit ne i lutemi Zotit ashtu siç thuhet në kreun *Fatiha* të Kur'anit: **“... na shtyj në rrugën e drejtë...!”**

Njerëzit e ndershëm e të drejtë janë ata që duhen më shumë e që iu besohet më shumë në shoqëri. Njerëzit që e kanë të njëjtë fjalën me punën janë ata që respektohen, kurse gënjeshtarët, dredharakët dhe mashtruesit nuk pëlqehen nga shoqëria.

Me ndershmëri e drejtësi është e mundur të fitohen pëlqimi dhe dashuria e Allahut. Njerëzit e ndershëm që kanë fituar pëlqimin e Allahut, respektohen nga shoqëria. Edhe ne, për të fituar dashurinë e Allahut dhe për t'u bërë njerëz të respektuar nga shoqëria, duhet të zbatojmë urdhrat e shkruara në Kur'an dhe këshillat e Profetit tonë.

Profeti ynë (a.s.) ka thënë: *“ Fjala e drejtë të çon në mirësi e mirësia të çon në xhennet.”*

Të jemi të ndershëm e të drejtë për shoqërinë, për mjedisin dhe për veten tonë e kështu të jetojmë!

## **b. Kujt i thonë “njeri i ndershëm”?**

Njeriu i ndershëm është ai që ka për parim themelor ndershmërinë e të vërtetën. Njeriu i ndershëm nuk gënjen, nuk mashtron. Nuk lëviz nga fjala e nga premtimi i dhënë. Nuk dëshmon në gënjeshtëri. Ai thotë gjithmonë të vërtetën dhe nuk heq dorë prej saj edhe sikur të jetë në dëm të vet. Nuk e merr nëpër këmbë nderin dhe emrin e tij të mirë për asnjë farë interesi.

Nxënësi i ndershëm nuk kërkon dhe nuk merr diçka që nuk i takon. Për të kopjimi është një padrejtësi që ai nuk ia lejon vetes. E di se, kur mëson, merr notë të mirë. Ka besim tek zgjuarësia e vet. Nuk lejon që t'i merret nëpër këmbë nderi dhe krenaria. Nuk e prish me anë të gënjeshtrove respektin që kanë të tjerët për të. Atyre që ka përreth, iu jep besim e siguri. E di se të ndershmin të gjithë e duan.

## **c. Cilat janë dobitë e ndershmërisë?**

Ndershmëria ka shumë dobi. Njeriu i ndershëm ka besim në vetvete. Shoqëria e formuar nga njerëz të ndershëm është një shoqëri që e do ndershmërinë. Në një shoqëri të tillë nuk ka padrejtësi. Njerëzit kanë besim te njëri-tjetri. Në përgjithësi ka qetësi. Gënjeshtrarët e mashtruesit nuk kanë vend në një shoqëri të tillë.

Në një vend ku sundon ndershmëria, padrejtësitë marrin fund dhe ligësia pakësohet. Në një shoqëri të tillë, me që pakësohen moskuptimet, marrëdhëniet mes njerëzve bëhen të rregullta. Dhe kjo bën që në shoqëri të zenë vend paqja e lumturia.

Në një shoqëri ku jetojnë njerëz të ndershëm, të gjithë kanë besim te njëri-tjetri. Dhe ky besim, pastaj, bën që njerëzit ta duan dhe respektojnë njëri-tjetrin, që të forcohen shoqëria e miqësia mes njerëzve.

Gjithmonë duhet të themi të drejtën e të sillemi të ndershëm. Asnjëherë nuk duhet ta keqpërdorim besimin që ndiejnë të tjerët ndaj nesh. Qoftë edhe me shaka, kurrë nuk duhet të gënjejmë!

### **3. ABDESTI TRUPOR (GUSULI) DHE ABDESTI I NAMAZIT**

#### **a. Abdesti trupor (gusuli)**

*Gusul* do të thotë larje e plotë e trupit. Feja jonë e ka bërë të detyrueshme (farz) larjen e përgjithshme të trupit në disa kushte të caktuara.<sup>4</sup> Në Kur'an urdhërohet:

**“Në qoftë se jeni fëlliqur<sup>5</sup>, bëni gusul!”** (Kur'ani, Maide: 6)

Edhe po të mos ketë një rast të tillë, muslimani duhet ta lajë tërë trupin të paktën një herë në javë. Veçanërisht, larja trupore para se të shkohet në namazet e xhumasë e të bajramit është sunnet.

Farzet, veprimet e detyruara të gusulit janë tre:

1. Larja e gojës
2. Larja e hundës
3. Larja e gjithë trupit pa lënë asnjë vend pa lagur.

Abdesti i gusulit merret me ujë të pastër.

#### **Sunnetet e gusulit**

Të bësh nijet për gusulin, ta fillosh atë me emrin e Allahut (besmele), ta fillosh pastrimin nga ajo pjesë e trupit që përmban papastërti, të lash vendet e turpshme, të marrësh para gusulit abdest si abdesti i namazit, të derdhësh tri herë ujë mbi trup, ta fillosh hedhjen e ujit nga koka pastaj të hedhësh ujë një herë nga shpatulla e djathtë, e më pas nga e majta, të fërkohesh mirë, ta lësh larjen e këmbëve për në fund nëse mbliidhet ujë në vendin ku shkel, janë sunnete të gusulit.

<sup>4</sup> Këto kushte janë: për meshkujt dhe femrat, gjendja pas marrëdhënieve seksuale; për meshkujt, gjendja pas derdhjes së spermës nën ndikimin e ngacmuesve të ndryshëm; për femrat, të përmuajshmet dhe gjendja e lehonisë.

<sup>5</sup> Në origjinal është fjala arabishte “xhunub”. (Shën. i përkthyesit)

## **b. Abdesti i namazit**

Për të falur namazin, duhet të jemi të pastër. Para Allahut duhet të dalim të pastër. Prandaj duhet t'i mbajmë pastër trupin dhe veshjet.

## **c. Farzet, sunnetet dhe mekruhet e abdestit <sup>6</sup>**

### **Farzet e abdestit**

Edhe abdesti është një nga mënyrat e pastrimit. *Abdest* do të thotë “ujë duarsh”. Abdesti merret duke bërë nijetin për adhurim, duke larë me ujë të pastër fytyrën, duart e këmbët dhe duke fërkuar kokën.

Në ajetin 6 të sures *Maide* urdhërohet: **“O ju që keni besuar, kur të ngriheni për të falur namazin, lajini fytyrat, duart gjer në bërryla, fërkojeni kokën dhe lani këmbët bashkë me thembrat!”**

Abdesti është një adhurim fillestar ku robi (krijesa e Zotit) vërteton devotshmërinë e vet duke bërë atë që i vjen e vështirë vetes. Kështu, duke hedhur tej mpirjen shpirtërore dhe duke u gjallëruar fizikisht, vetja bëhet gati për namaz që do të thotë dalje para Zotit!

Farzet e namazit janë katër:

1. Larja e fytyrës
2. Larja e duarve bashkë me parakrahët gjer në bërryla.
3. Fërkimi me dorë të lagur i një të katërtës së kokës.
4. Larja e këmbëve bashkë me thembra gjer në nyjet.

### **Sunnetet e Abdestit**

Të bësh nijet për të marrë abdest, të fillosh me emrin e Allahut, të lash së pari duart gjer në kyçe, të pastrosh dhëmbët me misvak, furçë apo qoftë edhe me gishta, t'i lash njëri pas tjetrit, pa ndërprerje, organet që marrin pjesë në abdest, t'i fërkosh ato gjatë larjes, të marrësh tre herë ujë në gojë, ta shpëlash gojën me ujë të bollshëm kur nuk je i agjërueshëm, t'i japësh tri herë ujë hundës e ta pastrosh me dorën e majtë, t'i lash nga tri herë organet që lahen, kur lan organet që janë çift, të fillosh me të djathtin, kur lan duart e këmbët, të fillosh nga majat e gishtave, ata që kanë mjekër, ta lagin mjekrën me dorë duke e përkthuar me gishtat, të lëvizësh unazën nga gishti për të mundësuar kalimin e ujit, të fërkosh veshët, qafën dhe gjithë kokën (fërkim i plotë).<sup>7</sup>

<sup>6</sup> Farz (arab. fardh): detyrim fetar i formës së prerë e i pakundërshtueshëm.

Sunnet: traditë; veprim i kryer nga Profeti; pjesë e sunnetit, traditës profetike, pra veprim i këshillueshëm. (Përdorimi i trajtës “sunnet” është më i përshtatshëm sepse krijon dallim me trajtën “sunnet” me të cilën zakonisht nënkuptojmë operacionin përkatës të meshkujt)

Mekruh: veprim i papëlqyeshëm por që s'përbën gjynah, mëkat. (Shën. i përkthyesit)

<sup>7</sup> Për fërkimin për të cilin bëhet fjalë këtu, në letërsinë fetare përkatëse përdoret fjala arabishte “mes'h” që do të thotë “përkthuarje”, pra jo fërkim i plotë duke e përsëritur veprimin e duke mëshuar mbi sendin që fërkohet. (Shën. i përkthyesit)

## **Mekruhet e abdestit**

Kur merret abdest, ka disa gjëra, kryerja e të cilave është e papëlqyeshme. Nëse kryhen, ato ia zvogëlojnë mirësinë abdestit. Disa prej mekruheve janë këto:

Ta përplasësh ujin fort në fytyrë, të përdorësh më pak ose më shumë ujë se ç'duhet, të flasësh pa nevojë ndërsa merr abdest, të kërkosh ndihmë nga të tjerët pa qenë e nevojshme, të lësh pas dore ndonjë nga sunnetet e abdestit, të marrësh abdest në një vend jo të pastër.

### **d. Gjërat që prishin abdestin**

- a. Dalja e gjakut, qelbit ose lëngut nga ndonjë vend çfarëdo i trupit.
- b. Vjellja me plot gojën.
- c. Kryerja e nevojës të vogël ose të madhe, lëshimi i gazrave.
- d. Të fikëtit; dehja.
- e. Zënia gjumë, fjetja.
- f. Qeshja në namaz aq sa mund ta dëgjojnë ata që janë pranë.

## **Lexim letrar**

### **Abdesti i fshin mëkatet**

Ebu Umame tregon:

“Amr bin Abese es-Sulemi na tha: “Dëgjova se në Mekë po flitej për një fe të re. Menjëherë u vura në rrugë. Kur arrita në Mekë, Hz. Muhammedi (a.s.) po shpallte fshehurazi islamit. U bëra musliman dhe për njëfarë kohe ndenja pranë tij. Më pas u ndava e shkova në vendin tim. Pas hixhretit në Medine i bëra një vizitë Profetit dhe i thashë:

- O i Dërguari i Allahut! A po ju kujtohem?

- Po! A nuk je ti ai personi që erdhi te unë në Mekë? - Më pyeti.

- Po, - i thashë - dhe vazhdova:

- O i Dërguari i Allahut! Më trego mbi gjërat që Allahu t'i ka mësuar e që unë nuk i di. Për shembull, më fol për namazin.

Profeti më mësoi në cilat kohë ta fal namazin.

Pastaj i kërkova të më shpjegonte si merrej abdesti.

I Dërguari (a.s.) më tha:

*“Cilitdo prej jush që përgatit ujin për abdest e u jep ujë gojës e hundës, patjetër që nga goja e hunda, bashkë me ujin, i derdhen edhe mëkatet që ka bërë me këto organe. Pastaj, nëse e lan fytyrën ashtu siç ka urdhëruar Allahu, bashkë me ujin që rrjedh nga fytyra dhe mjekrra, i derdhen edhe mëkatet që ka bërë me fytyrën. Pastaj, kur lan duart gjer në bërryla, bashkë me ujin i derdhen prej gishtave edhe mëkatet e bëra me duar. Kur e fërkon kokën, rrjedhin e zhduken bashkë me ujin që derdhet anë flokëve, edhe mëkatet e saj. Pastaj, kur lan këmbët gjer në thembra, mëkatet e këmbëve i rrjedhin nga gishtat bashkë me ujin. Pastaj çohet e fal namazin, falenderon e lavdëron Allahun. E përmend me nderim të thellë Allahun siç e meriton dhe fshin nga zemra çdo frikë e dashuri tjetër përveç asaj ndaj Allahut; atëherë ai pastrohet nga të gjitha mëkatet e bëhet si ditën që e ka lindu nëna!” (Muslim)*

## **e. Tejmmumi**

### **1. Përshkrimi i tejmmumit**

*Tejmmum* do të thotë *synim*. Tejmmumi i cili, duke pasur si synim zëvendësimin e abdestit ose gusulit kur nuk gjendet ujë ose kur është i pamundur përdorimi i tij, bëhet kështu: pasi fërkohen duart pas dheut të pastër ose sendeve prej dheu, të tilla si gurët, rëra ose tjegulla, fërkohen me to fytyra dhe parakrahët.

Tejmmumi është i detyruar (farz) në kushte të caktuara. Këtë e vërtetojnë **Kur’ani** dhe **sunneti** i Profetit (a.s.).

Tejmmumi zëvendëson abdestin dhe gusulin.

### **2. Farzet dhe sunnetet e tejmmumit**

#### **Farzet e tejmmumit**

- a. Të bësh nijet për tejmmum.
- b. Të fërkosh duart pas dheut të pastër ose sendeve prej dheu dhe, pastaj, të fërkosh me ato duart fytyrën.
- c. Të fërkosh duart pas dheut të pastër ose sendeve prej dheu dhe, pastaj, të fërkosh me ato duart parakrahët.

#### **Sunnetet e tejmmumit**

Ta fillosh tejmmumin me emrin e Allahut, t’i pastrosh organet sipas radhës, pa ndërprerje, njëri pas tjetrit; kur i fërkon duart pas dheut ose sendeve të tjera, t’i shtrish njëherë para, pastaj t’i tërheqësh pas; ta mbash pëllëmbën të shtrirë me gishtat hapur; pas fërkimit pas dheut ose sendeve të tjera, t’i shkundësh duart për të hedhur poshtë trupa të fortë që mund ta dëmtojnë fytyrën, duke i përplasur me njëra-tjetrën.

### **3. Kryerja e tejmmumit**

Tejmmumi në përshtatje me sunnetin merret kështu:

Së pari bëhet nijet se për ç'gjë do të merret tejemmum. Pastaj përvishen mëngët, thuhet "Eudhu besmele", fërkohen pëllëmbët pas dheut dhe me to fërkohet fytyra. Pasi fërkohen sërish pëllëmbët pas dheut, me pëllëmbën e majtë fërkohet parakrahu i djathtë bashkë me bërrylat, kurse me pëllëmbën e djathtë fërkohet parakrahu i majtë bashkë me bërrylat.

#### **4. Kushtet që kërkojnë tejemmum**

- Kur nuk gjendet ujë i mjaftueshëm për të marrë gusul ose abdest.
- Kur, për shkak sëmundjeje apo gjymtimi, nuk shkohet dot gjer te uji edhe pse vendi ku ndodhet uji është afër.
- Kur mund të humbasë namazi i të vdekurit ose i bajramit në se shkohet për të marrë ujë.
- Kur marrja e abdestit ose e gusulit me ujë dëmton shëndetin.
- Kur sasia e ujit që ka personi është aq e paktë sa përdorimi i tij për abdest do ta linte personin pa ujë.
- Kur personi që do të marrë abdest, në përdorimin e ujit ka nevojë për ndihmën e dikujt tjetër dhe nuk e gjen.
- Kur uji i nevojshëm për abdest mund të sigurohet vetëm duke e blerë dhe për të kërkohet para sa dyfishi i vlerës së vërtetë ose më shumë.

#### **5. Gjërat që e prishin tejemmumin.**

1. Gjërat që e prishin abdestin ose e kërkojnë gusulin, e prishin dhe e bëjnë të pavlefshëm edhe tejemmumin.
2. Kur merr fund shkaku për të cilin u mor tejemmum, ai zhvlerësohet.
3. Në qoftë se gjendet ujë në kohën që personi që ka marrë tejemmum është duke u falur, namazi i tij prishet. Ai duhet të marrë abdest e të falet nga e para. Por nëse uji gjendet pasi namazi ka përfunduar, ai namaz nuk përsëritet.



#### 4. EZANI DHE KUPTIMI I TIJ

Këndimi i ezanit:

الله أكبر الله أكبر, الله أكبر الله أكبر,  
أشهد أن لا إله إلا الله, أشهد أن لا إله إلا الله,  
أشهد أن محمد الرسول الله, أشهد أن محمد الرسول الله,  
حي على الصلاة, حي على الصلاة,  
حي على الفلاح, حي على الفلاح,  
الله أكبر الله أكبر,  
لا إله إلا الله.

#### Kuptimi:

Allahu është më i madhi! Allahu është më i madhi!  
Allahu është më i madhi! Allahu është më i madhi!  
Dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut!  
Dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut!  
Dëshmoj se Muhammedi është i dërguari i Allahut!  
Dëshmoj se Muhammedi është i dërguari i Allahut!  
Ejani në falje! Ejani në falje!  
Ejani në shpëtim! Ejani në shpëtim!  
Allahu është më i madhi! Allahu është më i madhi!  
Nuk ka zot tjetër veç Allahut!

## PERMBLEDHJE

1. Cila është rëndësia e pastërtisë për shëndetin? Shpjegojeni.
2. Ç'është pastërtia morale? Si bëhemi të pastër moralisht? Shpjegojeni shkurt.
3. Cilat gjëra duhet t'i kemi kujdes për të mbajtur pastër trupin? Tregojini.
4. Pse duhet t'i japim rëndësi pastërtisë së mjedisit? Shpjegojeni.
5. Ç'është ndershmëria? Kujt i thuhet "njeri i ndershëm"? Përcaktojini shkurtimisht.
6. Cilat janë dobitë e ndershmërisë? Shpjegojini.
7. Si merret abdesti i trupit? Shpjegojeni.
8. Si merret abdesti i namazit? Shpjegojeni.
9. Cilat janë gjërat që e prishin abdestin e trupit dhe abdestin e namazit?
10. Cilat janë dobitë fizike e shpirtërore të abdestit?
11. Përshkruajeni tejemmumin.
12. Tregoni në ç'mënyrë bëhet tejemmumi.
13. Cilat janë gjërat që e prishin tejemmumin?

## **PJESA IV**

### **NAMAZI**

#### **ÇESHTJET**

##### **1. FARZET E NAMAZIT**

- a. Farzet jashtë namazit (kushtet)**
- b. Farzet brenda namazit (elementët)**

##### **2. SI FALET NAMAZI?**

##### **3. NE Ç'RASTE PRISHET NAMAZI?**

##### **4. NDIKIMET E NAMAZIT NE JETEN TONE TE PERDITSHME**

##### **5. RENDESIA E FALJES SE NAMAZIT NE BASHKESI**

##### **6. NAMAZET**

##### **7. KREU "FIL" DHE KUPTIMI I TIJ.**

#### **PUNE PERGATITORE**

- 1. Mësojini farzet e namazit nga librat mbi namazin.
- 2. Mësoni nga më të rriturit si falet namazi i xhumasë.
- 3. Mësojini rastet kur prishet namazi nga librat mbi namazin.
- 4. Kërkoni të dini dobitë e faljes në bashkësi.
- 5. Ç'keni ndjerë kur keni shkuar në namazin e bajramit?

## NAMAZI

Namazi është një adhurim që bëhet për pëlqim të Allahut, që kryhet në kohë të caktuara, që nis me tekbir e mbaron me selam dhe që përbëhet nga fjalë e lëvizje të posaçme.

Namazi është, mes Zotit dhe robit të Tij, një përmendje, një lutje, një përgjërime i robit ndaj Tij!

Zoti urdhëron kështu në Kur'an:

**“Për të më përmendur mua, fal namaz!”** (Kur'ani, Taha: 14)

**“Ata besimtarë që e falin namazin tërë frikë, janë ata që me të vërtetë kanë shpëtuar”** (Kur'ani, Mu'minun: 1-2)

Namazi e largon njeriun nga ligësitë dhe e çon në shpëtim.

**“Pa dyshim, namazi të largon nga paturpësia e ligësia. Sigurisht, të përkujtohet Allahun është më i madhi adhurim! Allahu e di se ç'bëni!”** (Kur'ani, Ankebut: 45)

### 1. FARZET E NAMAZIT

Namazi është nga ato adhurime që Allahu i Lartë i ka urdhëruar në mënyrë të prerë për çdo musliman të shëndoshë mendërisht e që ka arritur moshën e pubertetit.<sup>8</sup>

Namazi ka dymbëdhjetë kushte të detyrueshme (farz). Gjashtë nga këto plotësohen para namazit e gjashtë, gjatë tij.

#### a. Kushtet e detyrueshme (farzet) jashtë dhe para namazit

**1. Pastrimi i brendshëm nga jashtëqitjet dhe gjendja e fëlliqur:** Bëhet me abdest, me gusul ose, në pamundësi të tyre, me tejemmum.

**2. Pastrimi i jashtëm:** Pastërtia e jashtme e trupit, veshjes dhe vendit ku do të falet namazi.

**3. Mbulimi i vendeve të turpshme:** Është mbulimi i vendeve që duhet të mos duken gjatë namazit. Për meshkujt është pjesa e trupit mes gjunjëve e kërkthizës (përfshi gjunjët dhe kërkthizën), kurse për gratë, gjithë trupi veç duarve gjer në kyçe, këmbëve gjer në kyçe dhe fytyrës.

---

<sup>8</sup> Pubertet: moshë e re kur përfundon periudha e fëmijërisë dhe fillon periudha e adoleshencës dhe e pjekurisë seksuale. Kjo moshë ndryshon sipas sekseve, racave dhe zonave gjeo-klimatike. Shih të dhënat e fiziologjisë dhe psikologjisë. (Shën. i përkthyesit)

**4. Koha e namazit:** Për ta falur një namaz, duhet të ketë hyrë koha e caktuar për faljen e tij. Secili namaz, farz (i detyrueshëm) apo vaxhip (i domosdoshëm), ka kohën e vet të faljes. Namazet duhet të falen brenda kohës së vet. Një namaz që falet para se t'i vijë koha, është i pavlefshëm, kurse namazi që lihet pas kohës përkatëse, bart përgjegjësi të rëndë.

**5. Orientimi (kiblja):** Do të thotë kthimi në drejtim të Qabes. Në qoftë se dikush gjatë namazit e shmang gjoksin nga ky orientim, atij i priset namazi.

**6. Nijeti:** Duhet bërë nijet për çdo namaz që do të falet. Për namazet që falen në bashkësi me imam, duhet që imami të bëjë nijet për t'u bërë imam, po ashtu edhe secili person duhet të bëjë nijet për t'u falur pas imamit dhe nën drejtimin e tij.

Namazi fillohet pasi të jenë plotësuar këto kushte.

#### **b. Kushtet e detyrueshme (farzet) brenda namazit**

**1. Tekbiri i fillimit:** Të fillohet namazi me tekbinin “**Allahu Ekber!**”

**2. Qëndrimi në këmbë (kijam):** Të rrihet në këmbë për një pjesë kohe gjatë faljes së namazit.

**3. Këndim Kur’ani:** Në këmbë, të këndohen të paktën tre ajete të shkurtra nga Kur’ani.

**4. Përkulje (ruku):** Pas këndimit të Kur’anit në këmbë, të përkulet mesi me gjunjtë drejt gjersa duart të prekin gjunjtë.

**5. Sexhde:** Pas rukusë të bihet dy herë në sexhde duke vënë në tokë këmbët, gjunjtë, duart, ballin dhe hundën.

**6. Ndenjja e fundit:** Të rrihet ndenjtur në reqatin e fundit të namazit aq sa të këndohet lutja “Ettehijatu”

## **2. SI FALET NAMAZI?**

Namazi falet duke bërë disa veprime si ndenjja në këmbë, përkulja dhe sexhdeja e duke kënduar disa lutje e krerë të Kur’anit. Për shembull, sunneti i namazit të mëngjesit falet kështu:

Pasi bëhen përgatitjet e duhura për namaz dhe hyn koha e namazit të mëngjesit, qëndrohet në këmbë kthyer në drejtim të Kibles. Thuhet “Eudhu besmele” dhe shprehet nijeti, qëllimi i kësaj faljeje, duke thënë: ”Për hir të Allahut, bëra qëllim të fal sunnetin e namazit të mëngjesit!”

Ngrihen duart dhe shprehet tekbiiri “Allahu Ekber!” Meshkujt i ngrenë duart gjersa gishtat e mëdhenj të prekin bulëzat e veshëve, kurse femrat gjer në nivelin e supeve.

Pas tekbirit lidhen duart.

Meshkujt vendosin dorën e djathtë mbi të majtën duke mbërthyer me gishtin e madh dhe të vogël kyçin e dorës së majtë. Të lidhura kështu, i vendosin duart nën bark (nën kërthizë). Kurse femrat i vendosin duart, dora e djathtë mbi dorën e majtë, mbi gjoks.

Në këmbë këndohet së pari lutja **Subhaneke** pastaj thuhet **“Eudhu bi’l-lahi mine’sh-shejtani’r-raxhim; Bismi’l-lahi’r-rahmani’r-rahim”**. Këndohet kreu **Fatiha** dhe një kre i shkurtër.

Pastaj bëhet përkulja (ruku) duke thënë **“Allahu Ekber”**

Meshkujt përkulen paralel me tokën, pa i përthyer gjunjët dhe bërrylat, gjersa pëllëmbët të vendosen mbi gjunjë. Kurse femrat nuk përkulen sa meshkujt. Duart i vendosin më lart se gjunjët të cilat i përthejnë pak.

Ndërsa rrihet përkulur, thuhet tri herë **“Subhane Rabbije’l-Adhim”**, që do të thotë **“Zoti im i Madh! E përmend me respekt emrin Tënd!”**

Pastaj, duke thënë **“Semiallahu limen hamideh”** drejtohet trupi. Kjo do të thotë: **“Allahu e dëgjon atë që i bën lavdërim”**.

Pasi trupi drejtohet, thuhet një herë: **“Rabbena leke’l-hamd!”** Kuptimi i kësaj është **“Zoti ynë i Lartë! Lavdërimi të përket vetëm Ty!”**

Pastaj, duke thënë **“Allahu Ekber”**, bihet në sexhde. Gjunjët, duart, balli dhe hunda prekin tokën dhe thuhet tri herë **“Subhane Rabbije’l-a’la”**.

Pastaj ngrihet nga sexhdeja duke thënë **“Allahu Ekber”** dhe rrihet ulur.

Meshkujt ulen mbi këmbën e majtë, kurse femrat, mbi këmbët të kthyera djathtas. Kjo ulje zgjat aq sa për të thënë **“Subhanallah”**.

Bihet përsëdyti në sexhde duke thënë **“Allahu Ekber”**. Në sexhde përsëritet tri herë **“Subhane Rabbije’l-a’la”**. Pastaj, duke thënë **“Allahu Ekber”**, ngrihet në këmbë për fillimin e reqatit të dytë dhe lidhen duart. Këndohen me radhë **besmeleja, kreu Fatiha** dhe një kre i shkurtër. Pas kësaj, si në reqatin e parë, bëhet përkulja (ruku) dhe rënia dy herë në sexhde. Pas sexhdeve rrihet ulur.

Gjatë uljes këndohen me radhë **“Ettehijjatu”** dhe lutjet **“Allahumme sal-li”**, **“Allahumme barik”** dhe **“Rabbena”**. Pastaj *jepet selam* duke e kthyer kokën djathtas: **“Esselamu alejkum ve rahmetullah!”** Pastaj *jepet selam* duke e kthyer kokën majtas: **“Esselamu alejkum ve rahmetullah!”** Fjala *selam* do të thotë *përshëndetje* si dhe *paqe*. Kuptimi i përshëndetjes dhe lutjes së mësipërme është: **“Mëshira dhe paqja e Allahut qofshin mbi ju!”** Me dhënien e selamit plotësohet falja e sunnetit të namazit të mëngjesit.

### 3. NE Ç'RASTE PRISHET NAMAZI?

- a. Kur priset abdesti gjatë faljes së namazit.
- b. Kur flitet gjatë faljes së namazit.
- c. Kur gjatë namazit qeshet aq sa ta dëgjojë vetë personi që falet. Në qoftë se e qeshura është aq sa ta dëgjojë personi pranë, atëherë priset edhe abdesti.
- d. Kur nuk zbatohet ndonjë nga farzet e namazit.
- e. Kur gjatë namazit shmanget gjoksi nga drejtimi i Kibles.
- f. Kur kryhet një veprim tjetër që s'i përket namazit. Kur i jepet përgjigje kërkesës së dikujt tjetër gjatë namazit.
- g. Kur pjesa nga Kur'ani këndohet gabim aq sa t'i priset kuptimi.
- h. Kur përshëndetet dikush ose kur i kthehet përshëndetja dikujt.
- i. Kur lind dielli gjatë kohës që falet namazi i mëngjesit.
- j. Kur falen meshkuj e femra në një radhë e përngjat.
- k. Kur dikush që ka marrë tejemmum, dëgjon ardhjen e ujit gjatë faljes.
- l. Kur qahet e rënkohet "ah" për diçka në lidhje me çështjet e kësaj jete. E qara prej frikës a dashurisë ndaj Allahut nuk e prish namazin.
- m. Kur hahet a pihet diçka. Kur gëlltitet diçka që ka mbetur mes dhëmbëve e që është më e madhe se një kokërr qiçër.

### 4. NDIKIMET E NAMAZET MBI JETESËN TONË TË PERDITSHMË

Zbatimi i urdhrave të Allahut i jep njeriut prehje e qetësi. Edhe namazi është një urdhër i Allahut, sepse Zoti ynë na ka urdhëruar: "...**Faleni namazin...**" Kur falim namazin, e zbatojmë këtë urdhër të Allahut, prandaj ndihemi të qetë.

Allahu i Lartë i ka urdhëruar njerëzit të jenë të moralshëm e t'u largohen ligësive. Falja e namazit ndikon padyshim në largimin e njeriut prej ligësive. Kështu, Allahu ynë i Lartë, në Kur'an, urdhëron: "**Pa dyshim, namazi ... të largon nga e keqja.**" (Kur'ani, Ankebut: 45) Ky ajet sqaron, gjithashtu, se njeriu që fal namaz, duhet të rrijë larg sjelljeve të këqia. Edhe ne nuk duhet ta heqim nga mendja këtë ajet të Allahut e duhet të ruhem prej të këqia.

Për të falë namazin, marrim abdest. Mوندohemi që trupi ynë, veshja jonë e vendi ku falemi të jenë të pastër. Këto gjëra na mësojnë të jemi të pastër e ta bëjmë shprehi këtë.

### 5. LUTJET E NAMAZIT DHE KUPTIMI I TYRE

Lutjet që thuhën gjatë namazit dhe kuptimet e tyre janë këto:

#### Subhaneke

سبحانك اللهم و بحمدك وتبارك اسمك و تعالى جددك ( و جل ثناءك ) و لا إله غيرك .

#### Kuptimi:

Allahu im! Ti je larg nga të metat! Të lavdëroj e të përmend Ty ashtu si të përshtatet. Emri yt meriton lavdi. Fama jote është e lartë. Zot tjetër veç Teje s'ka!

### **Eudhu Besmele**

( أعوذ بالله من الشيطان الرجيم ) ( بسم الله الرحمن الرحيم )

### **Kuptimi:**

Mbështetem te Allahu prej sherrit të djallit të neveritur! Me emrin e Allahut Mëshirues e Bamirës!

### **Ettehijjatu**

التحيات لله والصلوات والطيبات. ألسلام عليك أيها النبي ورحمة الله وبركاته, ألسلام علينا وعلى عبادالله الصالحين, أشهد أن لا إله إلا الله و أشهد أن محمدا عبده ورسوله.

### **Kuptimi:**

Gjithë adhurimet e bëra me gojë, trup e pasuri i përkasin vetëm Allahut!  
O Profet! Paqja, mëshira dhe begatia e Allahut qofshin mbi ty!  
Paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin edhe mbi ne e mbi robtë e mirë të Allahut!  
Dëshmoj se s'ka zot tjetër veç Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi është robi dhe i dërguari i Allahut!

### **Allahumme sal-li**

اللهم صل على محمد و على آل محمد كما صليت على إبراهيم و على آل إبراهيم إنك حميد مجيد.

### **Kuptimi:**

Allahu im! Mëshiroje profetin tonë, Muhammedin, e të afërmit e tij, siç ke mëshiruar Ibrahimin e të afërmit e tij! Pa dyshim, Ti je më i Larti, më i Lavdëruari!

### **Allahumme barik**

اللهم بارك على محمد و على آل محمد كما باركت على إبراهيم و على آل إبراهيم إنك حميد مجيد.

### **Kuptimi:**

Allahu im! Begatoje profetin tonë, Muhammedin, e të afërmit e tij siç ke begatuar Ibrahimin e të afërmit e tij! Pa dyshim, Ti je më i Larti, më i Lavdëruari!



## Lutjet “Allahumme Rabbena”

اللهم ربنا أتنا في الدنيا حسنة وفي الآخرة حسنة وقنا عذاب النار. برحمتك يا أرحم  
الراحمين.

### Kuptimi:

“Allahu im, Zoti ynë! Na jep ne të mira në këtë botë, na jep të mira edhe në jetën  
tjetër. Na mbro ne nga zjarri i xhehennemit!”

رب اجعلني مقيم الصلاة و من ذريتي ربنا وتقبل دعاء

### Kuptimi:

“Zoti im! Më bëj mua dhe fisin tim nga ata që falin namazin si duhet. Zoti ynë!  
Pranoji lutjet tona!”

ربنا اغفر لي ولوالدي وللمؤمنين يوم يقوم الحساب. برحمتك يا أرحم  
الراحمين.

### Kuptimi:

“Zoti ynë! Mëshirona e falna ditën e gjykimit mua, prindët e mi dhe gjithë  
besimtarët! Zoti ynë, që je më i mëshirshmi i të mëshirshmëve!”

## Lutjet e Kunutit

اللهم إنا نستعينك ونستغفرك ونستهديك, ونؤمن بك  
ونتوب إليك, ونتوكل عليك ونثني عليك الخير كله نشكرك ولا نكفرك, ونخلع  
ونترك من يفجرك.

### Kuptimi:

“Allahu im! Veç prej Teje kërkojmë ndihmë, prej Teje kërkojmë të na falësh  
mëkatet e të na udhëzosh në rrugë të drejtë!

Ty të besojmë, Ty të shfaqim pendimin e veç te Ti mbështetemi. Të gjitha të  
mirat veç prej Teje vijnë, Ty të lavdërojmë, Ty të madhërojmë!

Ty të falenderojmë dhe kurrë s’jemi mosmirënjohës ndaj Teje. I braktisim e  
shkëpusim çdo lidhje me ata që nuk u binden urdhrave të Tua!”

اللهم إياك نعبد ولك نصلى ونسجد وإليك نسعى ونحفد نرجوا رحمتك  
ونخشى عذابك, إن عذابك بالكفار ملحق.

#### **Kuptimi:**

“Allahu im! Vetëm Ty të adhurojmë, vetëm për Ty falim namaz dhe vetëm Ty të bëjmë sexhde; te Ti vrapojmë e mundohemi të bëjmë vepra që na afrojnë te Ti. Të adhurojmë gjithë dashuri dhe mëshirën Tënde e shpresojmë, por kemi frikë nga ndëshkimi Yt; pa dyshim, ndëshkimi Yt i kap mosbesimtarët!”

## **6. RENDESIA E FALJES SE NAMAZIT NE BASHKESI**

Bashkësi në falje (xhemaat) quhet ai grup njerëzish që fal namazin lidhur pas një imami dhe nën drejtimin e tij. Për muslimanët është shumë e rëndësishme falja në bashkësi. Sepse kjo lloj faljeje ka shumë dobi për njerëzit.

Falja e namazeve së bashku bën që njerëzit të njihen me njëri-tjetrin, të takohen shpesh e të bisedojnë. Gjatë këtyre bisedave, muslimanët shkëmbejnë mes njëri-tjetrit njohuri mbi çështjet fetare.

Muslimanët që falen së bashku, mësojnë shqetësimet dhe hallet e njëri-tjetrit dhe përpiqen ta ndihmojnë e lehtësojnë njëri-tjetrin. Interesimi për nevojat e njëri-tjetrit, ndihma e përbashkët forcojnë ndjenjat vëllazërore mes njerëzve. Mes tyre krijohet solidariteti dhe ndihma shoqërore.

Në namazet e xhumasë, bajramit dhe teravive, funksionarët fetarë i japin bashkësisë njohuri fetare. Njerëzit që shkojnë në xhami, i shtojnë njohuritë duke i dëgjuar ata.

Profeti ynë i dashur e ka nxitur faljen së bashku të namazit të pesë kohëve. Prandaj muslimanët, me sa kanë mundësi, duhet të falen së bashku.

## **7. NAMAZET**

### **a. Namazet e pesë kohëve**

#### **Namazi i mëngjesit**

Namazi i mëngjesit përbëhet gjithësej prej katër reqatësh: dy reqate sunnet e dy reqate farz. Më parë falet sunneti, pastaj farzi.

Mësuam si falet sunneti i mëngjesit. Edhe farzi falet njëllë si sunneti, vetëm se, kur bëhet nijet, thuhet: ”Për hir të Allahut, bëra si qëllim të fal farzin e namazit të mëngjesit!”

Meshkujt këndojnë kamet <sup>9</sup> para se të fillojnë të falin farzet e namazeve.

### **Namazi i drekës**

Namazi i drekës përbëhet, sipas radhës, nga katër reqate të sunnetit të parë, katër reqate farz e dy reqate të sunnetit të fundit, gjithësej dhjetë reqate.

**Falja e sunnetit të parë:** Sunneti i parë i namazit të drekës falet kështu:

Shprehet nijeti, qëllimi i faljes: ”**Për hir të Allahut, bëra si qëllim të fal sunnetin e parë të namazit të drekës!**” Pastaj fillohet me tekbir dhe falen dy reqate si sunneti i namazit të mëngjesit. Në fund të reqatit të dytë rrihet ulur ku këndohet vetëm lutja “Ettehijjatu” pastaj, me tekbir, ngrihet në këmbë për në reqatin e tretë. Në qëndrimin në këmbë këndohen, me radhë, Besmele, Fatiha dhe një kre i shkurtër. Pastaj bëhen një përkulje e dy sexhde dhe kalohet në reqatin e katërt. Në këmbë këndohen sërish me radhë Besmele, Fatiha e një kre i shkurtër, bëhen përkulja dhe sexhdet dhe ulet. Me radhë këndohen Ettehijjatu, Allahumme sal-li, Allahumme barik dhe Rabbena, pastaj jepet selam.

**Falja e farzit:** Bëhet qëllim duke thënë: “Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal farzin e namazit të drekës!” Fillohet namazi me tekbir dhe falen katër reqate si sunneti i parë. Vetëm se në reqatet e tretë e të katërt, në këmbë, këndohen vetëm Besmele e Fatiha, jo edhe një kre i shkurtër.

**Falja e sunnetit të fundit:** Bëhet qëllim duke thënë “Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal sunnetin e fundit të namazit të drekës!” Pastaj fillohet namazi me tekbir dhe falen dy reqate si sunneti i mëngjesit.

### **Namazi i pasdites:**

Namazi i pasdites përbëhet gjithësej nga tetë reqate: katër reqate sunnet e katër reqate farz. Në fillim falet sunneti, pastaj farzi.

Për faljen e sunnetit bëhet qëllimi kështu: “Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal sunnetin e namazit të pasdites!” Fillohet namazi me tekbir dhe falen dy reqate si sunneti i mëngjesit; gjatë uljes në fund të reqatit të dytë, këndohen me radhë Ettehijjatu, Allahumme sal-li dhe Allahumme barik. Pastaj ngrihet për në reqatin e tretë. Në këmbë, këndohen me radhë Subhaneke, Eudhu Besmele, Fatiha dhe një kre i shkurtër. Pastaj bëhen një përkulje e dy sexhde dhe fillohet reqati i katërt. Ndërsa rrihet në këmbë, këndohen me radhë sërish Besmele, Fatiha dhe një kre i shkurtër, bëhen përkulja dhe sexhdet, pastaj rrihet ndenjtur. Pasi lexohen me radhë Ettehijjatu, Allahumme sal-li, Allahumme barik dhe lutjet Rabbena, jepet selam.

**Falja e farzit:** Bëhet qëllim duke thënë: ”Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal farzin e namazit të pasdites!” Fillohet namazi me tekbir dhe falen katër reqate si farzi i drekës.

---

<sup>9</sup> Kamet (arab.): shtat; ndërtime, vendosje; përgatitje. Eshtë këndimi nga muezini i tekstit të ezanit duke shtuar fjalinë “Kadkametissalat” për të lajmëruar fillimin e faljes së namazit farz. Kameti këndohet me një ton të butë, minor dhe prekës duke ndikuar që besimtari, duke u shpirtur nga çështjet e kësaj bote, të përgatitet në ndjenja e në shpirt për të dalë para Zotit. (Shën. i përkthyesit)

## **Namazi i mbrëmjes**

Namazi i mbrëmjes përbëhet gjithësej prej pesë reقاتesh: tre reقاتe farz e dy reقاتe sunnet. Së pari falen farzi, pastaj sunneti.

**Falja e farzit:** Bëhet qëllim duke thënë: "Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal farzin e namazit të mbrëmjes!" Dhe fillohet namazi me tekbir. Falen tre reقاتe si tre reقاتet e para të farzit të namazit të drekës. Ulja dhe ndenjja e fundit bëhen në reقاتin e tretë, pas sexhdes. Pasi këndohen me radhë Ettehijjatu, Allahumme sal-li, Allahumme barik dhe Rabbena, jepet selam.

Për **faljen e sunnetit**, bëhet qëllim: "Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal sunnetin e namazit të mbrëmjes!" Pastaj fillohet namazi me tekbir dhe falen dy reقاتe si sunneti i fundit i drekës.

## **Namazi i natës**

Namazi i natës përbëhet gjithësej prej dhjetë reقاتesh, që janë, sipas radhës, katër reقاتe sunneti i parë, katër reقاتe farz e dy reقاتe sunneti i fundit.

**Për faljen e sunnetit të parë** bëhet qëllim: "Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal sunnetin e parë të namazit të natës!" Fillohet me tekbir dhe falet njëlloj si sunneti i namazit të pasdites.

**Për faljen e farzit** bëhet qëllim: "Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal farzin e namazit të natës!" Fillohet namazi me tekbir dhe falen katër reقاتe si farzi i pasdites.

**Për faljen e sunnetit të fundit** bëhet qëllim: "Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal sunnetin e fundit të namazit të natës!" Fillohet namazi me tekbir dhe falen dy reقاتe si sunneti i fundit i drekës.

## **Namazi i vitrit**<sup>10</sup>

Namazi i vitrit falet pas namazit të natës dhe përbëhet nga tre reقاتe. Falja e këtij namazi bëhet kështu:

Bëhet qëllim: "Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal namazin e vitrit!" Fillohet namazi me tekbir. Dy reقاتet e para falen si dy reقاتet e para të farzit të namazit të mbrëmjes. Në reقاتin e tretë këndohen në këmbë Besmele, Fatiha dhe një kre i shkurtër. Pastaj bëhet edhe njëherë tekbir si tekbiri fillestar dhe këndohen lutjet e Kunutit. Ata që nuk i dinë lutjet e Kunutit mund të lexojnë lutjen "Rabbena atina". Bëhen përkulja dhe sexhdet, pastaj rrihet ndenjtur ku, pasi këndohen Ettehijjatu, Allahumme sal-li, Allahumme barik e Rabbena, jepet selam.

## **b. Namazi i xhumasë**

Namazi i xhumasë<sup>11</sup> falet në bashkësi në kohën e namazit të drekës të ditës së premte, i cili atë ditë nuk falet. Ka gjithësej dhjetë reقاتe të cilat janë, sipas radhës,

---

<sup>10</sup> Vitri (arab.): i vetëm; vetmi; qetësi. Eshtë quajtur kështu namazi pas të cilit vjen mbyllja në vetvete, gjumi dhe prehja.

katër reqate sunneti i parë, dy reqate farz e katër reqate sunneti i fundit.<sup>12</sup> Falja e këtij namazi është detyrë për muslimanin që ka hyrë në moshën e pubertetit dhe është i shëndoshë mendërisht e trupërisht. Allahu i Lartë e ka quajtur **farz, detyrim**, faljen e namazit të xhumasë.

Namazi i xhumasë falet në këtë mënyrë:

Falja e sunnetit të parë: Bëhet qëllimi: "Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal sunnetin e parë të namazit të xhumasë!" Fillohet me tekbir dhe falen katër reqate si sunneti i parë i namazit të drekës.

Pas faljes të sunnetit të parë, imami ngjitet në minber, kurse muezini thërret ezanin e brendshëm. Pas thirrjes së ezanit, imami lexon hutben në këmbë. Pas leximit të hutbes muezini thërret kametin dhe fillon falja e namazit farz të xhumasë.

Për faljen e farzit bëhet qëllim: "Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal farzin e namazit të xhumasë, u lidha pas imamit!" Fillohet namazi me tekbir. Pasi këndon me vete Subhaneke dhe Eudhu besmele, imami këndon me zë të lartë Fatihanë dhe një kre të shkurtër. Ndërkaq, besimtarët, pasi këndojnë me vete vetëm Subhaneken, dëgjojnë në heshtje këndimin e imamit. Pastaj bëhen përkulja, sexhdet dhe ngrihet në këmbë për në reqatin e dytë. Imami këndon sërish me zë të lartë Fatihanë dhe një kre të shkurtër, ndërsa bashkësia e besimtarëve dëgjon në heshtje. Pastaj bëhen përkulja, sexhdet dhe rrihet ndenjor, ku, pasi lexohen Etehiijatu dhe lutjet Allahumme sal-li, Allahumme barik dhe Rabbena, jepet selam.

Për faljen e sunnetit të fundit, bëhet qëllim: "Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal sunnetin e fundit të namazit të xhumasë!". Pastaj fillohet me tekbir dhe falen katër reqate njëloj me sunnetin e parë.

Pas sunnetit të fundit, kush ka dëshirë, fal edhe gjashtë reqate të tjera, njëherë katër, pastaj, dy. Për namazin prej katër reqatesh, qëllimi bëhet kështu: "Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal farzin e namazit të pasmë të drekës!" Kurse për namazin prej dy reqatesh, qëllimi bëhet kështu: "Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal sunnetin e fundit të namazit të drekës!"<sup>13</sup>

Ezani që thërret muezini para hutbes së xhumasë, quhet **ezan i brendshëm**. Dimë se para faljes së farzeve të namazeve këndohet **kameti**. Në kamet, pasi thuhet "Hajje alel felah", "Ejani në shpëtim!", thuhet dy herë edhe "**Kadkametissalat**", "Eshtë vendi për falje!"

---

<sup>11</sup> Xhuma (arab.): mbledhje. Fjala "xhuma" nuk do të thotë "e premte". Këtë ditë, që është ditë feste dhe pushimi për muslimanët, këta mbledhen në mënyrë të posaçme në xhami ku, në namazin e veçantë të kësaj dite, bëhet predikim, mbahet një hutbe, ligjëratë, në të cilën trajtohen çështje fetare, politike, ekonomike, etj. dhe jepen këshilla. Kështu, kjo ditë është quajtur "e xhuma" prej kësaj mbledhjeje dhe namazi të posaçëm dhe jo mbledhja e namazi prej emrit të ditës! (Shën. i përkthyesit)

<sup>12</sup> Namazit të posaçëm të xhumasë i përkasin vetëm dy reqatet farz, falja e të cilave është, gjithashtu, e posaçme. Sunnetet para dhe pas farzit, si traditë, ndryshojnë në numër, konceptim dhe qëllim sipas shkollave juridike dhe vendeve ku zbatohen. (Shën. i përkthyesit)

<sup>13</sup> Nga këto gjashtë reqate, katër të parat falen si farzi i namazit të drekës dhe quhen "zuhr-i ahir", "dreka (mesdita) e pasme", kurse dy reqatet e tjera falen si sunneti dyreqatesh i fundit i drekës dhe quhen "sunnet-i vakt", "sunneti i kohës". (Shën. i përkthyesit)

### **c. Namazi i teravive**

Namazi i teravive falet në muajin e Ramazanit, pas namazit të natës.

Namazi i teravive ka njëzet reqate dhe falet në këtë mënyrë:

Bëhet qëllim: “Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal namazin e teravive!” Pastaj fillohet namazi me tekbir. Falet me nga dy reqate si sunneti i namazit të mëngjesit ose me nga katër reqate si sunneti i namazit të pasdites. Pas çdo dhënie salam këndohet salavat për Profetin tonë.

Në qoftë se namazi i teravive falet në bashkësi, me imam, në krye të çdo reqati imami këndon me zë të lartë Fatihanë dhe një kre të shkurtër, kurse besimtarët vetëm dëgjojnë në heshtje imamin.

### **ç. Namazi i bajramit**

Namazi i bajramit ka dy reqate. Falet në bashkësi në bajramet e Ramazanit e të Kurbanit afërsisht dyzet e pesë minuta pas lindjes së diellit.

Falja e namazit të Bajramit bëhet kështu: Bëhet qëllim: “Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal namazin e bajramit të Ramazanit, u lidha pas imanit!” Nëse do të falet namazi i bajramit të Kurbanit, thuhet: “Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal namazin e bajramit të Kurbanit, u lidha pas imanit!” Fillohet namazi me tekbir. Pasi këndohet Subhaneke, bëhet tri herë tekbir duke ngritur duart lart; pas dy tekbireve të para duart lëshohen të lira poshtë, ndërsa pas tekbirit të tretë duart lidhen, si zakonisht, nën kërthizë. Pasi thotë me vete Eudhu Besmele, imami këndon me zë të lartë Fatihanë dhe një kre të shkurtër kurse besimtarët e dëgjojnë në heshtje. Pastaj bëhen përkulja dhe sexhdet dhe ngrihet në këmbë për në reqatin e dytë. Imami këndon me vete Besmele, pastaj me zë të lartë Fatihanë dhe një kre të shkurtër, kurse besimtarët e dëgjojnë në heshtje. Pastaj ngrihen duart dhe thuhet tre herë tekbir. Kur thuhet këta tekbire, duart nuk lidhen, por lëshohen të lira poshtë. Pastaj thuhet tekbiri i katërt pa ngritur duart e shkohet në përkulje, bëhen sexhdet e rrihet ndenjor. Lexohen me radhë Ettehijatu, Allahumme sal-li, Allahumme barik, Rabbena dhe jepet salam.

Pas namazit imami ngjitet në minber e lexon hutben. Pastaj bëhen lutje.

### **d. Namazi i të vdekurit**

Namazi i të vdekurit ka cilësinë e një lutjeje për muslimanin e vdekur dhe falet në këmbë, në bashkësi. Në këtë namaz nuk ka përkulje e sexhde.

Namazi i të vdekurit falet kështu: Imami dhe xhemati qëndrojnë në nivelin e gjoksit të të vdekurit. Pastaj bëhet qëllim. Në qëllim bëhet e qartë nëse i vdekuri është burrë apo grua, fëmijë apo i rritur. Për shembull, nëse do të falet namazi për një të vdekur grua, qëllimi bëhet kështu: “Për hir të Allahut, e bëra si qëllim të fal namazin e lutjes për këtë grua të vdekur, u lidha pas imanit!”

Pasi bëhet qëllim e lidhen duart, këndohet Subhaneke bashkë me pjesën “**ve xhel-le thenauke**”. Pastaj bëhet tekbir pa i lidhur duart dhe thuhet lutjet Allahumme

sal-li dhe Allahumme barik. Sërish bëhet tekbir pa i lidhur duart dhe thuhet lutja e të vdekurit. Ata që nuk e dinë lutjen e të vdekurit, mund të këndojnë lutjet “Rabbena”. Pas këndimit të lutjeve bëhet sërish tekbir dhe jepet selam, njëherë djathtas, pastaj majtas. Pas namazit bëhen lutje dhe këndohet, për hir të Allahut, kreu “Fatih”.

#### **e. Namazet shtesë (nafile)**

Namazet shtesë (nafile) janë namazet, falja e të cilëve nuk është farz, sunnet ose vaxhib.<sup>14</sup> Namazet e pesë kohëve dhe ai i xhumasë janë farz, namazi i vitrit e i bajramit vaxhib, teravitë, sunnet.

Veç këtyre namazeve, janë edhe namazet shtesë, për shembull, namazi tehexhjud (i mesnatës), namazi i paradrekës, namazi tesbih, dhe namazi evvabin janë namaze shtesë, nafile. Falja e namazeve shtesë nuk është e detyrueshme. Por, ai që i fal, fiton të mira.

---

<sup>14</sup> Vaxhib (arab.): i domosdoshëm; domosdoshmëri.

## Lexim letrar

Namazi mbulon mëkatet

Sipas tregimit të Asim bin Sufjan es-Sakafiut (r.a.), ky ishte nisur për në luftën e Thelathilit, por nuk kishte mundur të merrte pjesë në të. Prandaj ia kishte kushtuar veten udhës e Allahut dhe ishte kthyer pranë Muavijes. Aty ndodheshin edhe Ebu Ejub el-Ensariu dhe Ukbe bin Amiri (r.a.).

Asimi tha:

*- O Ebu Ejub! Këtë vit s'e arritëm dot betejën. Për ta vënë në vend këtë na u dha një rrugë. Sipas saj, kush fal namaz në katër mesxhite, iu falkan gjynahet!*

Ebu Ejubi i tha:

*- O biri i tim vëllai! Unë do të të tregoj ty një mënyrë më të thjeshtë. Pata dëgjuar këtë fjalë të Profetit: "Kush merr abdestin në mënyrë të shkëlqyer, siç është urdhëruar, e fal namazin siç është urdhëruar, i falen gjithë punët e gabuara që ka kryer më parë!" O Ukbe, a nuk është kështu myzhdeja e Profetit?*

- Po! - Tha Ukbe.

Ebu Umame (r.a.) tregon: "Ishim me të Dërguarin e Allahut bashkë në faltore, kur erdhi një burrë e i tha:

*- O i Dërguar i Allahut, unë kam bërë një faj, prandaj më dëno!*

Profeti nuk iu përgjigj. Burri e përsëriti dhe një herë atë që donte. Profeti sërish heshti. Ndërkohë hyri koha e namazit e u krye falja. Pasi Profeti mbaroi namazin, ai burri e ndoqi pas; edhe unë e ndoqa se doja ta dëgjoja se ç'përgjigje do t'i jepte.

Profeti (a.s.) iu kthye njeriut:

*Kur dole nga shtëpia, a ishe me abdest, a e kishe marrë mirë e mirë abdestin?*

- Po, o i Dërguari i Allahut, - iu përgjigj ai. Profeti e pyeti:

- Po pastaj, a u fale bashkë me ne?

Burri iu përgjigj:

- Po o i Dërguari i Allahut!

Dhe Profeti i tha:

- Atëherë, Allahu i Lartë ta ka falur gabimin (mëkatin)!



## Lexim letrar

### KESHILLA

Pa dyshim, namazet e pesë kohëve, me kushtin për t'u ruajtur nga mëkatet e mëdha, janë edhe garanci për mëkatet e vogla. Në sajë të këtyre namazeve, Allahu i Lartë i fal mëkatet e vogla.

Kur ke kryer një vepër të keqe, bëj diçka të mirë pas saj. Sepse mirësitë i pastrojnë ligësitë e bëra më parë.

Allahu ka premtuar se do ta çojë në xhennet atë që i fal ashtu siç duhet namazet e pesë kohëve që Ai i ka bërë farz.

Abdesti i pastron mëkatet kur merret si duhet. Kur lahen mirë e mirë duart për të marrë abdest, gjynahet rrjedhin nga thonjtë e gishtat bashkë me ujin.

Kur lan fytyrën duke i dhënë ujë edhe gojës e hundës, duart e krahët bashkë me bërrylat, këmbët bashkë me thembrat e kur e fërkon kokën, pastrohesh edhe nga të gjitha mëkatet!

E në qoftë se vë ballin në sexhde për Allahun e fal namazin, pastrohesh nga gjithë mëkatet e bëhesh krejt i pastër si ditën që ke lindur!

## Lexim letrar

### KESHILLA

Kur e pyetën Hatemi Esamin mbi namazin, u përgjigj kështu:

“Kur afrohet koha e namazit, marr mirë e mirë abdest, shkoj në vendin ku do falem, ulem, përqëndrohem, pastaj ngrihem në këmbë për namaz. Përfytyroj Qaben mes vetullash, siratin nën këmbë, xhennetin në të djathtë e xhehennemin në të majtë, Azrailin mbi kokë; e quaj atë namaz si namazin e fundit që do fal, rri në praninë hyjnore plot frikë e shpresë; marr tekbir me kujdes e këndoj Kur'an duke menduar mbi kuptimin, përkulem me thjeshtësi, bie në sexhde gjithë frikë. E fal namazin gjithë sinqeritet e pastërti shpirtërore, po prapë pastaj nis e shqetësohem në më është pranuar apo jo e i lutem Allahut të më mëshirojë e të më falë!”

\* \* \*

Ka plot prej atyre që falen por që namazi i tyre s'është tjetër veç lodhje e mundim.

Ditën e kiametit njerëzit do të ringjallen e mblidhen po me atë qetësi, kënaqësi që patën treguar në namazet në këtë botë e po me atë shije që patën ndjerë nga namazet!

Në se robi që çohet për namaz, ia drejton Allahut fytyrën, zemrën dhe vetveten, ai pastrohet nga mëkatet si një i porsalindur!

Kur bëhet tekbir për namaz e thuhet “Allahu Ekber!”, “Allahu është më i Madhi!”, nuk i duhet dhënë vlerë asnjë gjëje tjetër veç Allahut!

\* \* \*

Gjatë një beteje, Hz. Aliu po e falte namazin shumë gjatë, ndaj e pyetën:

*- Pse e zgjat kaq shumë namazin? - Dhe ai u përgjigj kështu:*

*- Po a nuk po luftojmë për namazin? E ç'vlerë ka jeta po s'mundëm të falemi?*

## 8. KREU FIL (Elefanti) DHE KUPTIMI I TIJ

**Kreu Fil:**

الم تر كيف فعل ربك بأصحاب الفيل. ألم يجعل كيدهم في تضليل، و أرسل عليهم طيراً ابابيل، ترميهم بحجارة من سجيل. فجعلهم كعصف مأكول.

**Kuptimi:**

“Ti nuk e ke parë se ç'bëri Zoti yt me të zotët e elefantëve!  
A nuk bëri që të dështojnë planet e tyre?  
Lëshoi mbi ta zogj tufa-tufa që i qëllonin me gurë prej balte të ngurtësuar!  
Dhe i bëri ata si arë të lashtash të shkelur e të copëtuar!”

## PERMBLEDHJE

1. Cilat janë farzet jashtë namazit?
2. Cilat janë farzet brenda namazit?
3. Cilat janë veprimet që e prishin namazin?
4. Cilat janë ndikimet e namazit në jetën tonë të përditshme?
5. Pse është e rëndësishme falja e namazit në bashkësi?
6. Si falet sunneti i namazit të mëngjesit?
7. Si falet farzi i namazit të drekës?
8. Si bëhet falja e namazit të mbrëmjes?
9. Si falet sunneti i parë i namazit të natës?
10. Kur thuhet lutjet e Kunutit në namazin e vitrit?
11. Si falet farzi i namazit të bajramit?
12. Sa reqate ka namazi i bajramit? Kur falet ai?

## **PJESA V**

### **AGJERIMI**

#### **ÇESHTJET**

- 1. AGJERIMI**
- 2. KUSHTET E AGJERIMIT**
- 3. NE CILAT RASTE PRISHET AGJERIMI?**
- 4. SJELLJET E MERA QE NA MESON AGJERIMI.**
- 5. DOBITE E AGJERIMIT**
- 6. KREU ASR DHE KUPTIMI**

#### **PUNE PERGATITORE**

1. Si bëhen përgatitjet për Ramazan në familjen tuaj? Shkruajini në fletore.
2. Shkruani në fletore ato gjëra që mbani mend apo ato gjëra që vini re nga përgatitjet e sofrës së iftarit në shtëpinë tuaj.
3. Gjeni në fjalor kuptimet e fjalëve syfy, iftar dhe imsak dhe shkruajini në fletore.
4. Ç'ju sjell ndër mend agjërimi? Shkruajini.
5. Si bëhen përgatitjet për festat fetare në mjedisin ku jetoni? Shkruani përshtypjet tuaja në fletore.

## 1. AGJERIMI

Agjërimi është adhurimi që bëhet me trup. Agjërim është të mos hash, të mos pish dhe të rrish larg prej dëshirave të ndryshme trupore nga agimi gjer në perëndim të diellit. Hyrja e kohës për agjërim dhe fillimi i tij quhet “**imsak**”; koha e hapjes së agjërimit quhet “**iftar**”. E ngrëna gjatë natës me qëllim agjërimin quhet “**syfyr**”. Në Kur’an na bëhet e ditur se, ashtu si shoqërive para nesh, edhe ne na është bërë farz agjërimi dhe na urdhërohet si më poshtë:

**“O ju që keni besuar! Ashtu si paraardhësve tuaj, edhe juve ju bë farz agjërimi që të ruheni...”**

**“... Secili prej jush që mbërrin muajin e Ramazanit, le të agjërojë ...”** (Kur’ani, Bakara: 183-285)

Ramazani që është muaji i agjërimit, është muaji i një jete të begatshme e i shpërblimit. Në këtë muaj që na kujton vlerën e mirësive të panumërta me të cilat na ka furnizuar Allahu, sekreti i shijimit të kënaqësive të pafundme duke braktisur kënaqësitë e përkohshme, arrihet me anë të së mirës së agjërimit që na ka urdhëruar Allahu i Lartë!

Për të luftuar vazhdimisht me vetëdije adhurimi kundër pengesës që paraqet vetja e njeriut, domethënë dëshirat dhe kërkesat trupore, agjërimi e ul forcën e vetes në vlerat më të ulta.

Agjërimi na i zhvillon aftësitë morale si durimi, forca e vullnetit dhe largimi nga dëshirat trupore, aftësi, këto, të domosdoshme në luftën për jetë. Gjithashtu, ky adhurim ruan nderin dhe dinjitetin e njeriut përballë dëshirave të pasosura të trupit, si ngrënia, pirja dhe epshi.

Ramazani i nderuar është një stinë e mëshirës hyjnore, që u përfton besimtarëve virtyt e pjekuri. Kur agjërojmë, ashtu siç kemi kujdes që të mos na hyjë gjë në gojë, duhet të kemi kujdes edhe për çdo fjalë që nxjerrim nga goja.

Edhe Profeti ynë i dashur na ka lajmëruar për të mirat e shumta që do të fitojnë te Allahu ata që agjërojnë.

**“Përsa kohë që nuk dëmtohet nga gjërat që nuk i shkojnë atij që agjëron, agjërimi është një mburojë që e mbron njeriun.”**

**“Kur vjen muaji i Ramazanit, hapen portat e xhennetit, mbyllen portat e xhehennemit dhe djajtë lidhen me zinxhirë!”**

Përveç agjërimit të Ramazanit që është farz, detyrim, ka edhe agjëtime të tjera, si agjërimi shtesë (nafile) dhe agjërimi i përkushtuar. Edhe këta agjëtime mbahen për pëlqim të Zotit.

Agjërimi në ditën e parë të Bajramit të Ramazanit dhe në të katër ditët e Kurban Bajramit është **mekruh afër haramit** (veprim tejet i papëlqyeshëm, i papëlqyeshëm gjer në ndalim), sepse këto janë ditë feste për muslimanët, janë ditë kur ata vizitojnë njëri-tjetrin dhe e gostisin njëri-tjetrin me gjëra të ndryshme.

## 2. KUSHTET E AGJERIMIT

Feja islame e ka bërë detyrim agjërimin për çdo musliman që ka hyrë në moshën e pubertetit.

Që agjërimi të jetë detyrim (farz), duhen plotësuar këto kushte:

- a. Të jesh musliman. Agjërimi është detyrim për muslimanët.
- b. Të jesh i shëndoshë mendërisht e të kesh hyrë në moshën e pubertetit. Agjërimi nuk është detyrim për fëmijët e për të sëmurët mendorë.
- c. Agjërim mbajnë ata që janë mirë me shëndet; të sëmurët mund të mos agjërojnë deri sa të shërohen. Edhe ata që janë në udhëtim mund të mos agjërojnë gjer kur t'u mbarojë udhëtimi.

Ndërkaq, të sëmurët, kur shërohen dhe udhëtarët, kur u mbaron udhëtimi, i pasagjërojnë (kadha) ditët e paagjëruara.

Edhe shumë të moshuarit mund ta lënë agjërimin. Në qoftë se kanë mundësi ekonomike, për çdo ditë të paagjëruar japin kundërvlerën e ushqimit ditor për një të varfër.

Që agjërimi të jetë i vlefshëm, duhet bërë qëllim. Thelbësore në qëllim është që ta ndiesh me zemër se do të agjërosh me vetëdijen e adhurimit.

Qëllimi bëhet në mbrëmje ose në syfyr duke thënë: "Për hir të Allahut, bëra si qëllim të agjëroj nesër!" Edhe po ta themi me vete, ta ndiejmë me zemër ose ta kalojmë nëpërmend është e mjaftueshme, por është më mirë kur e themi me gojë. Edhe ngritja në syfyr vlen si qëllim.

Që femrat të mund të agjërojnë, nuk duhet të jenë me të përmuajshme ose në periudhën e lehonisë. Por mund të agjërojnë pas përfundimit të këtyre periudhave si dhe pastrimit përkatës duke vënë në vend edhe ditët e paagjëruara.

## 3. NE Ç'RASTE PRISHET AGJERIMI

Agjërimi prishet në këto raste:

- a. Kur ha ose pi diçka me vetëdije, kur pi cigare. Në këto raste kërkohet zëvendësimi i quajtur "kefaret".

b. Kur vjell me plot gojën.

c. Kur ha ose pi diçka nga harresa, mirëpo pastaj thua “mu prish agjërimi” e vazhdon të hash a të pish.

d. Kur hamë ose pimë diçka duke harruar se jemi agjërueshëm; në se kujtohemi, agjërimi nuk prishet. Vetëm se duhet ta ndërpresim menjëherë të ngrënë a të pirën.

e. Kur hedhim ilaç etj. në hundë a në vesh.

f. Kur na kalon ujë nga gryka gjatë abdestit.

Prishja e agjërimin me vetëdije pason “**agjërimin kefare**” që është një lloj ndëshkimi dhe që mbahet pas ramazanit për **gjashtëdhjetë e një ditë** pa ndërprerje.

Agjërimet e pakryera e të justifikuara si ato për shkak sëmundjeje, udhëtimi, etj., kryhen më pas po në të njëjtin numër ditësh. Ky agjërim që mbahet një ditë për një ditë quhet “agjërim kaza” (aksidental).

#### **4. GJERAT QE S'E PRISHIN AGJERIMIN**

- Kur ha ose pi duke harruar se je agjërueshëm.
- Kur kalon pluhur ose insekt në fyt.
- Kur gëlltit një thërrime të mbetur mes dhëmbëve, që nuk është më e madhe se një kokërr qiqër.
- Kur hyn ujë në vesh.
- Kur kalon pa dashje tym në fyt.
- Kur hedh pika ilaçi në sy.
- Kur jep gjak.

T'u marrësh erë luleve apo lëngjeve e vajrave aromatike nuk e prish agjërimin.

#### **5. SHPREHITE E MIRA QE FITOHEN ME AGJERIMIN**

Agjërimi i mëson njeriut plot sjellje të mira. Disa prej tyre janë:

**a. Zotërimi i vetvetes (forcimi i vullnetit)**

Agjërimi forcon vullnetin. Njeriu që agjëron, mësohet t'i zotërojë dëshirat dhe kërkesat trupore e të vetvetes, mësohet t'u bëjë ballë nevojave si etja, uria e të ngjashme me to. Mësohet të tregojë durim përballë vështirësive të ndryshme. Njeriu i mësuar të durojë, bëhet i qëndrueshëm ndaj vështirësive e shqetësimeve që hasen në jetë. Ai nuk lëshohet menjëherë. I përballon vështirësitë me gjakftohtësi. Duke agjëruar, njeriu ia mohon për një farë kohe vetes të mira të ndryshme. Kështu ai ua kupton më mirë vlerën atyre të mirave.

#### **b. Aftësimi për t'u bërë ballë vështirësive**

Durimi është gjë e vështirë. Për këtë arsye, të parët tanë kanë thënë: **"Durimi është i vështirë, por fundin e ka të mirë!"** Por, për të mbledhur frytet e durimit, duhet të mësohemi t'u vemë gjoksin vështirësive! Këtë mund të na e bëjë të mundur agjërimi. Me anë të agjërimit mësohemi të përballojmë vështirësitë materiale e shpirtërore. Na rritet besimi në vetvete. Profeti ynë (a.s.) ka thënë: *"Çdo gjë e ka zeqatin e vet. Zeqati i trupit është agjërimi. Agjërimi është gjysma e durimit!"* Me këtë ai ka vënë në pah lidhjen e ngushtë mes agjërimit e durimit.

#### **c. Formimi i marrëdhënieve të mira me mjedisin**

Agjërimi ndikon në mënyrë të ndieshme në formimin e marrëdhënieve të mira me mjedisin. Ngritja bashkë me familjen për syfyr, ngrënia e iftarit së bashku, falja e teravive së bashku u sjellin gjallëri familjes dhe mjedisit.

Shpesh ftojmë për iftar komshinjtë, të afërmit, miqtë, të varfërit e udhëtarët. Këto ftesa i lidhin më fort njerëzit me njëri-tjetrin. Veçanërisht në Ramazan që është muaji i mëshirës dhe faljes, të zemëruarit pajtohen, marrëdhëniet rinohen dhe forcohen.

Agjërimi e ndihmon njeriun të bëhet më zemërbutë, më i dhembshur, më i mëshirshëm e më falës.

#### **d. Ndhurma shoqërore**

Ndhurma shoqërore është më i rëndësishmi ndër virtytet që i afron njerëzit me njëri-tjetrin. Njerëzit që jetojnë në shoqëri, padyshim që ia kanë nevojën njëri-tjetrit. Pa ndihmën shoqërore njerëzit nuk mund të jetojnë të kënaqur e të lumtur.

Agjërimi është një adhurim që zhvillon ndjenjën e ndihmës shoqërore. Njeriu i agjëruar, e kupton më mirë ç'është uria e varfëria. E kupton se në ç'kushte e kalojnë jetën të varfërit. E kupton se ç'është uria duke e përjetuar vetë. Njeriu që e ka shijuar vetë urinë, dëshiron t'i ndihmojë të varfërit. Me zeqatin dhe fitret që jep, ndien kënaqësinë e ndihmës për të varfërit. Ndhurma që jep, fuqizon lidhjet e dashurisë dhe respektit mes njerëzve, zhvillon ndjenjën e bujarisë e, kështu, bëhet edhe pengesë për shpenzimet e tepërta e të kota.

## **6. DOBITE E AGJERIMIT**



Agjërimi ka shumë dobi morale e materiale, vetiake e shoqërore, shpirtërore e trupore. Këto mund t'i trajtojmë nga dy anë:

#### **a. Nga ana fizike**

Për njëmbëdhjetë muaj me radhë stomaku dhe gjithë organet e tjera punojnë pa pushim ditë e natë. Gjatë Ramazanit, disa organe, sidomos stomaku, gjejnë mundësinë të pushojnë. Në saje të agjërimit, e ngrëna dhe e pira na bëhen më të rregullta. E lemë mënjanë të ushqyerit pa masë e rregull. Për rrjedhojë, sistemi tretës qetësohet.

#### **b. Nga ana shpirtërore**

Profeti ynë (a.s.) ka thënë: **"Agjërimi është një mburojë"**. Dhe me të vërtetë, agjërimi është si një mburojë që e mbron njeriun nga të këqiat. Sepse agjërimi e mëson njeriun të ketë durim. Si rrjedhojë, njeriu fillon të sillet më i matur përballë të këqijave. Muslimani që agjëron, fiton pëlqimin dhe dashurinë e Allahut!

Në saje të agjërimit të sinqertë, Allahu i fal gjynahet. Dhe personi i vetëdijshëm për këtë, e ndien veten shpirtërisht të qetë.

Në saje të agjërimit arrijmë t'i mbajmë nën kontroll trupin, organet, ndjenjat dhe emocionet. Dhe kjo parandalon teprimet, na e zbukuron moralin, na maturon. Na mbron nga krenaria dhe mendjemadhësia.

## Lexim letrar

### Vepra që meritoi xhennetin

Muadh bin Xhebeli (r.a.) tregon: "Një herë, ishim bashkë në një marshim me të Dërguarin e Allahut. Një ditë u ndodha rastësisht pranë tij dhe marshuam bashkë.

- O i Dërguar i Allahut, - i thashë, - a mund të më tregosh një punë që të largon nga xhehennemi e që të afron te xhenneti?

- Më pyete diçka me rëndësi. Kjo është e lehtë për atë që i ka dhënë Allahu pjesë nga lehtësia. Adhuron Allahun, nuk i bën kurrsesi shok Atij, fal namazin, jep zeqatin, agjëron Ramazanin, bën haxh në shtëpinë e Allahut! - Pastaj vazhdoi:

- A do të t'i tregoj dyert e dobisë?

- Po, o i Dërguari i Allahut! - Iu përgjigja.

- Agjërimi është perde ndarëse mes njeriut dhe xhehennemit, sadakaja shuan gabimet si uji zjarrin. Namazi që falet natën, është shenjë e të mirëve, - tha dhe më këndoi këtë ajet: **"Ata ngrihen natën nga shtrati për të adhuruar Allahun, i luten Zotit të tyre duke iu druajtur ndëshkimit të Tij e duke shpresuar në mëshirën e Tij. Dhe japin nga gjërat që ua kemi dhënë si pjesë nga të mirat!"** (Kur'ani, Sexhde: 16)

Pastaj më pyeti:

- A do të ta tregoj kreun, shtyllën dhe kulmin e kësaj feje?

- Po, o i Dërguari i Allahut! - I thashë.

- Më dëgjo, atëherë, - tha e vazhdoi të më shpjegonte:

- **Kreu i kësaj feje është islami, shtylla është namazi, kulmi është xhihadi!**<sup>15</sup>

Pastaj vazhdoi kështu:

- A do të ta them atë më të rëndësishmen, që i plotëson të gjitha këto?

- Posi jo, o i Dërguar i Allahut! - I thashë.

- Dili zot kësaj! - Më tha dhe tregoi me dorë gjuhën time. Unë e pyeta:

- O i Dërguari i Allahut! A do përgjigjemi edhe për ato që flasim?

---

<sup>15</sup> Xhihad (arab.): luftë. Sipas përcaktimit të kuptimit të kësaj fjale nga vetë Profeti, xhihadi është dy llojesh, "xhihadi i vogël", lufta materiale dhe jashtë vetes së njeriut dhe "xhihadi i madh", lufta në vetveten e njeriut. (Shën. i përkthyesit)

- O Muadh! Pse, ajo që i hedh njerëzit me fytyrë a me hundë mbi zjarr, mos është diçka tjetër veç asaj që ata e fitojnë me gjuhën e vet?

## 7. KREU ASR DHE KUPTIMI I TIJ

والعصر, إن الإنسان لفي خسر, إلا الذين آمنوا وعملوا الصالحات وتواصوا بالحق وتواصوا بالصبر.

### **Kuptimi:**

Pasha kohën! Pa dyshim, njeriu është në disfatë! Përveç atyre që besojnë e bëjnë vepra të mira, që këshillojnë për drejtësi dhe që këshillojnë për durim!

## PERMBLEDHJE

1. Ç’lloj adhurimi është agjërimi?
2. Cilat janë kushtet e agjërimit?
3. Në cilat raste prishet agjërimi?
4. Ç’do të thotë “agjërimit shtesë (nafile)” dhe “agjërimit kefaret”?
5. Çfarë shprehish të mira i përfton agjërimit njeriut?
6. Cilat janë dobitë fizike të agjërimit?
7. Cilat janë dobitë shoqërore dhe morale të agjërimit?
8. Si e zhvillon agjërimit ndjenjën e ndihmës shoqërore?

## **PJESA VI ZEQATI**

### **ÇESHTJET**

- 1. ZEQATI**
- 2. KUSH JEP ZEQAT?**
- 3. KUJT I JEPET ZEQAT?**
- 4. PER Ç'FARE JEPET ZEQAT?**
- 5. DOBITE SHOQERORE TE ZEQATIT**
- 6. SADAKAJA E FITRIT (FITRI)**
- 7. RESPEKT NDAJ TE DREJTES SE TJETRIT**
- 8. LUTJA E BUKES DHE KUPTIMI I SAJ**

### **PUNE PERGATITORE**

1. Gjeni në fjalor fjalën “zeqat” dhe mësoni kuptimin e saj.
2. Pyetni dhe mësoni se kujt i jepet fitri dhe kur.
3. Diskutoni me shokët mbi të drejtat e fqinjtit.

## 1. ZEQATI

Një prej kushteve të islamit është edhe dhënia e zeqatit. Zeqat do të thotë pastërti, begati dhe shtim. Për çdo vit, muslimani i pasur u jep nevojtarëve të caktuar një të dyzetën e pasurisë në mall ose para. Ky është zeqati.

Zeqati është një adhurim i detyrueshëm (farz), sepse Allahu i lartë urdhëron: “... **jepni zeqatin!...**” Edhe Profeti ynë e ka bërë të qartë se zeqati është farz, duke thënë: “*Allahu e ka bërë farz (të detyrueshme) dhënien zeqat nga njerëzit e pasur.*” Njeriu që e zbaton këtë detyrë, fiton pëlqimin e Allahut.

Njeriu i pasur duhet të japë zeqat. Ai nuk duhet të harrojë se pasuria që zotëron, i është dhënë nga ana e Allahut. Si përgjigje falenderimi ndaj kësaj, duhet të japë zeqatin e pasurisë që ka.

Me të vërtetë, zeqati është një nga vlerat më të larta që islami i ka përfunduar njerëzimit. Në saje të zeqatit lehtësohen sadopak vështirësitë e të varfërve, të të dëmtuarve të të mbeturve në rrugë, të vejushave e bonjakëve që ka shoqëria.

Një njeriu syngopur, sado mall e pasuri që të ketë, prapë i duket pak. Kurse njerëzit që janë mësuar të japin zeqat e sadaka, janë bujarë e të kënaqur.

Duhet të dihet se lutjet e të varfërve dhe të të vetmuarve janë një burim kënaqësie për të pasurit e të fuqishmit. Dhe janë një ndihmë morale për ta. Nuk duhet harruar se nevoja e varfëria nuk janë gjëra për tu tallur e përçmuar; në saje të durimit e nënshtrimit, janë shkak për favor dhe mirësi në jetën tjetër.

Para Allahut, për nga virtytet, ata që e falenderojnë Allahun, të pasurit bujarë dhe të varfërit e ndershëm e të durueshëm, janë të barabartë.

## 2. KUSH JEP ZEQAT?

Zeqat japin ata njerëz që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a. Të jesh musliman dhe i lirë.
- b. Të jesh i shëndoshë mendërisht dhe të kesh hyrë në moshën e pubertetit.

c. Të jesh i pasur sipas fesë (të kesh mall ose para në sasinë e quajtur “nisab” që mbetet pas plotësimit të nevojave bazë dhe pagesës së borxheve). Nisabi është masa e pasurisë e caktuar nga feja. Personi që ka pasuri sa kjo masë, pasi të kalojë një vit hënor (354 ditë) nga çasti kur e ka zotëruar këtë pasuri, është i detyruar të japë si zeqat 2,5% të saj.

### 3. KUJT I JEPET ZEQTAT?

Në një ajet të shenjtë urdhërohet kështu:

**“Zeqati, si një detyrim (farz) prej Allahut, u jepet vetëm të varfërve, nevojtarëve, nëpunësve (të ngarkuar me mbledhjen e zeqatit), atyre që kërkohet të afrohen në islam, skllëvërve (që përpiqen të fitojnë lirinë e tyre), atyre që kanë borxhe, atyre që luftojnë në rrugën e Allahut dhe udhëtarëve. Allahu është Ai që di gjithçka, Zot i urtësisë e i gjykimit.”** (Kur’ani, Tevbe: 60)

Siç kuptohet edhe nga ajeti, zeqati duhet t’u jepet këtyre personave:

- a. Të varfërve dhe të dobtëve që kanë nevojë për shërbim.
- b. Atyre që kanë borxhe e s’munden t’i paguajnë.
- c. Udhëtarëve që u janë mbaruar të ardhurat gjatë udhëtimit.
- d. Atyre që janë në rrugë të Allahut (që luftojnë për Allahun).
- e. Nëpunësve të zeqatit.
- f. Atyre që kërkohet të afrohen me islamin.
- g. Skllëvërve (që të mund të fitojnë lirinë me paratë e dhëna).

Personi që duhet të japë zeqat, nuk mund t’ua japë zeqatin gruas, fëmijëve, nipave e mbesave, nënës, babait, gjyshit dhe gjyshes, sepse është i detyruar të plotësojë nevojat e këtyre njerëzve.

### 4. PER Ç’FARE JEPET ZEQTAT?

Gjërat për të cilat jepet zeqat janë këto:

- a. Paraja.
- b. Sendet e çmuara si ari, argjendi, etj. dhe stolitë si perlat, diamantet etj.
- c. Kafshët si gjedhet, delet, devetë etj.
- d. Mallrat e tregtisë.

Për të gjitha këto jepet zeqat në masën që ka përcaktuar feja jonë. Për këto mallra jepet zeqat nëse sasia e tyre ka arritur **nisapin**, sasinë e pranuar si të mjaftueshme nga feja për të dhënë zeqat. Sipas kësaj, **nisapi për arin është 80.18 gram**. Kurse **për paratë dhe mallrat e tregtisë**, sasia e mjaftueshme për të dhënë zeqat duhet të jetë e barazvlefshme me **80.18 gram ar**. Nëse të gjitha këto mallra e kanë arritur këtë sasi, 2.5% e tyre jepet si zeqat.

Sasia e mjaftueshme për zeqat **për delet e dhitë** është **dyzet krerë**. Për **gjedhet, tridhjetë**, ndërsa **për devetë, pesë**. (Duhet që kafshët të jenë prej atyre që më tepër se gjysmën e vitit ushqehen vetë në natyrë, pra nuk janë ngarkesë ekonomike për të zotin. Këto kafshë quhen **sevaim**).

**Zeçati nuk jepet për gjërat dhe mallrat që janë nevojë bazë për njeriun.** Për shembull, nuk duhet dhënë zeçat për shtëpinë ku banohet, orëditë e shtëpisë, rrobat që vishen, mjetet apo kafshët që përdoren për transport, sepse këto hyjnë në nevojat bazë.

## **5. DOBITE SHOQERORE TE ZEÇATIT**

Feja jonë e ka vlerësuar shumë punën dhe ka urdhëruar që njerëzit ta fitojnë jetesën me punë. Por në shoqëri ka edhe njerëz që, edhe pse punojnë, nuk kanë të ardhura të mjaftueshme ose, për arsye të ndryshme si sëmundjet e pleqëria, nuk kanë mundësi të punojnë. T'u japësh ndihmë këtyre njerëzve, është edhe një detyrë njerëzore, edhe urdhër i Allahut. Ja, pra, zeçati bën të mundur t'u jepet ndihmë këtyre njerëzve. Kur të pasurit i ndihmojnë të varfërit, në shoqëri lind solidariteti mes njerëzve. Te të pasurit zhvillohet dashuria e mëshira ndaj të varfërve, kurse te të varfërit lind respekti e dashuria ndaj të pasurve që bëjnë mirë. Dashuria, respekti, mëshira dhe dhembshuria mes njerëzve forcojnë bashkimin dhe unitetin në shoqëri.

Në shoqëri mund të ketë njerëz të vobektë që janë të detyruar të lipin. Nevojat e këtyre njerëzve mund të përballohen nga zeçati. Kështu, me anë të zeçatit parandalohet edhe lipja.

## **6. SADAKAJA E FITRIT (FITRI)**

Sadakaja (lëmosha) është një lloj ndihme që u jepet të varfërve për hir të Zotit. Fitri është sadakaja që u jepet të varfërve në muajin e Ramazanit. Dhënia e kësaj sadakaje është detyrë për çdo musliman në gjendje.

Sadakaja e fitrit mund të fillojë të jepet qysh në ditën e parë të Ramazanit dhe përfundon në kohën e namazit të Bajramit. Kushdo që është në gjendje, u jep të varfërve fitrin e vet, të bashkëshortes dhe të fëmijëve. Kryefamiljari nuk mund t'u japë fitra bashkëshortes, nënës, babait, gjyshit, gjyshes, fëmijëve dhe nipave sepse është i detyruar për të plotësuar nevojat e tyre.

## **7. RESPEKT NDAJ TE DREJTES SE TJETRIT**

### **a. E drejta vetiake e njeriut**

E drejta vetiake e njeriut është nga të drejtat, mbrojtjes së të cilës i ka dhënë rëndësi islami. Për mbrojtjen e bashkimit dhe unitetit, e sigurisë dhe qetësisë në shoqëri, është e nevojshme të tregohet respekt për të drejtën vetiake të njeriut dhe secilit t'i jepet e drejta e vet. Për shembull, duhen respektuar e drejta e jetës, banimit,

punës, besimit dhe e lirisë të mendimit. Nuk i duhet cënuar askujt jeta private, besimi e mendimi. Njerëzve duhet t'u jepet e plotë ajo që u takon. Për shembull, pagesa e punës duhet bërë e plotë dhe në kohën e caktuar. Ashtu edhe nxënësi i sjellshëm që kryen detyrat që i ngarkohen, duhet të dekorohet.

Në fenë tonë, e drejta e njeriut është quajtur e shenjtë dhe i është dhënë rëndësi e madhe ruajtjes së saj. Allahu i Lartë na urdhëron t'i mbrojmë e t'i respektojmë të drejtat e njeriut. Edhe Profeti ynë i dashur (a.s.) tërheq vëmendjen që e drejta t'u paguhet njerëzve në kohën e duhur, duke thënë: *"Paguajeni hakun e punëtorit ende pa iu tharë djersa!"*

Grabitja e të drejtës së personit është e ndaluar (haram). Allahu i Lartë nuk do ta falë atë që shkel të drejtat e tjetrit. Profeti ynë e ka sqaruar këtë çështje me këto fjalë: *"Nuk është e lejuar të hyjë në xhennet, ai që ka mbi vete hakun e dikujt tjetër!"*

Ndërsa përdorim të drejtën tonë, duhet të kemi parasysh edhe të drejtat e të tjerëve. Nuk duhet të bëjmë asnjëfarë dallimi mes njerëzve kur është fjala për të drejtat e njeriut. Nuk duhet të dëmtojmë pronën dhe jetën e askujt. Në qoftë se shkelim pa dashje të drejtën e dikujt, duhet menjëherë të kërkojmë ndjesë e falje prej tij.

## **b. E drejta e fqinjët**

Fqinjët janë njerëzit me të cilët jetojmë së bashku në të njëjtën ndërtesë apo lagje. Me fqinjët takohemi shpesh e flasim. Herë pas here shkojmë e vijmë te njëri-tjetri. Shkojmë në festat e rastet e tyre dhe ata vijnë në festat e rastet tona. Kur kemi nevojë për ndonjë gjë, e kërkojmë prej tyre.

Kur një shok i veti e pyeti Profetin se ç'të drejta kishin fqinjët mbi të, Profeti i dha këtë përgjigje:

*"Në se fqinji është i sëmurë, shkon dhe i bën vizitë. Në se vdes, ndihmon që t'i kryhen shërbimet e fundit. Në se kërkon borxh prej teje, i jep. Në se ka ndonjë gabim, nuk ua thua atë të tjerëve. Në se është në gjendje të vështirë, e ndihmon. Në se i jep Allahu të mira, e përgëzon. Në se i ndodh ndonjë fatkeqësi, e ngushëllon, nuk e shqetëson ..."*

Me fqinjët duhet të shkojmë mirë, duhet t'i vizitojmë, duhet t'i ndihmojmë kur kanë nevojë. Duhet të ndajmë me ta gëzimet e hidhërimet. Duhet të sillemi mirë e me mirëkuptim me ta.

Është e drejta jonë të jetojmë në shtëpinë tonë të qetë e pa u shqetësuar nga të tjerët. E njëjta e drejtë u përket edhe fqinjëve tanë. Duhet të kemi respekt për këtë të drejtë të fqinjëve dhe nuk duhet t'i shqetësojmë ata. Profeti ynë i dashur ka urdhëruar kështu: *"Kush beson Allahun e Ditën e Gjykimit, të mos i mundojë fqinjët e tij..."* Prandaj ne duhet të shmangemi prej sjelljeve që shqetësojnë fqinjët. Për shembull, nuk duhet të hapim radion e televizionin me zë të lartë. Në se jetojmë në të njëjtin apartament, nuk duhet të bëjmë zhurmë kur hyjmë e dalim. Në se era e gjellës që gatuajmë përhapet përreth, duhet t'u japim edhe fqinjëve nga ajo gjellë.



Kujdesi ynë për të drejtat e fqinjët e shton dashurinë mes nesh dhe e forcon mbështetjen për njëri-tjetrin.

### **c. E drejta e të varfërit dhe bonjakut**

Eshtë edhe urdhri i fesë sonë, edhe detyrë njerëzore t'u ndihmojmë të varfërve e bonjakëve e të kujdesemi për të drejtat e tyre. Feja jonë na urdhëron të ndihmojmë të varfërit, të mbrojmë bonjakët e të sillemi mirë me ta. Në Kur'an, në librin tonë të shenjtë, Allahu i Lartë urdhëron kështu:

**“Adhurojeni Allahun dhe mos i bëni shok Atij! Silluni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët, të varfërit, fqinjët e afërt, fqinjët e largët, shokët e afërt, udhëtarët....”** (Kur'ani, Nisa: 36)

Allahu i Lartë na urdhëron, gjithashtu, t'i mbrojmë bonjakët, të përballojmë rritjen dhe plotësimin e nevojave të tyre. Dhe, duke na urdhëruar të mbrojmë të drejtat e tyre, na thotë:

**“Jepuni jetimëve pasurinë e vet... Mos e hani pasurinë e tyre duke e përzier me tuajën (sikur t'ju përkiste ju), sepse ky është një mëkat i madh.”** (Kur'ani, Nisa: 2)

Të varfërit duhen ndihmuar vazhdimisht. Nëse kanë nevojë për diçka, u duhet plotësuar; nëse është e mundur, u duhet gjetur një punë që të mund ta fitojnë vetë jetesën. Me bonjakët duhet të sillemi mirë dhe duhet t'u tregojmë dashuri e dhembshuri. Duhet t'i urojmë për festa e ditë të shënuara, kurse në ditë të vështira duhet t'u ndodhemi pranë. Sepse shoqëritë mbahen në këmbë për hir të të vuajturve!

## **Lexim letrar**

### **Gjendja e atyre që s'japin zeqatin Ditën e Gjykimit**

Hz. Ebu Hurejre (r.a.) dhe Hz. Xhabir (r.a.) tregojnë:

*“Profeti ynë (a.s.) na tha: ”Të gjithë atyre që kanë deve, gjedhe e dhi e nuk e japin zeqatin e tyre, Ditën e Gjykimit këto kafshë do t'u afrohen shumë më të mëdhenj se ç'janë në të vërtetë. Njeriu do të ulet në një vend të gjerë e të rrafshët e kafshët do të kalojnë duke shkelur mbi të me këmbë e putra, duke e shtypur e duke e goditur me brirë. Asnjë prej kafshëve nuk do t'i ketë brirët të thyera, asnjë kafshë s'do jetë pa brirë. Në këtë mënyrë, sa të kalojë kafsha e fundit mbi të, do vihet prapë në radhë e para. Dhe kjo do të vazhdojë gjersa të plotësohet llogaria e tij dhe të merret vendim për të.*

*Kujtudo që ka pasur pasuri dhe ka lënë pa dhënë të drejtën e Allahut, Ditën e Gjykimit pasuria do t'i kthehet në trajtën e një gjarpëri kokështypur që vrapon pas tij me gojë hapur. Sa t'i afrohet gjarpri, njeriu do përpiqet të ikë. Së fundi, gjarpri do t'i thotë atij:*

*- Merre pasurinë që ke fshehur! Unë s'kam nevojë për të!*

*E së fundi, kur ta kuptojë se s'shpëton dot prej gjarprit, njeriu do ta fusë dorën në gojën e tij dhe gjarpri do ta bluajë atë siç bluan hamshori tagjinë!”*

### **KESHILLA:**

Dhënia e zeqatit e pastron mallin nga e keqja. Dhënia e zeqatit bëhet shkak për faljen e mëkateve. Dhënia e zeqatit zgjat jetën e i shton begatinë pasurisë.

Zeqati është ura e islamit.

Dhënia e zeqatit është përmendur shpesh herë në Kur'an së bashku me namazin.

H.z. Ebu Bekri, duke u nisur nga ideja "Feja islame është një, nuk mund të copëtohet", u ka hapur luftë atyre që s'donin të jepnin zeqat.

Mosdhënia e zeqatit sjell një ndëshkim të rëndë e të dhimbshëm në botën tjetër.

## Lexim letrar

### Gjendja e gruas që s'kishte dhënë zeqatin e floririt

Një grua bashkë me vajzën e saj shkoi te Profeti (a.s.). Në dorën e vajzës kishte dy byzylykë të trashë prej floriri. Profeti e pyeti gruan:

- A e ke dhënë zeqatin e këtyre?

- Jo, - iu përgjigj gruaja. Atëherë Profeti i tha:

- A do kënaqeshe në se në Ditën e Gjykimit Allahu të t'i kthente ato në dy hallka zjarri?

Atëherë gruaja i nxori menjëherë nga dora e vajzës byzylykët dhe i vuri para Profetit duke thënë:

- Këto u përkasin Allahut dhe të Dërguarit të Tij! ( Le të llogaritet vlera e zeqatit e të jepet ai.)

## Lexim letrar

### Virtyti i njeriut që jep sadaka

I Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: "Kur Allahu krijoi botën, ajo filloi të tundej e të dridhej si një degë hurme majtas e djathtas; pastaj Ai e qëndroi atë me malet, kështu bota gjeti drejtpeshim. Engjëjt u mahnitën me forcën e maleve. E thanë:

- Zoti Ynë, a ke krijuar ndonjë krijesë më të fortë se malet?

- Po, - urdhëroi Ai. - Kam krijuar hekurin!

- A ke krijuar gjë më të fortë se hekurin? - E pyetën. Zoti tha:

- Po, kam krijuar zjarrin!

- A ke krijuar gjë më të fortë se zjarrin? - E pyetën sërish. Zoti u tha:

- Po, kam krijuar ujin!

- A ke krijuar gjë më të fortë se ujin? - E pyetën sërish. Zoti u tha:

- Po, kam krijuar erën!

- A ke krijuar diçka më të fortë se erën? - E pyetën sërish engjëjt. Zoti u tha:
- Po, kam krijuar njeriun, - tha dhe vazhdoi:
- Në se ai jep sadaka me dorën e djathtë duke e mbajtur fshehur sa të mos e shohë dot as dora e majtë, është më i forti nga të gjithë!

## 8. LUTJA E BUKES DHE KUPTIMI I SAJ

الحمد لله الذي أطعمنا وسقانا وجعلنا من المسلمين.

### Kuptimi:

“Falenderimi i takon Allahut, Atij që na ngop, na shuan etjen dhe që na ka bërë muslimanë!”

### PERMBLEDHJE

1. Cilët japin zeqat?
2. Kujt i jepet zeqat?
3. Për cilat mallra jepet zeqat dhe në ç’sasi?
4. Cilat janë dobitë shoqërore të zeqatit? Shpjegojeni shkurt.
5. Ç’është sadakaja e fitrit? Kush e jep sadakanë e fitrit?
6. Pse është e rëndësishme të mbrohet e drejta e njeriut? Shpjegojeni shkurt.
7. Cila është rëndësia e mbrojtjes së të drejtave të fqinjit për të pasur marrëdhënie të mira me ta?
8. Si duhet të sillemi me të varfërit dhe jetimët? Shpjegojeni shkurt.

## **PJESA VII**

### **HAXHI**

#### **ÇESHTJET**

- 1. HAXHI**
- 2. PER KE ESHTË HAXHI FARZ?**
- 3. FARZET, VAXHIBET DHE SUNNETET E HAXHIT**
- 4. KURBANI**
- 5. KURBANI I PERKUSHTUAR**
- 6. LUTJE NGA GOJA E PROFETIT TONE**

#### **PUNE PERGATITORE**

1. Gjeni në fjalor kuptimet e fjalëve *kurban*, *haxh* dhe *kurban i përkushtuar* dhe mësojini.
2. Diskutoni në klasë rëndësinë e prerjes së kurbanit si ndihmë për të varfërit.
3. Pyetni më të mëdhenjtë rreth kurbanit të përkushtuar.

## 1. HAXHI

*Haxhi*, si fjalë, do të thotë vizitë në vendet e shenjta. Kurse **haxhi si adhurim është veshja e ihramit, qëndrimi (vakfe) në Arafat dhe tavafi i Qabes.**

**Haxhi është adhurimi që kryhet edhe me trup, edhe me pasuri.** Kryerja e këtij adhurimi është një nga kushtet e islamit, sepse e ka urdhëruar Allahu i Lartë.

Në Kur'an urdhërohet:

**“Vajtja në haxh dhe vizita e Qabes për ata që kanë mundësinë të shkojnë e kthehen, është një e drejtë e Allahut mbi njerëzit. Kushdo që e mohon këtë, (ta dijë që) pa dyshim, Allahu nuk ua ka nevojën njerëzve!”** (Kur'ani, Al-i İmran: 97)

Haxhi, që është njëri prej pesë pjesëve përbërëse të islamit, ka për qëllim të na e mundësojë të marrim pjesë nga dorëzimi dhe nënshtrimi i Hz. Ibrahimit e Hz. Ismailit, të gjuajmë me gurë armikun brenda vetes tonë që e quajmë vetvete, ego, dhe prirjet djallëzore jashtë vetes sonë, të strehohemi te Zoti duke hedhur tej dallimet klasore e duke hyrë në atmosferën e qefinit, të rrëqethemi me ndjesinë e përfytyrimit të tmerrit të fundit të botës, të bashkohemi me muslimanët e vendeve të ndryshme e të ndërtohet një vëllazëri mes besimtarëve.

Profeti ynë (a.s.) ka thënë:

**“Haxhi dhe umreja i pastrojnë gjynahet siç i pastron qezapi i argjendarit arin dhe argjendin!”**

**“Kush bën haxh në rrugën e Allahut, po qe se shmanget nga dëshirat e pasionet dhe nuk bën gjynah, bëhet i pafajshëm si të ishte lindur nënë!”**

Njeriut të pastruar nga mëkatet, i zbutet zemra, i shtohen ndjenjat e mëshirës dhe dhimbshurisë ndaj njerëzve, tregon kujdes të veçantë të mos i bëjë keq kujt e të mos lëndojë kënd.

Çdo vit, në kohën e Kurban Bajramit, mijëra muslimanë nga vende të ndryshme shkojnë në haxh. Muslimanët që janë së bashku në haxh, njihen me njëri-tjetrin, afrohen e bëhen miq. Muslimanët që shkojnë në haxh, adhurojnë Allahun, i luten t'ua falë mëkatet. Shkojnë në qytetet e Mekës dhe Medines dhe vizitojnë disa vende që ndodhen atje, për shembull, shpellën Hira ku Profetit tonë i zbritën ajetet e para, faltoren e Profetit tonë të dashur në Medine dhe varrin e tij.

Ai njeri që shkon në haxh, përjeton gëzimin dhe lumturinë e zbatimit të urdhërit të Allahut.

## 2. PER KE ESHTË HAXHI FARZ?

Në fenë tonë, personi që plotëson kushtet e mëposhtme, e ka për detyrë të shkojë në haxh një herë në jetë.

1. Të jetë musliman.
2. Të jetë i shëndoshë mendërisht e të ketë hyrë në moshën e pubertetit.
3. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore.
4. Të jetë i lirë.
5. Të ketë gjendje për të përballuar shpenzimet e haxhit e të familjes gjatë kohës që është në haxh.
6. Të ketë kohë të mjaftueshme për të bërë haxhin.

Gjithashtu, në vendin ku shkohet në haxh, të mos ketë luftë a epidemi dhe rruga të jetë e sigurt.

### **3. FARZET, VAXHIBET DHE SUNNETET E HAXHIT**

#### **Farzet e haxhit**

**1. Qëndrimi (vakfe) në Arafat:** Qëndrimi në Arafat nga dreka e ditës para bajramit, gjer në mëngjesin e ditës së Kurban Bajramit ose pritja aty për një farë periudhe brenda kësaj kohe.

**2. Tavafi i Qabes:** Tavafi në Qabe në njërën nga tri ditët e para të Bajramit. Tavaf quhet sjellja shtatë herë përret Qabes sipas rregullave të caktuara.

Adhurimi i haxhit kryhet nën ihram. Ihrami është një copë e bardhë, e përbërë nga dy pjesë. Meshkujt, njërën pjesë e hedhin mbi supë, pjesën tjetër e mbështjellin pas trupi në mes e poshtë. Kurse femrat veshin një rrobë që u mbulon gjithë trupin.

#### **Vaxhibet e haxhit**

Vaxhibet e haxhit janë veshja e ihramit në vendin e quajtur “mikāt”, mosshkelja e ndalesave të ihramit, ndenjja në Arafat ditën para Bajramit nga dreka gjer në perëndim të diellit, gjuajtja e shejtanit me gurë, qëndrimi (vakfe) në Muzdelife, tavafi i lamtumirës.

#### **Sunnetet e haxhit**

Marrja e gusulit para se të vishet ihrami, veshja e ihramit nga burrat, thënia e telbijes, tavafi fillestar për ata që vijnë nga jashtë, tavafi shtesë (nafile) gjatë kohës së ndodhjes në Mekë.

### **4. ETIKA E HAXHIT**

1. Pagesa e borxheve, nëse ka.
2. Vajtja në haxh me para hallall.
3. Marëdhëniet e mira me bashkudhëtarët.

4. Gjatë haxhit s’duhet munduar e shqetësuar askush.

5. Të përshëndetesh me familjen dhe të afërmit para nisjes e t’u kërkosh ndjesë atyre për gabimet e bëra.

## 5. KURBANI

Si fjalë, *kurban* do të thotë *afrim*. Si term kurban do të thotë kafsha që ka cilësitë e duhura e që pritet me qëllim për t’iu afruar më tepër mëshirës së Allahut.

Prerja e kurbanit është urdhër i Allahut të Lartë. Në Kur’an thuhet: **“Ti adhuroje Zotin tënd e pri kurban për Të!”** (Kur’ani, Keuther). Është e domosdoshme (vaxhib) për muslimanin që është në gjendje të marrë kurban, që është i shëndoshë fizikisht e mendërisht, që nuk është në udhëtim dhe që është në moshë madhore, të presë kurban.

Për kurban priten kafshët si lopë, dele, deve. Edhe meshkujt, edhe femrat e këtyre kafshëve janë të përshtatshëm për kurban. Nuk janë të përshtatshëm për kurban shpendët si pula, rosa a gjeli i detit. Kafsha që do të pritet për kurban, s’duhet të jetë e sëmurë ose e gjymtuar.

Koha për prerjen e kurbanit janë tre ditët e para të Kurban Bajramit. Me kafshën që do të pritet, duhet sjellur mirë, duhet trajtuar me mëshirë, duhet përdorur thikë e mprehtë, kafsha nuk duhet munduar, duhet prerë nga një njeri i aftë, kafshës i duhen mbyllur sytë e lidhur këmbët, nuk duhet ndotur mjedisi përreth, në fund, vendi i prerjes duhet pastruar.

Prerja e kurbanit për hir të Allahut është sunnet i Hazreti Ibrahim.

Është një traditë fetare ndarja në tre pjesë e mishit të kurbanit dhe dhënia e njëres pjesë të varfërve. Njëra pjesë e mishit u jepet miqve e të afërmëve, kurse pjesa që mbetet, hahet në shtëpi. Kush dëshiron, ua ndan gjithë mishin e kurbanit të afërmëve. Dikush që e ka familjen e madhe, mund ta mbajë të tërin në shtëpi.

## 6. KURBANI I PERKUSHTUAR

Kurbani i përkushtuar është një flijim që është premtuar të bëhet për hir të Zotit në se plotësohet një dëshirë. Për shembul, në se dikush premtonte të presë kurban duke thënë **“Në se babai më shërohet, do të pres kurban”**, ky është një përkushtim. Edhe ky kurban bëhet nga kafshët si lopë, dele, dhi, ka, etj.

I gjithë mishi i kurbanit të përkushtuar u ndahet të varfërve. Nga mishi i këtij kurban nuk mund të hanë personi që e ka përkushtuar si dhe bashkëshorti a bashkëshortja, prindërit, fëmijët, gjyshi e gjyshja, nipat e mbesat. Nëse hanë, u japin



të varfërve aq sa vlera e mishit të ngrënë. Ndarja në këtë mënyrë e mishit të kurbanit të përkushtuar, është një urdhër fetar.

## Lexim letrar

### Karamelet

Im atë nxorri ca ujë nga tullumbi dhe lau sytë. Pastaj u fshi me një goxha shami që e nxori nga xhepi. E hodhi xhaketën supeve dhe i shtroi me gishta flokët e ngjitura nga djersa. Duke ecur për të hyrë brenda, më tha:

- Domethënë, në mësimin e fesë more dhjetë, ë?
- Dhjetë dhe me yll, madje, - ia ktheva unë!
- Merri, atëherë, karamelet, se i ke fituar me të drejtë!

Im atë nxori nga xhepi i fryrë i xhaketës një fishek plot me karamele leblebi dhe ma zgjati. Karamelet ishin ngjyra-ngjyra: të kuqe, të verdha, të bardha, jeshile... Megjithatë, shijen e kishin njëloj: që të gjitha, karamele leblebi! Krejt siç na pati treguar mësues Muzafëri. E pati lënë kutinë e lapsave që mbante në dorë, në mes të tavolinës dhe na pati thënë: "Zëreni se kjo është Qabeja..."

Dhe pati vazhduar:

"E zemë, gjithashtu, se këto pesë karamele me ngjyra që kemi vendosur përreth kutisë, janë muslimanë që e bëjnë Qaben tavaf. Që të pestë i kanë ngjyrat të ndryshme. I bardhi ka ardhur nga Shqipëria. Ky me ngjyrë kafe të errët i përngjet një zezaku të Afrikës. Ky është lëkurëkuqi i Amerikës. Ky i verdhi ka ardhur nga Kina, kurse ky tjetri ta zemë se është australian. Të gjithë janë të një feje, të gjithë, muslimanë! Prandaj edhe janë takuar këtu, në Qabe! Duan t'ia shpallin gjithë botës se muslimanët janë vëllezër, sepse kështu thotë libri i Allahut!"

- Mësues, po ngjyrat, a s'kanë ndonjë rëndësi?

Këtë pyetje e pati bërë Ibrahim. Mësuesi i pati mbledhur të gjitha karamelet mbi tavolinë dhe ia pati drejtuar Ibrahim. Po qeshte.

- Haji, të shohim! - I pati thënë.

Ibrahimi i pati marrë me drojë karamelet e i pati ngrënë një e nga një.

- A pati ndër to ndonjë karamele të thartë a të kripur? - E pati pyetur Ibrahim. Dhe pati vazhduar vetë:

- Domethënë, ngjyrat nuk paskan ndonjë rëndësi! Pavarësisht nga ngjyra, karamelat janë të ëmbla. Po kështu edhe njerëzit! Për të qenë musliman, s'ka rëndësi raca e ngjyra. Që të gjithë muslimanët janë vëllezër!

## 7. LUTJE NGA GOJA E PROFETIT TONE

حسبنا الله ونعم الوكيل.

**Kuptimi:**

“Neve na mjafton Allahu! Ç’dorëzanës i mirë është Ai!”

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ.

**Kuptimi:**

”Nuk ka zot tjetër veç Allahut! Ai është një e i vetëm! Ai nuk ka shok! Gjithçka i përket Atij, gjithë lavdërimet janë vetëm për Të! Atij i mjafton fuqia për gjithçka!”

يَا مُقَلِّبَ الْقُلُوبِ ثَبِّتْ قَلْبِي عَلَى دِينِكَ.

**Kuptimi:** “Zoti ynë që na i vërtit zemrat! Përqëndroje zemrën time në islam!”

## PERMBLEDHJE

1. Për kë është i detyrueshëm haxhi?
2. Cilat janë farzet e haxhit?
3. Për cilët është vaxhib (domosdoshmëri) prerja e kurbanit?
4. Cilat kafshë mund të priten për kurban?
5. Ç’ është kurbanit i përkushtuar?

**PJESA VIII**  
**FEJA ESHTË MORAL I BUKUR**

**ÇESHTJET**

- 1. FEJA ESHTË MORAL. I BUKUR**
- 2. SHPREHITE DHE SJELLJET E MIRA**
- 3. SHPREHITE DHE SJELLJET E KEQIA**
- 4. KREU “FATIHA” DHE KUPTIMI I SAJ**

**PUNE PERGATITORE**

1. Mësoni një ajet e një hadith mbi detyrat që kemi ndaj prindërve.
2. Mësoni nga prindërit të këqiat që sjell përgojimi i njerëzve.
3. Mësoni të këqiat e inatit dhe armiqësisë.
4. Mësoni nga më të rriturit detyrat që kemi ndaj shoqërisë dhe atdheut.

## 1. FEJA ESHTË MORAL I BUKUR

Secila fe vjen me qëllimin që të mundë të keqen e t'i japë pushtet të mirës. Për këtë arsye, çdo fe synon së pari të përmirësojë moralisht besimtarët e vet. Më pas, t'i rregullojë shoqëritë e t'i lartësojë ato moralisht. Nga kjo anë, morali i bukur është synimi i përbashkët i të gjitha feve hyjnore. Përsa kohë që individët nuk rregullohen moralisht, as shoqëritë nuk rregullohen, as morali i bukur nuk përhapet. Të gjitha urdhrat dhe këshillat e islamit kanë për qëllim ta shpëtojnë njeriun nga veset e këqia. Që të stoliset me sjellje të mira, njeriu së pari duhet të marrë nën kontroll instiktin. Rruga për këtë është forcimi i vullnetit. Ja, pra, feja islame i ka treguar njeriut një mënyrë jetese me të cilën mund ta marrë lehtësisht veten nën kontroll.

Profeti ynë ka thënë: *"Unë u dërgova të plotësoj moralin e bukur"*. Me këto fjalë Profeti ynë na e bën të qartë shkaku e ardhjes së tij dhe na tregon se islami është feja e moralit të bukur. Kurse në një hadith tjetër thuhet: *"Ju s'mund t'i kënaqni njerëzit me pasurinë tuaj, veçse me fytyrë të qeshur e moral të mirë mund t'i bëni të kënaqur ata"*. Kështu, morali i bukur është qëllimi i vetëm i islamit; ai qëndron mbi mallin e mbi pasurinë! Sepse morali i bukur është edhe rruga për të ngritur vazhdimisht marrëdhënie të mira me njerëzit!

Që të arrijmë të kemi një moral të bukur, duhet të kemi besimin të fortë. Por dhe kjo nuk mjafton; besimin duhet ta zbatojmë e ta pasqyrojmë në jetën e përditshme. Prandaj në Kur'an urdhërohet: **"O ju që keni besuar! Pse flisni për gjëra që s'keni për t'i bërë?"** (Kur'ani, Saff: 2) Kjo tregon se duhet t'i kemi një fjalën me veprën. Kështu, morali i bukur, është morali i Profetit. Edhe islami është moral i bukur. *"Moral i bukur është mirësia më e madhe që u është dhënë njerëzve!"*

Që të kemi një moral të bukur, duhet të zbatojmë disa detyra që na ngarkon feja. Zbatimi i këtyre detyrave ndihmon në përmirësimin tonë e të shoqërisë. Disa prej këtyre detyrave janë këto.

## 2. SHPREHITE DHE SJELLJET E MIRA

### a. Detyrat ndaj vetes

Detyra janë rregulla që njeriu është i detyruar t'i kryejë e t'i zbatojë. Duhet t'i dimë e t'i zbatojmë mirë ato. Pëndryshe, nuk arrijmë të mësojmë vlerën e jetës sonë, as t'u japim vlerë të tjerëve. Për këtë, duhet t'ia dimë mirë vlerën jetës që na ka dhënë Allahu. Duhet ta ruajmë mirë atë.

Duhet ta mbrojmë trupin e të kujdesemi për shëndetin. Nuk duhet ta rrezikojmë shëndetin. Duhet t'i japim përparësi pastërtisë. Nuk duhet ta nënvleftësojmë pastërtinë e trupit, ushqimit e mjedisit. S'duhet të lëmë pas dore as pastërtinë morale, duhet ta stolisim moralin tonë me moral të bukur. Duhet të marrim njohuri të drejtë e të saktë. Diturinë duhet ta shtojmë vazhdimisht. Kështu e përdorim më mirë mendjen tonë.

## b. Detyrat ndaj prindërve

Ne kemi detyra të shumta edhe ndaj prindërve, sepse ata kanë shumë të drejta mbi ne. Ata janë munduar për ne që para se të lindim dhe pas lindjes na kanë rritur me dashuri. Nuk kanë kursyer asgjë për të plotësuar nevojat tona në rritje.

Feja jonë na bën të ditur se detyra jonë më e madhe pas adhurimit të Allahut është të sillemi mirë me prindërit. Lidhur me këtë, në Kur'an është urdhëruar kështu: **“Dhe mos u thoni atyre as edhe of!”** (Kur'ani, Isra: 23) Prandaj duhet të sillemi mirë me ta e të zbatojmë menjëherë çdo kërkesë të tyre. Nuk duhet t'ua thyejmë kurrë zemrën, por duhet të përpiqemi t'i kënaqim ata. Duhet t'u puthim duart e të marrim urimet e tyre. Kjo do na japë ne një mbështetje të madhe shpirtërore.

Kur'ani i Lartë na bën të ditur se, pas detyrave që kemi ndaj Allahut, detyra jonë më e rëndësishme është të respektojmë prindërit e t'u bëjmë të mira atyre.

Nëna dhe babai janë themeli i familjes. Ata janë burimi i edukatës familjare që kemi marrë. Gjithë njohuritë dhe vlerat morale që fitojmë, forcën gjithë prej tyre e marrin. Për të jetuar në harmoni në shoqëri, kemi nevojë për udhëzimet e tyre, për përvojën e tyre jetësore.

## Lexim letrar

### Keci

Nexhipi i donte shumë kecat. Gjatë gjithë verës ai ushqeu e rriti një kec që i kishte falur i ati. I pëlqente jashtë mase kur keci i vogël vraponte pas tij e luante me të.

- Se mos e harron derën hapur! - E paralajmëronte shpesh i ati Nexhipin. - Po hyri keci brenda, do të na i dëmtojë rrobat!

Një ditë Nexhipi hyri në shtëpi me vrap për të marrë topin. Iu kujtua fjala e të atit, por, duke menduar se do të dilte shpejt, nuk e mbylli derën. Dhe nuk e vuri re se keci që vraponte pas tij, hyri brenda.

Ndërsa kërkonte me sytë e bukur bojëqielli se nga kish shkuar Nexhipi, keci iu afrua pasqyrës së madhe në sallon. Kur pa përballë vetes një kec tjetër si vetja, eci drejt tij. U zemërua keqas kur pa se kafsha po i afrohej pa frikë. Dësh të hakmerrej. Menjëherë u hodh drejt tij me gjithë fuqinë.

“Shangërrrr” u dëgjua një zhurmë. Pasqyra e madhe ishte bërë copë e grimë.

Po ta dinte Nexhipi atë që Profeti ynë u kish thënë dy shokëve të tij, Abdullah bin Omerit e Abdullah bin Amrit në kohë të ndryshme, **”dëgjojeni fjalën e prindit”**, nuk do të dilte nga fjala e të atit!

## Lexim letrar

### Fëmija i talentuar

Tre gra me çanta në duar po ktheheshin nga tregu. Nga që ishin të lodhura, u ulën për të pushuar në një stol anës rrugës. Filluan të flisnin me njëra-tjetrën për fëmijët.

Gruaja e parë tregoi se sa i shkathët ishte fëmija i saj e si mund të ecte për minuta të tëra mbi duar.

Gruaja e dytë u tha shoqeve se sa zë të bukur kishte i biri. Të gjithë mpakeshin pas këngëve që këndonte ai me zërin si bilbil.

Kurse e treta vetëm i dëgjoji. Kur e pyetën se pse s'fliste, u përgjigj:

- Im bir nuk ka ndonjë talent të veçantë, prandaj!

Një i moshuar që kishte dëgjuar rastësisht bisedën e grave, eci pas tyre.

Në krye të rrugës gratë lanë çantat në tokë e filluan të fërkonin krahët e belin që u dhimbnin nga lodhja. Fëmijët e tyre vrapuan menjëherë kur i panë.

Biri i gruas së parë ecte mbi duar duke bërë akrobacira.

Biri i gruas së dytë u ul mbi një gur e filloi të këndonte një këngë. Gratë e tjera e duartrokitën me entuziazëm.

Kurse biri i gruas së tretë i tha s'ëmës:

- Prit të të ndihmoj, nënë! - Dhe ia kapi rripin e çantës.

Gratë iu drejtuan të moshuarit që po kalonte andej duke e pyetur për talentet e fëmijëve të tyre.

- Unë veç një fëmijë të talentuar pashë këtu, - tha i moshuari. -Këtë fëmijë që vrapoi për të ndihmuar t'ëmën. Ai zbatoi këtë hadith të Profetit: *"Këshilloj secilin nga ju t'i bëjë shërbim nënës!"*

## Lexim letrar

### Pjata plastike

Marangozi plak kishte rënë shumë tashmë. As i kishte mbetur dritë në sy e as forcë në gishta. Ngaqë i dridheshin duart, mezi e mbante lugën e gjella i derdhej mbi mbulesën e tavolinës.

Ë biri e nusja i zemëroheshin gjithmonë pse nuk sillej më i kujdesshëm. Po më shumë shqetësoheshin kur i rridhte gjella nëpër nofull. Më në fund, sofrën e plakut e veçuan. Ndërsa ata hanin në tavolinë, atij i jepnin të hante përtoke.

Nipi i vogël, Hasani, mërzitej shumë për gjyshin; kur hante, ia mbante dorën që të mos i derdhej gjella.

Një ditë, ndërsa me sytë plot lot shikonte ata që hanin në tavolinë, plakut të moshuar i rrëshqiti pjata nga dora e iu thye. Kjo i zemëroi ata së tepërmi. I thanë plakut fjalë të rënda që ia thyen zemrën. Pastaj filluan t'ia jepnin gjellën në pjata plastike.

Një ditë, ndërsa i biri i marangozit plak po i thoshte të shoqes të mos i vinte frutat në pjata plastike, e urdhëroi:

- Hidhi këto pjata tani!

Hasani, duke ndarë dy nga pjatat, tha:

- Këto mos i hidh, nënë, se do na duhen!

I ati u bë kureshtar:

- Pse, çfarë do të bësh me to?

- Kur të plakeni, do t'ju hedh gjellën tuaj aty! - U përgjigj Hasani.

Prindërit e Hasanit u turpëruan shumë për atë që i kishin bërë plakut. Dhe e morën sërish në tavolinë.

Po ta dinin djali e nusja e marangozit plak se gjëja më e mirë që i çon njerëzit në xhennet, është mirësia ndaj prindërve, sigurisht që nuk do silleshin kështu.

Sa bukur që e ka thënë Profeti ynë:

*“Pëlqimi i Allahut fitohet duke kënaqur prindërit. Ndëshkimi i Allahut pësohet duke hidhëruar prindërit!”*

### **c. Detyrat tona ndaj mësuesve**

Mësuesit janë ata që na mësojnë të shkruajmë e të lexojmë, na japin dije të reja e na edukojnë. Me ndihmën e tyre i vemë re më mirë të metat tona dhe i korrigjojmë ato. Për të gjitha këto, mësuesit meritojnë respekt po aq sa edhe prindërit. Mësuesit tanë përpiqen që ne të bëhemi të vlefshëm për familjen, kombin dhe njerëzimin. Prandaj themi se ata kanë pjesë të madhe në zhvillimin e aftësive dhe personalitetit tonë.

Këta njerëz që mundohen aq shumë për ne, duhet t'i kujtojmë edhe pasi të ndahemi nga shkolla. Herë pas here duhet t'i gëzojmë me vizitat tona. Sa herë që t'i shohim, duhet të ngrihemi në këmbë e t'i respektojmë. Duhet t'i kujtojmë shpesh, t'u telefonojmë e t'u dërgojmë urime për festa. Hazreti Aliu ka thënë: "Bëhem skllavi i atij që më mëson një shkronjë!" Duhet të thellohemi mirë në kuptimin e kësaj fjale!

### **d. Detyrat tona ndaj motrave e vëllezërve e ndaj të afërmëve të tjerë**

#### **1. Detyrat tona ndaj motrave e vëllezërve**

Ne kemi disa detyra edhe ndaj motrave e vëllezërve.

Nuk duhet të sillemi keq me vëllezërit e motrat. Ndaj më të mëdhenjve duhet të tregojmë respekt, ndaj të vegjëlve, dashuri. Duhet ta mbështesim vazhdimisht njëri-tjetrin. Prandaj s'duhet të zemërohemi e të rrimë të zemëruar. Duhet t'i harrojmë mëritë. Duhet të sillemi me mirëkuptim me njëri-tjetrin.

Familja është themeli i shoqërisë. Motrat e vëllezërit janë përbërësit kryesorë të saj. Nëse ata nuk shkojnë mirë me njëri-tjetrin, qetësia në familje prishet. Sa më pak harmoni të ketë në familje, aq më pak harmoni ka shoqëria. Prandaj duhet të kalojmë me mirëkuptim me motrat e vëllezërit.

#### **2. Detyrat tona ndaj të afërmëve të tjerë**

Gjyshi, gjyshja, xhaxhai, halla, daja, tezja dhe fëmijët e tyre janë të afërmit tanë. Ata janë farefis me ne, të afërt në gjak me ne. Ne duhet të kemi vazhdimisht marrëdhënie të afërta e të sinqerta me ta. Ne kemi nevojë për dashurinë e tyre, edhe ata për tonën.

Respektin që tregojmë për prindërit, duhet ta tregojmë edhe për ta. Rruga për të qenë mbështetje për njëri-tjetrin, kalon përmes dashurisë dhe respektit për njëri-tjetrin.

Feja islame i ka dhënë rëndësi të madhe vizitës te të afërmit. Ne duhet t'i vizitojmë të afërmit herë pas here. Duhet t'ua fitojmë zemrën, duhet të përfitojmë nga



përvoja e tyre. Në ditët e festave, në ditët dhe netët e mira duhet t'i vizitojmë ose t'i urojmë me telefon apo me kartpostale urimi.

### **e. Detyrat tona ndaj kombit dhe shoqërisë**

Nuk është e mundur që njeriu të jetojë i vetmuar. Për këtë arsye, në çdo etapë të zhvillimit të shoqërisë njerëzit kanë jetuar në shoqëri. Bashkësia njerëzore që jeton mbi të njëjtën pjesë toke e që ka gjuhë, kulturë e histori të përbashkët, quhet komb. Që të vazhdojmë të jetojmë në bashkësi e të lumtur, ne kemi detyra të ndryshme ndaj vendit që i përkasim e shoqërisë mes së cilës jetojmë.

Individët e të njëjtës shoqëri bartin të njëjtat ndjenja si në gëzim, ashtu edhe në hidhërim. Nga ky këndvështrim, duhet t'i duam individët e shoqërisë. Duhet të jetojmë në solidaritet me ta, duhet ta mbështesim njëri-tjetrin. Nuk duhet t'i shkelim të drejtat e tyre, nuk duhet të lejojmë t'u shkelen nga të tjerët, përkundrazi, duhet të kujdesemi për to. Kështu bëhemi më të fuqishëm.

Ne hidhërohemi në fatkeqësi të tilla si përmytjet, zjarret dhe tërmetet. Në këto raste, menjëherë u shkojmë në ndihmë të dëmtuarve duke bërë gjithçka na vjen doresh. Për këtë na nxit dhe feja jonë. Ajo e quan këtë një detyrë njerëzore. Kështu zhvillohen solidariteti dhe mbështetja reciproke në gëzime e hidhërim, kështu zhvillohet bashkimi!

### ***Lexim letrar***

### **Kush është mundës i vërtetë**

Ibni Mesuti ( r.a.) tregon:

“Një ditë Profeti na pyeti:

- Kë quani mundës mes jush? As’habet, shokët, iu përgjigjën:

- Quajmë atë person që s’ka burrë që ta mundë!

Atëherë Profeti tha:

- Jo! Mundës i vërtetë është ai që, kur zemërohet, e mund zemërimin, e zotëron vetveten dhe nuk shmanget kurrë nga e drejta!

Hazreti Ebu Hurejre (r.a.) përcjell: “Profeti (a.s.) ka thënë:

“I fuqishëm nuk është mundësi që mund kundërshtarin në ndeshje. I fuqishëm është ai që mund vetveten kur nxehet!”

## **KESHILLA:**

- I fuqishëm është ai që mund zemërimin!
- Zjarri nuk shuhet me zjarr, por me ujë. Nuk i jepet përgjigje me zemërim njeriut të zemëruar!
- Kush çohet me zemërim, ulet me dëm. Vjen zemërimi, sytë errësohen; zemërimi ikën, skuqet fytyra! Domethënë, i vjen turp për ç'ka bërë. Zemërimi është i ëmbël, por frutin e ka të hidhur; këshilla është e hidhur, po frutin e ka të ëmbël!
- Uthulla e fortë thyen enën e vet.
- Ai që i nxihet fytyra, nxin edhe më të dashurin e vet!
- Kush mbjell erën, korr furtunën!
- Kur vjen zemërimi, ikën mendimi!
- Nxehja është fillimi i gjithë të këqijave!
- Kush mund zemërimin, mund armikun!
- Ai që zemërohet gjatë bisedës, humb forcën, i dorëzohet kundërshtarit pa armë!
- Gllënjka më e vlefshme që kapërdin njeriu për Allahun, është gllënjka e zemërimit të vet kur e gëlltit duke menduar pëlqimin e Allahut!
- Kur nxehemi, duhet të ulemi ndenjor ose të shtrihemi, të themi Eudhu Besmele, të marrim abdest e të falim namaz!

## Lexim letrar

### Mikpritja e Ebu Talhasë

#### dhe e bashkëshortes së tij

Një burrë shkoi te Profeti (a.s) e i tha:

“Unë po vdes urie!”

Profeti dërgoi menjëherë një burrë në shtëpi e i kërkoi ushqim njëjës prej grave. Por ajo i çoi fjalë:

“Të betohem për atë Zot që të ka dërguar, se s’ka në shtëpi gjë tjetër veç ujit!”

Atëherë Profeti e dërgoi atë burrin te një zonjë tjetër. Edhe ajo i iu përgjigj po ashtu. Më së fundi, Profeti tha:

“Ai që ngop këtë të uritur, shpërblehet me xhennet!”

Një burrë e dëgjoi këtë e tha:

“O i Dërguar i Allahut! Ai do jetë miku im!”

Dhe e mori njeriun e uritur me vete në shtëpi. Atje pyeti të shoqen:

“A kemi ndonjë gjë për të ngrënë?”

“Jo, iu përgjigj ajo, veç ushqimit të fëmijëve!”

“Ti gënjeji ata me ndonjë gjë, pastaj veri në gjumë. Kur të hyjë miku, ne bëjmë sikur po hamë. Kur ta zgjasë dorën për të ngrënë, ti ngrihu gjoja për të rregulluar kandilin, po fike krejt atë!”

Gruaja bëri siç i tha i shoqi. Ajo bëri siç i tha ai. U ulën së bashku. Miku hëngri, kurse ata, burrë e grua, e kaluan natën të uritur.

Në mëngjes shkuan pranë Profetit. Profeti i tha kështu Ebu Talhasë:

Sjellja juaj e mbrëmshme me mikun i ka pëlqyer Allahut e për këtë Ai zbriti këtë ajet: **”... edhe nëse janë nevojtarë për vete, ata venë të tjerët para vetes së tyre!”** ( Kur’ani, Hashr: 71)

## **KESHILLA:**

- Ai që i beson Allahut e Ditës së Gjykimit, ta gostisë mikun!
- Nuk ka dobi prej atij që nuk respekton mikun!
- Në një shtëpi që nuk hyjnë miq, nuk hyjnë as engjëjt!
- Më i vlefshmi nga ju është ai që ushqen në rrugën e Zotit!
- Ai që i jep të hajë e të pijë me gjithë zemër vëllait të tij prej feje, largohet prej xhehennemit!
- Kush gostit vëllain prej feje, është sikur ka gostisur vetë Allahun!
- Bashkëshortja e mirë që ndihmon njerëzit në fe e në të mirë, është dhuntia më e mirë e kësaj bote!

## **3. VESET E KEQIA**

Feja islame i jep rëndësi të madhe moralit. Edhe Profeti ynë i dashur që na bën të ditur se është dërguar për të plotësuar moralin e bukur, na thotë, gjithashtu, se më i miri ndër njerëz është ai që ka moralin më të mirë.

Gjithashtu është tërheqës fakti që Profeti në lutjet e tij i kërkon shpesh Allahut shëndet, mirësi e moral të bukur.

Morali i bukur na jep epërsi. Na e rrit vlerën para Allahut e mes njerëzve.

Kurse veset e këqia na largojnë prej Allahut. Njerëzit me vese të këqia nuk i do e nuk i respekton askush.

Vesi i keq e dëmton gjithnjë të zotin. Në çdo çështje e fut në shqetësim. Bëhet shkak që ai të mos jetë kurrë i lumtur. Veçanërisht, edhe në botën tjetër vuan dënimin për të këqiat që ka bërë. Për këtë arsye, në fenë tonë janë saktësuar cilat janë sjelljet e mira e cilat të këqia dhe na është këshilluar të përvetësojmë të mirat e të ruhemi prej veseve të këqia.

Tani le të shohim disa prej këtyre sjelljeve e veseve të këqia që feja jonë na i ka ndaluar:

## **a. Përgojimi dhe smira**

### **Përgojimi pas krahëve**

Thashethemet dhe përgojimi janë e njëjta gjë. Thashethemet janë e folura pas krahëve për dikë për gjëra që nuk do t'i pëlqenin po t'i thuheshin ndër sy.

Kjo është një sjellje shumë e keqe. Në Kur'anin e Lartë Allahu na e ka bërë të ditur se të folurit pas krahëve është aq e ndyrë dhe e shëmtuar sa të hash mishin e njeriut të vdekur. Muslimanët gjithmonë duhet të flasin për vetitë e mira të vëllezërve të tyre; në qoftë se kanë vese të këqia, duhet të përpiqen të mos ua vënë re. Ky qëndrim bën që vetitë e mira dhe mendimet e bukura të përhapen në shoqëri. Numri i të këqiave rritet kur për to flitet vazhdimisht. Duhet të ruhem nga kjo gjë.

Profeti ynë pati thënë: *“Mos e përmendni vëllain tuaj të fesë për atë që nuk i pëlqen!”* Lidhur me këtë, e pyetën: *“Po në se ai e ka atë që themi?”* Kurse ai iu përgjigj: *“Në se ai e ka atë gjë, flitet pas krahëve, përgojohet. E në se nuk e ka, shpifet!”*

Ata që flasin pas krahëve, janë njerëz që vazhdimisht rrëmojnë të metat e të tjerëve. Njerëz të tillë nuk i shohin të metat e veta ose nuk duan t'i shohin!

Përfolja është një imoralitet i madh. Dëmi nuk prek veç atë që flet pas krahëve, por gjithë shoqërinë. Bëhet shkak për zemërimet e mërira. Dashuria e respekti zhduken. Njerëzit bëhen armiq me njëri-tjetrin. Jetojnë vazhdimisht në dyshim: *“Vallë çfarë flitet kundër meje?”*

Njerëzit që përflasin të tjerët, mundohen ta tregojnë veten pa të meta e më lart se të tjerët. Por, në të vërtetë, duke përfolur të tjerët, ata ulin vetveten.

### **Smira**

Një tjetër veti e keqe është smira.

Disa njerëz kanë shumë smirë. Nuk munden t'i durojnë sukseset, pasurimin, emrin e mirë e pozitën e njerëzve përreth. Duan që gjithë këto të mira t'i përkasin vetëm atij. Njerëzit e tjerë të mos i kenë. Madje, në se i kanë, t'i humbin. Të pasurit të bëhen të varfër, të aftët të paaftë, të bukurit, të shëmtuar.

Për shembull, në se një nxënës, kur shoku i tij merr notë të mirë, mërzitet e thotë *“pse të marrë ai notë më të mirë se unë”,* ai ka smirë. Nxënësit me smirë gëzohen kur shokët e tyre marrin notë të keqe. Ky është një kuptim shumë i keq.

Në të vërtetë, smira është një sëmundje shpirtërore që u hap rrugë edhe shumë të këqiave të tjera. Këta të sëmurë mund të shkojnë gjer atje sa t'i dëmtojnë njerëzit që kanë smirë.

Smira është dënuar edhe në Kur'an dhe na është thënë se duhet të mbështetemi te Allahu nga dëmi i smirëkëqinjve.

Në Kur'an, duke shpjeguar gjendjen e smirëzinjve, thuhet: **"Në se ju ju vjen një e mirë, ata mërziten e, në se ju ju vjen një e keqe, ata gëzohen"** (Kur'ani, Al-i Imran: 120)

Ta duam dhe për vete epërsinë, fisnikërinë, suksesin e pasurinë që shohim te të tjerët, nuk është smirë. Kjo quhet *mahnitje, zili*. Në të vërtetë, të mahnitesh pas sukseseve dhe epërsive apo bukurive të të tjerëve e t'i kesh zili ata në kuptimin që të dëshirosh të njëjtat gjëra edhe për vete, është diçka e mirë, është një shtysë për të ecur përpara. Thënia sipas së cilës "besimtari sheh me zili, hipokriti, me smirë", e bën qartë dallimin mes këtyre dy situatave.

Smira është vesi më i keq!. Profeti ynë ka thënë: *"Mos kini smirë të tjerët, sepse si zjarri djeg drurin, edhe smira zhduk gjërat e mira!"*

Armiqësia, mburrja, dëshira e madhe për pasuri, famë e pozitë bëhen shkak për xhelozin e smirë. Prandaj, duke zbukuruar moralin tonë, duhet të përpiqemi që të mos sëmuremi nga smira. Kështu ruajmë edhe veten, edhe shoqërinë nga të këqijat e smirës.

## **b. Egoizmi dhe dyfytërsia**

Egoizmi është të menduarit vazhdimisht vetëm për përfitimin dhe interesin e vet. Egoistët nuk shqetësohen në se egoizmi i vet mund t'i dëmtojë të tjerët. Ata mendojnë vetëm për veten. E shohin si të drejtë personale që të përvetësojnë gjërat më të bukura, që të ngjiten në postet më të larta. Ata përpiqen të shtien në dorë gjërat që dëshirojnë pa njohur asnjë normë morale. Nuk i njohin të drejtat e të tjerëve. Vlerat e larta si morali, për ta nuk bartin asnjë kuptim!

Veprimi i një shitësi i cili, për ta shitur mallin e vet e për të fituar më shumë, flet keq për mallin e fqinjët që s'ka asnjë të metë, është një model tipik i egoizmit. Edhe ata që, në ato vende ku duhet mbajtur radhë, nuk bëjnë si të gjithë, janë egoistë.

Te personat egoistë, ndjenjat e bukura si ndihma reciproke, shoqëria, miqësia, drejtësia, vëllazëria asgjësohen. Të tillët janë njerëz që s'u bën përshtypje padrejtësia, janë mendjemëdhenj e dorështrënguar. Egoistët janë të mangët edhe në vlera të tilla të larta si vetëmohimi e atdhedashuria. Atyre as që u shkon ndërmend ta ndihmojnë një të varfër!

Egoizmi nuk ka anjë lidhje me ato që na urdhëron feja jonë. Muslimani duhet të mendojë për të tjerët më e pakta sa mendon për veten. Ai duhet të kujdeset për të drejtat dhe interesat e të tjerëve si të ishin të vetat. Atë që dëshiron për vete, duhet ta dëshirojë edhe për vëllazërit e tjerë të fesë. Hadithet e mëposhtme na tregojnë se kurrsesi nuk duhet të jemi egoistë.

Profeti ynë ka thënë kështu: *"Nuk është besimtar i vërtetë ai që fle i ngopur, ndërsa fqinji i tij është i uritur."* *"Nuk ka besuar me të vërtetë ai prej jush që nuk dëshiron për vëllain e tij të fesë atë që dëshiron për vete."*

**Dyfytyrësia** ose, e thënë me një fjalë të huaj, **hipokrizia**, është cilësia e njeriut të pasinqertë, për pasojë, edhe i dëmshëm për të tjerët. Hipokritët nuk janë siç kërkojnë të duken. Njerëzve u tregojnë fytyrë të ëmbël e dashamirësi, por, në të vërtetë, në zemra ushqejnë inat e armiqësi. Kënaqen kur fusin grindje e keqkuptim mes njerëzve. Edhe ata që nuk janë muslimanë të vërtetë, por hiqen si të tillë, janë hipokritë.

Si nga ana e besimit, ashtu edhe nga ana morale, hipokrizia është diçka shumë e keqe. Në të dy rastet, hipokritët janë njerëz që shkaktojnë dëm.

Kapitali kryesor i hipokritëve është **gënjeshtria**. Të tillët thonë gënjeshtria pa ndërprerje. Tjetër thonë e tjetër bëjnë. Me thëniet e sajua marëdhëniet mes njerëzve. Bëhen shkak që njerëzit të ndiejnë dyshim për njëri-tjetrin.

Gjëja e vetme që dëshirojnë, është të fusin armiqësi mes njerëzve. Për t'ia arritur kësaj e për të mbjellë mes njerëzve farën e urrejtjes dhe armiqësisë, hipokritët provojnë çdo lloj gënjeshtre e dredhie.

Në kohën e Profetit tonë, kur hipokritët shihnin muslimanët, thonin: **”Ne i besojmë Allahut dhe Ditës së Gjykimit.”** (Kur’ani, Bakara: 8) Kurse mes njerëzve të vet pohonin se i kishin gënjyer muslimanët. Allahu i Lartë ka urdhëruar kështu mbi ata njerëz dyfytyrësh:

**“Këta përpiqen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët. Ndërsa veç veten mashtrojnë por nuk e kuptojnë këtë!”** (Kur’ani, Bakara: 9)

Këta lloj njerëzish kanë disa veti që i dallojnë nga të tjerët. Profeti ynë, gënjeshtren, mosmbajtjen e fjalës dhe shkeljen e amanetit i ka quajtur shenja hipokrizie.

Allahu i Lartë na ka bërë të ditur se për të këqiat që kanë bërë hipokritët në këtë botë, do dënohen rëndë në botën tjetër. Të tillët as njerëzit nuk i duan. Edhe ne, duke menduar të mirën tonë e të shoqërisë, duhet t’u rrimë larg hipokritëve e të mos krijojmë miqësi me ta!

## Lexim letrar

### Gënjeshtari

Atë ditë në gjykatë kishin gjyq një burrë e një grua. Kadiu u ul në vendin e vet dhe filloi gjyqi. Së pari fjala iu dha gruas.

Gruaja filloi të fliste duke treguar burrin e dobët që kishte afër:

- Ja, ky burri më sulmoi! Më mori nderin! - Tha duke qarë.

Burri u mbrojt:

- Gënjen, zotëri! Unë po numëroja paratë e deleve që kisha shitur kur kjo grua më erdhi pranë e më kërkoi para duke më kërcënuar se, po të mos i jepja, do të më vinte në pozitë të vështirë! Kur e pa se nuk pranova, filloi të çirrej e të bërtiste!

Nga fjalët, sjelljet dhe qëndrimi i tyre, gjykatësi e kuptoi se kush gënjente dhe kush thoshte të vërtetën, por nuk e dha veten. Iu drejtua burrit:

- Edhe e sulmon gruan e shkretë, edhe gënjen pa pikë turpi se s'i ke bërë gjë! Shpejt jepja asaj gjithë paratë që ke në xhep, ndryshe, të hodha në burg!

Sjellja e gjykatësit i çuditi të gjithë të pranishmit.

Gruaja mori gjithë qejf paratë e u largua duke uruar gjykatësin. Atëherë gjykatësi u kthye nga burri e i tha të shkonte pas gruas e t'ia merrte paratë. I çuditur nga ç'po ndodhnin, burri fluturoi jashtë me shpresën që paratë t'i ktheheshin prapë.

Pas pak i sollën sërish të dy në gjykatë. Burri rënkonte duke u lëkundur sa majtas, djathtas. Nga fytyra e gërvishtur i rridhte gjak. Sërish fjala iu dha së pari gruas. Ajo ishte gjithë nerva:

- Zoti gjykatës! Këtë herë ky burrë i pafytyrë deshi të më merrte nga duart paratë që më dhatë ju!

Gjykatësi e pyeti:

- Ashtu? Po a ia arriti të t'ia merrte?

- Gruaja iu përgjigj duke qeshur me tallje:

- Pse, si të dukem unë? A mundet dot ky qull të rrëmbejë para nga dora ime?-

Atëherë gjykatësi e vuri me shpatulla për muri:



- Moj grua e paturp! Erdhe këtu duke u sjellë si e ndershme e na the që ky burrë të ka sulmuar. Me që është kështu, a nuk duhej të luftoje pak më fort për të ruajtur nderin se sa për paratë që kishe në dorë? Ktheja shpejt paratë burrit!

Para se ta dënonte gruan gënjeshtare, gjykatësi i kujtoi asaj këtë fjalë të Profetit:

*“Gënjeshtra është imoralitet. Imoraliteti e çon njeriun në xhehennem!”*

### **c. Urrejtja dhe armiqësia**

Marrëdhëniet që kemi me njerëzit mund të mos jenë gjithnjë të përsosura. Ndonjëherë, qoftë edhe pa dashje, ndodh që e prekim a e mërzitim njëri-tjetrin. Sjelljet e pamatura bëhen shkak për zemërim e mëri. Në të vërtetë, gjëja më e mirë që mund të bëhet në të tilla raste, është që të dy palët të kërkojnë ndjesë e të falin gabimin e bërë. Kështu nuk lihet vend për zemërim. Në qoftë se zemërimet dhe mëritë e vogla rriten, me kalimin e kohës njeriu mbushet me ndjenja armiqësie. Pastaj armiqësia lind ndjenjat e hakmarrjes. Kësaj i thonë urrejtje. Urrejtja dhe armiqësia janë gjëra që feja jonë i ndalon. Urrejtja dhe armiqësia i bëjnë njerëzit pa ndjenja, të ashpër. I bëjnë të mendojnë vazhdimisht për keq, t’u shkaktojnë dhimbje të tjerëve, ta humbin mirëkuptimin dhe lejueshmërinë.

Thellimi në urrejtje dhe armiqësi lind tek njeriu mendimin dhe ndjenjën e hakmarrjes. Krimet dhe gjakmarrja shpesh kryhen si pasojë e kësaj ndjenje. Këto s’janë kurrsesi veti të një muslimani. Muslimani është njeri i mëshirshëm e i kuptueshëm. Për muslimanin duhet të kenë më shumë rëndësi fytyra e qeshur, ndjenja e faljes, jo përpjekja për t’u bërë armik me njerëzit, por mik!

Profeti ynë i dashur ka thënë se një prej vetive kryesore të muslimanit është të jetë njeri *“që shkon mirë me të tjerët e që të tjerët shkojnë mirë me të.”*

Njeriu nuk fiton asgjë duke thyer zemrat e duke mërzitur njerëzit. Punët që bëjmë me ndjenjë mërie e armiqësie, janë gjithmonë shkak pendimi për ne. Njerëzit që ushqejnë armiqësi e urrejtje, herët a vonë fitojnë armiqësinë e urrejtjen e të tjerëve.

Në islam, miqësia e vëllazëria janë parim. Ata që lidhen vëllazërisht me njëri-tjetrin, nuk kanë vend në zemra për armiqësi e urrejtje. Kur bëjnë ndonjë gabim, kërkojnë menjëherë falje. Në se iu bëhet ndonjë e keqe, nuk e zmadhojnë atë por e falin duke u treguar të lejueshëm. Nuk harrojnë se si i ka falur Profeti ynë i dashur ata që e larguan nga Meka e që deshën bile edhe ta vrisnin. Përpiqen të jenë gjithnjë falës e të mirëkuptueshëm si Profeti ynë!

## Lexim letrar

### Druri i gështenjës

Xha Hysniu tregoi me gisht të pandehurin e i tha gjykatësit:

Zotëri! Vitin e shkuar, kur po shkoja në mërgim, i lashë amanet këtij burri një unazë me diamant. Tashti ia kërkoj të ma kthejë, por nuk ma jep.

Gjykatësi iu drejtua Qehajait, se ashtu i thoshin, të ulur në vendin e të pandehurit:

- Pse nuk ia jep unazën e këtij burri?

Qehajai iu përgjigj:

- Ky burrë gënjen, zoti gjykatës! As që më ka dhënë ndonjë unazë a diçka të tillë!

Gjykatësi e pyeti Hysniun:

- A ke ndonjë dëshmitar që të ka parë kur po ia jepje unazën këtij burrit?

- Jo, - tha xha Hysniu. - Nuk kishte asnjëri pranë nesh kur ia dhashë unazën nën një dru gështenje.

Atëherë gjykatësi i tha Hysniut:

- Shko shpejt atje e më sill një degë prej asaj peme!

Ndërsa Qehajait i tha të priste aty. Pas copë here, gjyqtari iu drejtua Qehajait:

- Ku mbeti dhe ky Hysniu? Pa shih nga dritarja, a po vjen?

Qehajai i pandehur iu përgjigj pa luajtur nga vendi:

- Nuk vjen dot para tre orësh, zoti gjykatës! Eshtë larg ai vend!

Atëherë gjykatësi iu drejtua Qehajait:

- Ah, ti, budalla gënjeshtar! Po s'e pate marrë ti atë unazë, si do ta dish se ku është ai dru gështenje? A nuk e ke dëgjuar si ka urdhëruar Profeti ynë?

*“Gënjeshtria e çon njeriun në të keqe dhe e keqja, në xhehennem!”*

Pastaj i dha atij një dënim të rëndë!

## Lexim letrar

### Grindaveci

Avniu ishte djalë i mirë, por, nga që grindej me të gjithë, shokët nuk e donin dhe aq.

Një ditë vjeshte fëmijët ishin mbledhur buzë liqenit e po flisnin për liqenet e detërat. Thonin se deti e ka ujin më të thellë e më të ftohtë.

Avniu, si gjithmonë, mbrojti të kundërtën.

Shokët që ia dinin vesin, as nuk i hynë diskutimit me të. Më pas fillua- të gjuanin mbi ujë me gurët e sheshtë që kishin mbledhur. Gurët kërcenin si zogj mbi ujë.

Atë ditë i pari doli Faruku. Gurët e tij rrëshqitnin mbi ujë më shumë e më bukur duke bërë kërcime të panumërta!

Avniu u bë ziliqar për Farukun.

- Pa ti shoh gurët që ke në duar! - I tha.

Faruku hapi dorën e i tregoi gurët që kish mbledhur. Në të vërtetë, gurët e tij nuk kishin asnjë ndryshim prej të tjerëve. Por Avni grindavecit i duhej të gjente një shkak.

- Posi, ke mbledhur gurë të hollë si letra. E kush s'i hedh bukur këta?

Faruku që ishte një djalë i sjellshëm, i tha:

- Merri ti këta! Mua më jep ata që ke në dorë!

Po prapë nuk ndryshoi gjë.

Hajdari, që ishte sakatuar në një aksident automobilistik, iu afrua Avniut duke çaluar.

- Sot s'qenke në formë, o mik! - I tha. Avniu, që ishte mërziur ngaqë kishte humbur, filloi t'i bërtasë :

- E ku merr vesh ti nga këto, çalaman!

Kjo sjellje e Avniut i zemëroi shumë fëmijët e tjerë. Të gjithë i thanë se ishte i pasjellshëm e i padrejtë!

Shihni se sa në kundërshtim me këtë hadith të Profetit është sjellja e Avniut! Apo jo?

*“Mos u grind me vëllain tënd të fesë! Mos u tall me të!”*

#### **d. Sjellje që dëmtojnë vendin dhe kombin**

Vendi ynë është pasuria më e rëndësishme që kemi. Të gjithë jemi lindur e rritur në këto toka. Me familjen dhe të afërmit jetojmë në qetësi në këtë atdhe. Jemi të lumtur e të lirë. Mësojmë gjuhën tonë e fenë tonë. Këtu ruhen jeta, pasuria e nderi ynë!

Duhet të jemi të vlefshëm për vendin tonë që na fal ne gjithë këto gjëra të bukura. Për këtë na duhet të punojmë shumë. Përtacia është një veti që pengon në zhvillimin e vendit e që e dëmton atë.

Duhet të jetojmë si komb, të bashkuar si vëllezër! Dhe, për këtë, na duhet të ndajmë gëzimet dhe hidhërimet, të zhvillojmë ndjenjat vëllazërore. Çdo sjellje që na e prish bashkimin, që shkakton armiqësi mes nesh, është e dëmshme!

Edhe veprimet negative kundrejt pasurive të vendit janë sjellje të dëmshme. Djegia e pyjeve, dëmtimi i pasurisë publike dhe keqpërdorimi i saj janë disa prej këtyre sjelljeve.

Gjithkush ka të drejtën e vet mbi pasurinë dhe sendet publike, pra, në përdorim të përbashkët. T'i dëmtosh ato, do të thotë të shkelësh të drejtat e një kombi të tërë. Prandaj, duhet të përpiqemi t'i përdorim pa i dëmtuar bankat e shkollës, stolat e parkut dhe telefonat në rrugë. Vetëm duke u sjellur kështu tregojmë se e duam vendin tonë!

#### **Lexim letrar**

##### **Lima e përgjakur**

Atë ditë do të psoniste Ademi. U ngrit herët e shkoi në treg. Të gjitha gjërat që mori, i futi te trasta e vogël e psonisjes. Po as që i shkoi ndër mend se lima që kish blerë bashkë me sendet e tjera, mund të shponte paketën ku ishin mbështjellë mëlçitë. Kur erdhi në shtëpi, nxori nga çanta limën me majë të mprehtë. E la te dera që t'ia lante pastaj gjakun që kishte sipër. Kur u kthye, pa një mace që e kish tërhequr era e mëlçive dhe po e lëpinte limën.

Ç'ishte e çuditshme, në vend që gjaku mbi limë të pakësohej, shtoej! Dhe macja lëpinte gjithë qejf gjakun e freskët!

Kur e kuptoi si qëndronte puna, Ademiti i erdhi shumë keq për macen e gjorë. "Pist! Pist!", e përzuri.

Kurse macja e shihte gjithë inat Ademin që i qe bërë pengesë. E gjora, nuk e kuptonte se lima i kish prerë gjuhën e se gjaku që lëpinte, ishte gjaku i vet.

Kur Ademi ia tregoi të atit ç'kish ndodhur, ai qeshi.

- Disa njerëz janë si ajo macka jote, more bir! Nuk e kuptojnë se e keqja që bëjnë, i dëmton ata vetë. Atyre që mundohen të ndalojnë të keqen e tyre, u zemërohen, ja, ashtu si macja jote!

Ademi i tha:

- Atëherë, nuk duhen penguar. Duhet lënë ta kuptojnë vetë se ajo që bëjnë, është e keqe.

Kurse i ati e kundërshtoi:

- S'na ka hije ne t'i lemë njerëzit vetëm për vetëm me të keqen e tyre, biri im! Eshtë detyra jonë të përpiqemi t'i largojmë njerëzit nga e keqja! Kështu, u bëjmë mirë edhe atyre, edhe shoqërisë!

Pastaj i lexoi këtë hadith të Profetit:

*“Kur dikush sheh një të keqe, ta pengojë atë me dorë. Në se nuk mundet ta pengojë me dorë, ta pengojë me fjalë. Në se nuk mundet ta bëjë as këtë, le ta urrejë të keqen...”*

#### 4. KREU FATIHA DHE KUPTIMI I TIJ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

الحمد لله رب العالمين, الرحمن الرحيم, مالك يوم الدين, إياك نعبد وإياك نستعين,  
إهدنا الصراط المستقيم, صراط الذين أنعمت عليهم. غير المغضوب عليهم ولا الضالين.

##### **Kuptimi:**

Falenderimi i përket vetëm Allahut, Zotit të botëve, Mëshiruesit, Bamirësit, sunduesit në Ditën e Llogarisë! Zoti ynë! Vetëm Ty të adhurojmë dhe ndihmën vetëm prej Teje e kërkojmë! Drejtona në udhën e drejtë, në udhën e atyre që u ke dhënë të mira, jo në udhën e atyre që janë ndëshkuar e të atyre që ecin shtrembër!

#### PERMBLEDHJE

1. Ç'duhet të bëjmë për të fituar respektin e të tjerëve?
2. Pse e duam familjen tonë?
3. Si ua shprehim më të mëdhenjve respektin që kemi për ta?
4. Pse është i rëndësishëm respekti ndaj flamurit?
5. Çfarë kuptoni me dashurinë për njeriun?
6. Pse duhet ta duam natyrën?
7. Si duhet të sillemi me kafshët?
8. Pse është e rëndësishme të mbrojmë pemët e pyjet?
9. Ç'lidhje ka mes shprehjes “Lulja është e bukur në degë” dhe dashurisë për natyrën?
10. Ç'do të thotë të përfolësh?
11. Shprehni ndryshimin mes smirës dhe zilisë.
12. Ç'do të thotë egoizëm? Cilat janë të këqiat e tij?
13. Kush quhet hipokrit?
14. Shpjegoni dëmet e urrejtjes e të armiqësisë.
15. Cilat janë sjelljet që i sjellin dëm vendit e kombit?

## BURIMET

- 1- Kur'ani
- 2- Sahih-i Buhari
- 3- Sahih-i Müslim
- 4- İslam İlmihali -Ö. Nasuhi Bilmen
- 5- İslam İlmihali, İslâm Ansiklopedisi
- 6- İslâm Ansiklopedisi – Türkiye Diyanet Vakfı
- 7- Din Kültürü ve Ahlâk Bilgisi - Doç.Dr.H. Algül. Doç. Dr. Osman Çetin.  
Yrd. Doç. Dr. Mustafa Öçal. - Altın Kitaplar Yayınları
- 8- Osman Nuri Topbaş, Nebiler Silsilesi 1-4, Erkam Yay.
- 9- Osman Nuri Topbaş, İman – İslam – İbadet, Erkam Yay.
- 10- . Yaşar Kandemir, Çocuklara Kırk Hadis, Erkam Yayınları
- 11-Mürşide Uysal, Peygamberimizden Hikayeler, Uysal Yayınları
- 12-Din Kültürü ve Ahlâk Bilgisi, Sabit Canbulan, Meram Yayınları
- 13-Din Kültürü ve Ahlâk Bilgisi, S. Hayri Bolay, Murat Yayıncılık